

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP
INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” – PRISHTINË

70–vjetori i Kongresit II (IV) të NDSH–së në Shkup

(Konferencë shkencore, 1 qershor 2016)

16



Shkup, 2017

Boton:
**INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE –
SHKUP
INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” – PRISHTINË**

Vëllimi 16 – 2017

Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Dr. Sevdail Demiri

Këshilli redaktues:
Dr. Sabit Syla
Dr. Skender Asani
Dr. Sabile Keçmezi–Basha
Dr. Qerim Lita
Dr. Sevdail Demiri

Redaktor teknik:
Naser Fera

Copyright© ITSHKSH, 2017

ISBN: 978–608–4653–44–8

www.itsh.edu.mk - www.ihp-ks.org

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP
INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” – PRISHTINË

*70–VJETORI I KONGRESIT II (IV)
TË NDSH–SË NË SHKUP
(Konferencë shkencore, 1.6.2016, Shkup)*

*70-ГОДИШНИНАТА ОД II (IV) КОНГРЕС НА
НДШ ВО СКОПЈЕ
(Научна конференција, 1.6.2016, Скопје)*

*70th ANNIVERSARY OF CONGRESS II (IV)
THE NDSH IN SKOPJE
(Scientific Conference, 1.6.2016, Skopje)*

- 16 -

SCUPI

Shkup, 2017

Ky botim financohet nga:



Republika e Maqedonisë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës



Nga punimet e konferencës në ITSHKSH – Shkup
(Kryesia e punës dhe fjalimi i drejtorit të ITSHKSH, dr.Skender Asani)



Pas shpalosjes së pllakës përkujtimore në oborrin e Sh.F. "Liria"
në Komunën Çair të Shkupit

TRYEZA E LËNDËS:

HYRJE.....	9
SABILE KEÇMEZI–BASHA: FORMIMI DHE VEPRIMTARIA E ORGANIZATËS NACIONAL–DEMOKRATIKE SHQIPTARE NË KOSOVË.....	11
QERIM LITA: ORGANIZIMI DHE MBAJTJA E KONGRESIT II (IV) TË NDSH–SË NË SHKUP	26
SABIT SYLA & IZET MIFTARI: REZISTENCA KUNDËR RIPUSHTIMIT JUGOSLLAV TË KOSOVËS NË RAJONIN E SHALËS (1944–1947).....	47
HAKI KASUMI: VEPRIMTARIA ATDHETARE E GJON SERREQIT	62
DAUT BISLIMI: HALIM ORANA – NJË JETË PËR SHQIPËRI ETNIKE	69
IZBER HOTI: AJET GËRGURI SIMBOL I LUFTËS PËR ÇLIRIM DHE DEMOKRACI.....	78
NAIM HALIMI: HISTORIOGRAFIA SHQIPTARE DHE AJO E HUAJ PËR DHE RRETH VEPRIMTARISË ATDHETARE TË NDSH–SË	84
NURIDIN AHMETI: KONTRIBUTI I KRERËVE FETARË NGA KOSOVA NË LËVIZJEN NACIONAL–DEMOKRATIKE SHQIPTARE	90
SEVDAIL DEMIRI: ARRESTIMET DHE GJYKIMET E ANËTARËVE TË KOMITETIT TË NDSH–SË SË KUMANOVËS (1946/47)	99
SHTOJCË.....	107
REZYME	169

HYRJE

E kaluara jonë e lavdishme historike, dalëngadalë po e gjen shtratin e vetë në kornizën institucionale të trevave shqiptare. Po kujtohen e nderohen ngjarje e figura të cilat për mëse 50 vjet me radhë ishin anatemuar, burgosur, vrarë apo likuiduar nga regjimet komuniste.

Lufta e gjatë për mbijetesë e popullit shqiptar, si dhe luftërat e armatosura me emblemen e UÇK-së, sollën ndryshime rrënjësore në korpusin tonë shoqërorë. Andaj, si rezultat i këtyre ndryshimeve pozitive, sot me krenari po kujtohen veprimtarët e çështjes kombëtare, të cilët në kohërat më të vështira, na treguan se rruga jonë e vetme orientuese për perspektivën tonë të sigurtë, është bota demokratike përëndimore.

Pikërisht këtë orientim përparimtar e kishte edhe njëra nga organizatat më domethënëse në vargun e përpjekjeve të shqiptarëve për liri dhe bashkim kombëtar – Organizata Nacional–Demokratike Shqiptare, e cila shkurt njihet si NDSH. Shtatë dekada më parë, çerdhen e veprimit politik, NDSH-ja e kishte në Shkup, pikërisht në këtë qytet të lashtë dardano–ilir, ku historikisht janë ndërthurur intereset e fuqive të ndryshme.

Dhe tani, pas shtatë dekadave, NDSH-ja është përjetësuar dhe zyrtarizuar pikërisht këtu në Shkup. Disa nga rrugët e Qytetit të Shkupit, me krenari mbajnë emrat: “Nacional–Demokratët Shqiptarë”, “Azem Marana”, “Qemal Skenderi”, “Gjon Sereçi”, etj. Pa dyshim, është ky një angazhim i vogël i autoriteteve shqiptare të Shkupit të vjetër dhe hisrtorianëve shqiptarë, në krahasim me veprën e madhe të atyre veprimtarëve.

Edhe konferenca shkencore që u mbajt më 1 qershor 2016 në Shkup, në përkujtim të 70–vjetorit të Kongresit II (IV) të NDSH–

së, është në funksion të nderimit të mundit, djersës dhe gjakut të atyre të cilët u flijuan për një të ardhme më të ndritur të brezave.

Ishte ky një bashkëorganizim në mes të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup dhe Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, me qëllim të zbardhjes së të vërtetave historike, lidhur me këtë ngjarje të rëndësishme.

Me kumtesat e tyre shkencore, të cilat janë përmbledhur në këtë botim të veçantë të revistës “Scupi”, morën pjesë dhjetëra studiues jo vetëm se nga dy institucionet e lartpërmendura, por edhe studiues dhe njohës tjerë të kësaj fushe. Gjatë konferencës u zhvillua edhe një debat mjaft konstruktiv, kurse punimet e konferencës i ndoqi një publikë mjaft i respektuar, në mesin e të cilëve ishin edhe pjesëtarë të familjeve të përfaqësuesve të lartë të NDSH-së, si të Azem Maranës, Gjon Sereçit, Ajet Gërgurit, Ibrahim Haki Kelmendit, Sulë Hotlës, Qemal Skenderit, Jetish Vishit, etj.

Pjesë përbërëse e këtij organizimi, ishte edhe shpalosja e pllakës përkujtimore në nderim të delegatëve të Kongresit II (IV) të NDSH-së: Azem Marana, Qemal Skënderi, Hasan Bilalli, Hysni Rudi, Jonuz Balla, Osman Cami, Halim Orana, Haki Taibi dhe Faik Këpuctari-Prishtina. Kjo pllakë u shpalos në oborrin e Shkollës Fillore “Liria” në Komunën Çair të Shkupit, pikërisht në çerdhen e NDSH-së, nën organizimin e kryetarit të komunës, Izet Mexhiti.

Shpresojmë që përmes këtyre punimeve shkencore, që po botohen në këtë edicion, do të dalin nga harresa ngjarje dhe figura historike, të cilat meritojnë më shumë përkushtim dhe vëmendje, për t’ua lënë trashëgimi gjeneratave që do të vijnë pas nesh.

Këshilli organizues/redaktues

SABILE KEÇMEZI-BASHA

Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë

FORMIMI DHE VEPRIMTARIA E ORGANIZATËS NACIONAL- DEMOKRATIKE SHQIPTARE NË KOSOVË

Pas Marrëveshjes së Mukjes (1943)¹, ndaj Ballit Kombëtar, si forcë politike kombëtare zhvillohet një fushat komprometuese, duke e akuzuar drejtpërdrejt si bashkëpunëtore të fashizmit, dhe pas kësaj lindi nevoja që krerët e saj të mblidhen dhe me ndihmën e misionarëve diplomatik të shërbimeve informative angleze, në nëntor të vitit 1943, në Gjakovë iniciohet formimi i ONDSH-së². Dihej se Kosovës gjatë luftës iu premtua se pas përfundimit të LDB, ajo do të bashkohej me Shqipërinë, por ndodhi mashtrimi më i madh që i kishin bërë jugosllavët shqiptarëve, dhe dihej se më 8–10

¹ **Marrëveshja e Mukjes** u nënshkrua më 2 gusht 1943 në fshatin shqiptar të Mukjes, midis Ballit Kombëtar dhe Partisë Komuniste të Shqipërisë, për të bashkërenduar rezistencën shqiptare në Luftën e Dytë Botërore, dhe për t’u përgatitur për të ardhmen e Shqipërisë Etnike. Marrëveshja themeloi një Komitet të Shpëtimit Kombëtar i cili duhej të merrte drejtimin e lëvizjes së rezistencës shqiptare. Nga ana e komunistëve shqiptarë, marrëveshja u nënshkrua nga Ymer Dishnica, një anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Një mosmarrëveshje u ngrit në lidhje me statusin e Kosovës. Ndërsa Balli Kombëtar propozoi për të luftuar për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, përfaqësuesit komunistë kundërshtuan ashpër. Më në fund u arrit një kompromis, ku çështja e Kosovës të vendosej në një referendum të popullit të saj në fund të luftës. Marrëveshja u konsiderua kundërrevolucionare nga Partia Komuniste e Jugosllavisë, i deleguari i të cilëve pranë Partisë Komuniste të Shqipërisë, Svetozar Vukmanović-Tempo, ushtronte ndikim të konsiderueshëm mbi komunistët shqiptarë, e veçanërisht mbi drejtuesin e tyre, Enver Hoxha. Si pasojë, kjo marrëveshje u dënua zyrtarisht nga Enver Hoxha në një takim të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë.

² Qerim Lita, “Referat për komitetet nacional-demokratike shqiptare”, Prishtinë, 2009, 5

korrik 1945, u mbajt Kuvendi i Prizrenit ku edhe zyrtarisht Kosova u okupua nga Serbia dhe Jugosllavia.

Pas konferencës, forcat atdhetare— nacionaliste shqiptare ngelën të pakënaqura, andaj organizuan dhe riaktivizuan organizatat atdhetare dhe më vonë do të shohim se numri i tyre ishte i madh. Në Kosovë vepronte organizata e NDSH-së, që ishte vazhdimësi e ONDSH të Ejup Binakut, Besa Kombëtare e Prof Ymer Berishes³, Organizata NR. 2⁴, e Ajët Gërgurit etj.

Një ndër këto organizata që bëri bujë pa dyshim ishte Organizata Nacional Demokratike Shqiptare (ONDSH) në Kosovë, Maqedoni dhe në vise të tjera shqiptare në Ish-Jugosllavi⁵. Veprimet dhe ndjenjat patriotike të shqiptarëve, dashuria për atdheun, shfaqja transparente e dëshirës dhe aspiratat shekullore për bashkimin kombëtar, jo vetëm që nuk u përfillën, por u konsideruan si “shqiptaromëdha” dhe që çonin ujë në mullirin e armikut. Nën presionin e fuqishëm politik të qarqeve serbe e jugosllave, çështja e Kosovës u tentua të mbyllej në mënyrë të panatyrshme dhe të

³ Prof. Ymer (Shaban) Berisha (1912-1946), lindi në fshatin Gjurgjevik i Madh. Pasi kreu Shkollën Normale në Elbasan, arsimin e lartë, në degën histori-geografi dhe kursin ushtarak në Romë, shërbeu arsimtar në fshatrat e Krujës, Tropojës, Kukësit, Peshkopisë, Lushnjës, Beratit, dhe të Shkodrës, ndërsa në vitet 1941-1944, në normalen “Sami Frashëri” të Prishtinës. Nga nëntori i vitit 1944 doli në ilegalitet, formoi organizatën “Besa kombëtare” dhe u shqua si ideolog i qëndresës së armatosur për mbrojtjen e kufijve dhe bashkimin e trojeve shqiptare. U vra më 11 korrik të vitit 1946, në Hereç të Gjakovës, në përpjekje me forcat e të ashtuquajturës Mbrojtje Popullore dhe të milicisë.

⁴ Organizatën nr. 2, e formoi Ajët Gërguri në prill të vitit 1945. Prej janarit të vitit 1946, quhet edhe me një emër të ri “Shtabi i Zonës II-të LPLTSH”. Gjatë tërë veprimtarisë së saj ishte e lidhur ngushtë me organizatën patriotike “Besa kombëtare”. Anëtarët e kësaj organizate ishin njerëz të shquar të lëvizjes shqiptare si në fushën politike, ashtu edhe në atë luftarake. Për këtë arsye, kjo organizatë mori për detyrë përgatitjen e Kongresit të Lipovicës të LNDSH-së, të mbajtur me 25 korrik 1946 në malet e Lipovicës.

⁵ Muhamet Pirraku, *Mulla Idriz Gjilani, Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore 1941-1951*, Prishtinë 1995, f. 324

humbas karakterin e saj si një problem i mprehtë kombëtar e politik⁶.

Komiteti Qendror i NDSH-së në Shkup u formua në prill të vitit 1945 dhe veprimtarinë e vet e zhvilloi edhe në Kosovë e Maqedoni⁷. Ky Komitet pati jetë veprimi më të gjatë se KQ i Prizrenit, përkatësisht deri më 1946, kur edhe u zbulua veprimtaria e tij. Gjatë tërë kohës Komiteti i Shkupit ishte shumë aktiv, ngase mbante lidhje edhe me përfaqësuesit e huaj në Shkup, si me përfaqësuesit anglez, amerikan, francez, turq⁸, etj.

Kongreset e Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare

Nga anëtarët e ONDSH-es u mbajtën gjithsejtë tri kongrese, dhe duhet shtuar se rrethanat ishin të tilla sa këto kongrese u mbajtën brenda një viti, kur edhe bëhet zbulimi i veprimtarisë të anëtarëve të ONDSH-së.

Kongresi I (III) i ONDSH-së

Kongresin I (III), u mbajt në Kopilaçë, më 15–16 gusht 1945⁹, por në këtë tubim nuk kishin marrë pjesë të gjithë të ftuarit, sepse ishte shumë vështirë për të udhëtuar, sepse në çdo pjesë të vendit qarkullonin dheurvejtonin bashkëpunëtorët e UDB-es, dhe ekzistonte frika që të zbulohen e të arrestohen anëtarët. Në këtë kongres nuk kishin ardhur edhe përfaqësues të tjerë e që mosardhja

⁶ Lefter Nasi, Mbi statusin Politiko-Juridik të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore (1944-1946), “Çështja e Kosovës një problem historic dhe actual”, Tiranë 1996 fq. 222.

⁷ Qerim Lita, “Referat për komitetet nacional demokratike shqiptare”, Prishtinë, 2009, 71

⁸ Sabile Keçmezi- Basha, *Lëvizja ilegale patriotike shqiptare në Kosovë 1945-1947*, Prishtinë 1998, f. 79; Ahmet Qeriqi, *Kongresi i Lipovicës- ngjarje e rendësishme e rezistencës popullore*, “Bujku”, 14 janar 1996

⁹ Daut Bislimi, *Formacionet politiko- ushtarake në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë 1997, f. 227-230; Branislav Bozhoviq, Milorad Vaviq, *Surova vremena na Kosovu i Metohiju*, Beograd 1991, fq. 549, AVII, nj, k. 61, 12/1 – 45, 46

e tyre ndikoi që të mos zgjidhet KQ i NDSH-së, e që tërë kjo ngeli që të bëhet më vonë, në kongresin e ardhshëm, ku do të tubohen edhe delegat të tjerë¹⁰, dhe u vendos që kongresi i ardhshëm të mbahet me 1 qershor 1946 (respektivisht u caktua që të mbahet pas dhjetë muajve nga Kongresi I i NDSH-së). Për këtë tubim të madh të rezistencës kombëtare u ftuan të gjithë përfaqësuesit e të gjitha komiteteve të NDSH-së që vepronin në atë kohë.

Kongresi II (IV) i ONDSH-së

Kongresi i II (IV) i ONDSH-së u mbajt me 1 qershor, në qytetin e Shkupit. Situata politike kur u mbajt kongresi i dytë ishte edhe më e rëndë se ndërkohë u zbuluan dhe u arrestuan anëtarët e KQ të NDSH-së në Prizren. Ky ishte edhe shkaku që kushtëzoi që të merren masa paraprake urgjente organizative, ngase në Kosovë ishte instaluar pushteti administrativo-ushtarak, dhe çdo veprim ilegal ishte i vështirësuar. Sipas disa të dhënave me të cilat disponohet, në kongres morën pjesë vetëm 12 delegatë¹¹, sepse situata politike ishte shumë e rëndë dhe e tendosur. Çdo veprim apo lëvizje përcillej me dyshim nga organet e pushtetit. Megjithatë të pranishmit morën qëndrim që kongresi t'i zhvillojë punimet, sepse në të ardhmen askush nuk do të mund të prognozonte për përmirësimin e situatës politike në vend.

Nga ky kongres doli një udhëheqësi e re e NDSH-së. Kryetar u zgjodh patrioti dhe veprimtari i dalluar Halim Orana nga Gjilani, Qemajl Skenderi u zgjodh zëvendës-kryetar dhe Azem Morana, sekretar i organizatës, ndërsa anëtarë të KQ të NDSH-së u propozuan dhe u zgjodhën Hamdi Berisha, Mehmet Bushi, Hysni Rudi, Januz Balla, Mahmut Dumani, Hasan Bilalli, Haki Efendi

¹⁰ Besim Kajtazi, Gjurmëve të Komitetit Nacional Demokratik Shqiptar, Ora, 1991 (vazhdimi i tretë), Prishtinë

¹¹ Muhamet Piraku, *Mulla Idriz Gjilani, Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore 1941-1951*, Prishtinë 1995, f. 324

Sermaxhaj, Osman Cani dhe Mitat Tershana. Kongresin e kishte përshëndetur edhe Luan Gashi, i cili kastile kishte ardhur nga Perugia e Italisë, dhe në atë kohë ishte sekretar i Komitetit të Ballit Kombëtar.¹² Kongresi gjatë punës që zhvilloi, miratoi një sërë dokumentesh që më vonë patën një rëndësi të madhe historike. Delegatet me aklamacion miratuan “Skemën e organizimit” dhe “Programin e Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare”¹³. Në kongres vlen të përmendim se mirënjohje e veçantë për punën dhe hartimin e dokumenteve iu shpreh Halim Oranës, sepse pa angazhimin e tij puna e kongresit do të ishte më e zbehtë dhe jo në nivelin e duhur¹⁴.

Dokumentin e parë, që e miratoi kongresi ishte “Skema organizative”, që në të vërtetë në të përfshihej struktura organizative e organizatës si në terren, po ashtu edhe në vetë komitetet e tyre. Në çdo qytet dhe në çdo fshat propozohej nga një skemë identike për formimin e komiteteve të vendit, për lirin e tokave shqiptare. Koordinimi i të gjitha punëve ndërmjet komiteteve duhej të bëhej përmes “Komitetit Epruer”¹⁵. Ndërsa, Komiteti Epror të jetë i varur nga Komiteti Qendror i NDSH-së. Dhe çdo komitet, pa marrë parasysh se është i qytetit, fshatit, rajonit apo i komunës, duhet të ketë strukturën organizative ose udhëheqësin e vet, e cila përbëhet nga kryetari, sekretari, anëtari i parë, anëtari i dytë dhe anëtarë të tjerë të kryesisë, që do të caktohen sipas nevojës. Kryesia, respektivisht anëtarët e saj i ndajnë detyrat dhe obligimet ndërmjet veti, që caktohen sipas nevojës dhe zotësisë së anëtarëve. Punën e organizimit dhe përgjegjësin për të e mban kryetari. Ai, ndër të tjera organizon dhe zbaton urdhëratë e Komitetit Epror. Sekretari në bashkëpunim me dy anëtarët, kryejnë shërbimet e propagandave

¹² Lubo Popoviq, Dosja 50-1-00002.

¹³ Sabile Keçmezi-Basha, Procesi gjyqësor I Prizrenit, 1946, (Monografi në dorëshkrim)

¹⁴ Dr. Sabile Keçmezi-Basha, Lëvizja patriotike...vepër e cituar

¹⁵ *Rekapitulimi i UDB-es pas vitit 1947*. Dr. Muhamet Pirraku, *Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945*, Prishtinë 1992, f.160

të lajmeve dhe si detyrë kryesore kanë të bëjnë ndërlidhjen ndërnjjet shërbimit politik dhe atij ekonomik. Sipas “Skemës organizative” llogaritej se shërbimi më i ndjeshëm dhe më i nevojshëm ishte shërbimi politik i komitetit, dhe anëtarët e këtij shërbimi ishin të obligueshëm që t’i kushtonin rëndësi të posaçme.

Nga “Skema e organizimit” propozohej, që çdo komitet në kuadrin e vet të formonte një trup, i cili do të vepronte nën emrin “SIP” që do të thoshte Sigurim Politik. Sigurimi Politik kishte për detyrë mbledhjen e informatave për personat e ndryshëm dhe të hetonte sigurimin e mirëvajtjes së veprimtarisë së komiteteve.

Programi politik i ONDSH-së

Duhet përmendet se, edhe pas përfundimit të LDB, organizatat ilegale të cilat filluan të vepronin në Kosovë karakterizohen me programet e tyre që kryesisht kishin mbështetje në kërkesat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Organizata e cila bëri bujë dhe emër me veprimtarin e saj patriotike gjatë viteve 1945 e deri më 1956 ishte ONDSH-në¹⁶, e cila veprimtarin e saj e shtrinte në Kosovë dhe në pjesën Lindore të Maqedonisë, duke u përcaktuar për luftë të armatosur kundër robërisë së re jugosllave dhe formimit të një shteti shqiptar me territoret e veta. Kishte një politik nacionale e demokratike pro-perëndimore, dhe kryesisht udhëhiqej nga patriot dhe intelektual të shquar si Ymer Berisha, Halim Spahiu¹⁷, Selman

¹⁶ Sabile Keçmezi-Basha, Programet Politike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 1878-1990, Prishtinë, 2013, 158

¹⁷ Halim (Shaqir) Spahia (1897 - 1946) lindi në Gjakovë. Ishte tregtar, industrialist, financier dhe mbi të gjitha një patriot. Halim Spahia ishte aktivist i Ballit Kombëtar, kryetar i Këshillit Qendrorë të LNDSH-së, kryetar i Këshillit Nacionalçlirimtar (KNÇ) të Rrethit të Prizrenit dhe anëtar i Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar të Kosovës. Halim Spahia rrjedhë nga një familje tregtare me tradita patriotike. Qysh në rini u detyrua ta braktiste vendlindjen e okupuar nga serbo-malazezët dhe u vendos në Krumë, ndërsa më vonë ai vazhdoi të jetonte dhe të vepronte në Kukës. Halim Spahia duke qenë në mesin e patriotëve të shquar shqiptarë si Bajram Curri, Hasan Prishtina, Hysni Curri, Bajram Daklani, Nimon Ferizi, Avni Rustemi etj. Qysh herët u pajis me një atëdhe dashuri të rallë

Riza, Gjon Serreqi¹⁸ e shumë të tjerë. Programi i saj ishte i përbërë prej pesë pikave të cilat kryekëput përputheshin me pikat e LSHP.

dhe u kalit për betejat e mëvonëshme të cilat I mori mbi supet e veta për bashkimin kombëtar. Halim Spahia luftoi dhe u angazhua vazhdimisht me tërë qenien e tij për çështjen kombëtare, për bashkimin e Kosovës dhe të tokave të tjera shqiptare në një tërsi kombëtare – Shqipërinë Etnike Demokratike, të integruar në Botën e Lirë Perëndimore. Për këtë ai sakrifikoi me plotë vetëdije pasurinë, dijen dhe jetën e tij. Halim Spahia si tregtar, industrialist dhe financier i njohur që ishte, kontribuojë në ngritjen ekonomike dhe sociale të Lumës, të Hasit dhe të Malësisë së Gjakovës. Ai la gjurmë të pashlyeshme në ngritjen e industrisë, të rrjetit tregtar, të infrastrukturës, të arsimit dhe të shëndetësisë në këto treva shqiptare, si dhe në Kosovë. Halim Spahia si deputet i Përfekturës së Kosovës në Parlamentin Shqiptar, që angazhuar me konsekuencë për përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe të pozitës së fshatarësisë së Veriut, si dhe angazhuar për injorimin dhe zhdukjen e kufirit që ndante dy pjesët e kombit shqiptarë. Halim Spahia së bashku me Selman Rizën, Ejup Binakun etj. themeluan më 1943 në Gjakovë, Lëvizjen Nacionale Demokratike Shqiptare (LNDSH-ën) dhe njëherit Halim Spahia ishte kryetar i parë i Komitetit Qendror të LNDSH-ës, të cilën e udhëhoqi guximshëm derisa që gjallë. Njëherit ai ishte edhe delegate i Gjakovës në Kuvendin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit ku dha një kontribut të veçantë.

¹⁸Gjon Serreqi ka qenë njëri ndër intelektualët dhe personalitetet më të shquara dhe më me ndikim të Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare të Kosovës. Gjoni, ishte i biri i Gjergj Serreçit. Lindi në Ferizaj më 11 shkurt të vitit 1920. Nëna e Gjergjit quhej Ankica, e gjinisë Kurti, nga Prizreni. Mësimet e para i mori në vendlindje. Duke qenë se shquhet për zell dhe talent të veçantë, babai, Gjergji, e regjistron në Seminarin peshkopal në Prizren, por megjithatë Gjoni përfundon gjimnazin më 1939/40. Po në këtë vit ai vazhdon studimet në Universitetin e Zagrebit- Fakulteti Filozofik. Pas një viti qëndrimi, kthehet në Kosovë, ku edhe e gjen kapitullimi i Jugosllavisë. Në prill të vitit 1941, këtë herë nisët për Itali, në qytetin e Pizës vazhdon studimet në të njëjtin fakultet si në Zagreb, por pas gjashtë muajve largohet përsëri për të shkuar në qytetin e Firencës. Më 1943 përsëri kthehet në Kosovë dhe emërohet kryetar i Komunës Babush, Rrethi i Nerodimes. Më 1944 arrestohet nga policia gjermane SS. Së pari e deportojnë në Kampin e Prishtinës “K-16”. Aty qëndron deri në janar 1945. Në qershor 1945 kthehet në Ferizaj. Po në këtë vit fillon të punojë si profesor i Gjimnazit “Sami Frashri” në Prishtinë, dhe qëndron deri më 27 prill 1946, kur kalon në ilegalitet. Gjon Serreqi u arrestua më 24 shkurt 1947, aty diku kah ora 21 e natës. Atë e arrestuan dy oficerë të OZN-së: Aleksa Vuçiniq dhe Dragutin Papoviq, me katër policë serbë përcjellës, të cilët arrijnë ta kapin Gjonin para se të aktivizonte bombat e dorës. Në procesin gjyqësor të mbajtur me 22-27 prill 1947, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, nr. 66/47, Gjon Serreqi sëbashku me Ukë Sadikun, Ajet Gërgurin e Osman Bunjakun, dënohen me vdekje-pushkatim. Edhe pse iu

Programi i ONDSH

Do të citoja vetëm disa nga pikat kryesore të programit të kësaj organizate siç janë të shënuara:

1. Liri dhe pavarësi të plotë me të drejtë vetëqeverimi në bazë të vullnetit të popullit të çfaqun lirisht.
2. Nën tokat shqiptare kuptohet krejt vendet ku banojnë shqiptaret në 60% pa dallim se si quhet krahina e vendi dhe nga kush asht i pushtuem.
3. Lëvizja nuk ka qëndrim armiqësor kundër asnjë populli fqinj as kundër partije politike, vetem insiston në mënyrë kulturave dhe me armë do të përpiqet mi arrijtë idealet shekullore të kombit Shqiptar qi të jetë i lirë dhe vetesundues në shtet të vet me kufij etnik.
4. Mbasi të vendosen kufijt etnik, pa marr parasysh tjerat kushte të kufijve si janë ato: strategjike, ekonomike, politike etj, në mënyrë miqësore do te shkëmbehet popullata e pakicave nacionale, tue i tërheq Shqiptaret qi do te mbetin jasht kufijve në vend të aryne qi do ti shpërngulin tue u organizue për regjim me të vërtet demokratik dhe për relacione miqësore me popujt fqj Ballkanik
5. Në kohë paqe Lëvizja nuk do të pushojë por do te vazhdojë si shërbim roje të drejtave të popullit Shqiptar, si t'atyne të jashtme, nderkombtare tue u organizue për regjim me të vërtet demokratik dhe për relacione miqësore me popujt fqj Ballkanik.

“Shema organizative” e Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare

1. Në çdo vend (qytet e katund) formohet “Komiteti i vendit për lirimin e tokave shqiptare”;

ankuan Gjyqit Suprem të Serbisë, ajo e refuzoi atë me vendimin KZH 989, më 3 korrik 1947, sikurse edhe Presidiumi i Kuvendit të Serbisë me vendimin Rez.nr. 3202 të datës 13 gusht 1947.

2. Për koordinim pune në mes të këtyre komiteteve të vendit janë “Komitetet Epruer”;
3. Komiteti Epruer mvaret nga Komiteti Qendror. Të parët janë në lidhje me komitetin Epruer e këta me Komitetin Qendror;
4. Çdo komitet formohet nga : Kryetari, Sekretari, Anëtar i parë, Anëtar i Dytë, dhe përgjegjës të ndryshëm sipas nevojës;
5. Këta i ndajnë detyrat dhe përgjegjësin si mbas nevojës e zotësisë. Drejtimin e përgjithshëm e mban kryetari, administron dhe zbaton urdhrat e Komiteteve Epruer;
6. Sekretari bashkë me dy anëtarët kanë: Shërbimin e propagandave të lajmeve, edhe si detyrë kryesore, ndërlidhjen, ashtu edhe shërbimin ekonomik dhe politik;
7. Shërbimi politik i takon kujdesia e posaçme. Për këtë çdo komitet formon një trup nën emrin “SIP” (Sigurimi politik). SIP–i e ka për detyrë mbledhjen e informatave mbi personat e ndryshëm dhe heton sigurimin e mirëvajtjes së veprimtarisë së komiteteve;
8. Komitetet e vendit veprojnë në marrëveshje në mes të anëtarëve;
9. Komitetet Eprorë kanë po këta persona; për nga shkakut se do të kenë më shumë punë, anëtarët do t’i ndajnë detyrat dhe në rast nevojë të formojnë seksione me referentë dhe përgjegjës”.¹⁹

Struktura organizative

Duke u mbështetur mbi këtë parim ishte paraparë që Komiteti Qendror të jetë organi më i lartë i organizatës, ndërsa në terren të vepronin komitetet e rretheve, të rajoneve, të komunave dhe komitetet lokale nëpër fshatra. Komitete lokale e rajonale kishin

¹⁹ Dokumentet të cilat u miratuan në Kongresin e IV të ONDSH-së, i cili u mbajt me 1 qershor të vitit 1946 në Shkup: “Shema Organizative” dhe “Programin” e “Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare” e kishte hartua patrioti i Gjilanit, Halim Orana.

statusin e organizmave baze ngase kryenin punë sikur që ishin grumbullimi i ndihmave materiale, ushqime, veshmbathje, shpërndanin afishe, përhapnin të vërtetën për NDSH, propagandonin domosdoshmërinë e bashkimit kombëtar, formonin komitete të reja në terren, ku përfshinin të rinjtë shqiptar, por gjithashtu ishte si obligim që sa më shumë të angazhoheshin edhe gratë. Komitetet e para të ONDSH u formuan në Prizren dhe në Rahovec aty kah fillimi i vitit 1945. Por shpejt lindi nevoja, për shkaqe të sigurisë që KQ i ONDSH të ndahet në dy pjesë. Kështu ndodhi një pjesë e KQ kaloi në Shkup dhe një pjesë e KQ ngeli në Prizren.

Komiteti i Prizrenit u formua me urdhrin e Ali Rizës, kapiten, dhe në Rahovec u formua me iniciativën e prof. Ymer Berishës. Por shpejt këto dy organizata u bashkuan dhe formuan KQ të cilën e udhëhoqi Halim Spahija. Në mesin e shumë punëve që kryente ONDSH, ajo u angazhua që çdo anëtarë i organizatës të ketë pseudonim. Ishte e obligueshme që çdo komitet të bënte evidencimin e anëtarëve të vrarë, të regjistronte emrat e serbëve që torturonin, maltretonin e likuidonin shqiptarët, të regjistroheshin të gjithë shqiptarët që spiunonin apo bashkëpunonin me okupatorin, por detyra më parësore ishte që anëtarët e NDSH-së të mos hezitonin që të punësoheshin në organet e shtetit të ri ngase në këtë mënyrë ata vinin më lehtë deri tek informata dhe qëllimet e pushtetit²⁰.

Komitetin e rrethit në Prishtinë e formoi Tahir Deda, një qytetar i pasur i cili tërë pasurin e la në shërbim të atdheut, por kryetar i saj u zgjodh Sylejman Aliu²¹, profesor. Ndërsa, procedura e pranimit në radhët e NDSH-së ishte shumë rigoroze, ngase për të pranuar një anëtar të ri duhej të gjendej një propozues dhe të flet për biografinë e tij atdhetare, pastaj nga të pranishmit kërkohej që të hulumtojnë për të dhe të verifikojnë të dhënat. Kur të gjitha të dhënat

²⁰ Sabile Keçmezi-Basha, *Lëvizja patriotike... vepër e cituar; Hakif Bajrami, Kosova prej Bujanit në Kaçanik*, Prishtinë 1997; Ragip Megjuani: "A kanë qenë udhëheqësit e vjetër shqiptarë të Kosovës të viteve 1945-1989 më kombëtar"

²¹ Ethem Çeku, *Shekulli i ilegales*, Prishtinë 2004, 23; *Masakrat e klikës Tito në Kosovë, Metohi dhe Dibër të Madhe*, Tiranë, 1952,

përputheshin në mes të propozuesit dhe të anuarve që kishin hulumtua për biografin e tij kandidati pranohej në radhët e NDSH. Anëtarit të ri i caktohej pseudonimi dhe në një mbledhje thirreshin disa anëtar nga KQ, dhe personi i pranuar e jepte betimin.

Teksti i Betimit

Betimi jepej para flamurit, revoles, dhe fillimisht ishte edhe Kurani, por më vonë me ardhjen e Gjon Sereqit në radhët e NDSH—së, ndryshon teksti i betimit. Betimi në fillim kishte këtë tekst: “Beto—hem në Kuran, në Flamurin Kombëtar dhe në armë, se do të punoi, me besnikëri e vetësakrificë me çmimin e jetës, për kombin shqiptarë dhe për çlirimin e bashkimit të tokave shqiptare në Shqipërinë Etnike”, ndërsa teksti i dytë i betimit që e kishte modifikua Gjon Sereqi ishte më i shkurt dhe kishte këtë përmbajtje: “Betohem në Flamur, në fis e në revole se do të mbetem besnik i organizatës NDSH”²², në tekst revolja simbolizonte se poqese dikush tradhton organizatën ai do të vritej. Betimi kryesisht bëhej në këmbë, dhe ceremonia e pranimit përfundonte dhe mbledhja kryhej me parullën: ”Shqipëria shqiptarëve, vdekje tradhtarëve”²³. Pas pranimit personi që pranohej ishte i barabartë me të gjithë të tjerët dhe ndaj organizatës merrte obligimet dhe përgjegjësit që i takonin.

Mbështetja nga shtetet demokratike

Pas përfundimit të LDB—së, pushteti jugosllav ishte i vetëdijshëm se populli shqiptar dhe forcat nacionaliste në Kosovë dhe gjithandej ku jetonin shqiptaret ishte i pakënaqur me riokupimin dhe aneksimin e Kosovës nga Serbia, andaj OZNA dhe organet tjera të ndjekjes ishin angazhuar që t’i zbulonin anëtarët e organizatave ilegale dhe

²² Muhamet Pirraku, *vepër e cituar...* f. 324-326

²³ Gojko Medenica, *Nata e frorit* (Aksioni për zënien e komandantit të bandave balliste për Kosovë e Metohi, Ukë Sadikun), Rilindja 25 shkurt 1965; Hasan Shala, Izet Hoti, Besa e gurit, Prishtinë 1996, f. 60-70

t'i asgjësonin e likuidonin kudo që ndodheshin ato. Për këtë, atdhetaret e njohur, siç ishin Muharrem Bajraktari e Mithat Frashëri që ndodheshin në Greqi e Itali, u angazhuan dhe bënë apel tek krerët e forcave nacionaliste që të përgatiten dhe të largohen nga Kosova për Greqi²⁴, që nga atje të përgatiten më mirë dhe me ndihmën e forcave aleate dhe properëndimore të ndërmarrin aksione për vendosjen e rendit të ri në Shqipëri e Jugosllavi. Po përkrahje kishin, bile në bazë të dokumentacionit, del se kishin përkrahje morale nga përfaqësitë angleze, turke, franceze dhe të SHBA-ve, po ashtu përkrahje kishin edhe nga mërgata shqiptare që vepronte në Bari të Italisë dhe në vendet tjera të Evropës e botës.

Themeluesit kryesor të ONDSH-së dhe profili i tyre politik

Themeluesit e kësaj organizate ishin kryesisht intelektual, dhe patriot të shquar të kohës. Ishin njerëz të cilët kishin përfunduar fakultete në vendet perëndimore si në Francë, Itali, Gjermani etj. Ishin elita shqiptare njerëz të pasur që shumë nga ata kishin shkruar tërë pasurin për çështjen kombëtare. Dhe duhet përmendur se themeluesit kryesor të saj ishin: Prof. Ymer Berisha që llogaritej se ishte edhe vet koka e ilegales, pastaj ishin profesorët e gjimnazit “Sami Frashëri” në Prishtinë si: Luan Gashi, Hajdar Maloku-Planeja, Gjon Serreqi, agronomi Adem Gllavica, gjykatësi Limon Staneci, që të dy ishin kryeshefa të rretheve, njëri ishte nga Ferizai e tjetri nga Gjiłani, gjykatësi Ibrahim Lutfiu, Ukë Sadiku, kryeshef i qarkut në Mitrovicë, Ejup Binaku, kryeshef i rrethit në Rahovec, me profesion mësues, Ajet Gërguri, teknik i bujqësisë dhe shumë e shumë të tjerë që nga kjo që thamë le me kuptua se udhëheqësit e ilegales ishin njerëz të ngritur dhe me atdhedashuri të madhe. Por duhet cekur se ONDSH-ja në radhët e veta kishte edhe kapitena në Ushtrinë Jugosllave si Ibrahim Banush Sedllari, Ejup Binaku, Hysni Rudi si dhe oficerë e nënoficerë të tjerë.

²⁴ Letra e Mithat Frashërit, Muharrem Bajraktarit; Reginald Hibert, *Fitorja e hidhur*, Tiranë 1993, f. 374-379

Organizata ilegale e ONDSH-së, ishte organizata më e madhe pas LDB. Ajo gjatë vitit 1945–1947, në radhët e veta kishte 30.000 mijë anëtarë, kurse në PKJ në Kosovë kishte vetëm 8.800 anëtarë, e prej tyre shqiptarë ishin vetëm 6.000 veta²⁵. Dhe nga kjo del përfundimi se sa ishte populli shqiptar me pushtetin dhe Partinë Komuniste.

Kongresi III (V) i ONDSH-së

Situata e krijuar si brenda ashtu edhe jashtë kufijve ndikoi që organizata e NDSH-së të mbante tri kongrese partiake brenda një viti. Kongresi V, u thirr të mbahet më 25 korrik 1946 në malet e Lipovicës (Blinaj) në Drenicë, por për të humbur gjurmë nga organet e sigurimit jugosllav lajmërohet se do të mbahet në Kozmaç²⁶. Kjo taktikë nga ana e udhëheqësve të ONDSH-së u tregua e suksesshme, sepse kongresi u mbajt pa u zbuluar nga organet e ndjekjes. Në kongres merrnin pjesë mbi 250 delegatë ndaj edhe ishte më masivi në historinë e NDSH-së.

Vizioni i programit politik të ONDSH-së

Nuk mund të thuhej se ONDSH ishte organizatë pa të ardhme, ngase poqese e shikojmë në planin afatshkurtër mund të themi se ishte por në planin afatgjatë ONDSH- ishte fituese. Më vonë, të gjitha organizatat ilegale që vepruan tek shqiptarët jashtë shtetit shqiptar vazhduan rrugën e anëtarëve të NDSH-s por në forma mënyra dhe emra të ndryshëm. Të gjitha programet e organizatave të mëvonshme ilegale kishin në programet e tyre, kërkesat e njëjta që kishte pasur ajo, dhe anëtarët e tjerë të saj që nuk u zbuluan veprimtarin e tyre e zhvilluan në organizata tjera ilegale. Këtë më së

²⁵ Këshilli Popullor i Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë, 1943-1953, Prishtinë 1954, 46-48.

²⁶ *Rekapitulimi i UDB-es pas vitit 1947*. Dr. Muhamet Pirraku, *Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945*, Prishtinë 1992, f.160

miri e dëshmon, edhe lufta e fundit e UÇK-së²⁷, që ishte një rezultat dhe një vazhdimësi e të gjitha organizatave patriotike atdhetare që u zhvilluan në Kosovë.

*Ndikimi i veprimtarisë së NDSH-së në kohën
kur veproi dhe më vonë*

Në kohën kur veproi ONDSH, ishte njëra ndër organizatat që bëri buj në vend dhe jashtë saj. Anëtarët e saj ishin të lidhura ngushtë me përfaqësitë e shteteve perëndimore me të cilat mbanin kontakte të vazhdueshme dhe i njoftonin me situatën politike në vend dhe për padrejtësitë e shumta që bënte pushteti jugosllav ndaj shqiptarëve. Të kujtojmë vetëm letrat e Prof. Ymer Berishës me Gjeneralin Hadson²⁸.

Ndërsa pas zbulimit dhe arrestimit të anëtarëve të saj nga ana e organeve të ndjekjeve, edhe pse OZNA²⁹ trumbetonte se i kishte zbulua të gjithë anëtarët e saj megjithatë ajo asnjëherë nuk mundi ta zhdukte dashurinë e madhe ndaj atdheut dhe synimin për bashkimit kombëtar tek shqiptarët, por ajo si një prush qëndroi e ndezur në zemrat e njerëzve, dhe si produkt i saj lindi Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

²⁷ Sabile Keçmezi-Basha, Formimi dhe veprimtaria e Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare, Kosova 18/19, Prishtinë 1996, 171-184

²⁸ Qerim Lita, "REFERAT PËR KOMITETET NACIONAL DEMOKRATIKE SHQIPTARE", Prishtinë 2009, 41-47

²⁹ UDB-a u lind nga paraardhësja e saj OZN-a (Odelenje za Zashtitu Naroda - Dega e Mbrojtjes Popullore), e cila u formua më 14 maj 1944 me vendim të Shtabit Suprem të UNÇJ-së. Ajo fillimisht ka vepruar në kuadër të seksionit të MP të KANÇJ-së. Ndërsa në Kosovë u formua më 1 shtator 1944. Të gjitha dokumentet e kohës flasin se OZN-a për Kosovë është formuar me kërkesën e "Komitetit Krahinor të Kosmetit" dhe të Komitetit Qendror të PKJ-së.

PËRFUNDIME

Bërthamën e forcave nacionaliste për formimin e Ushtrisë Demokratike Shqiptare e gjejmë diku në nëntor 1944. Pas formimit të Komitetit Suprem të Kosovës të Adem Gllavicës më 1 dhjetor 1944³⁰, lindi ideja që në çdo pjesë të Kosovës, aty ku jetojnë shqiptarët të formohen organizatat ilegale si dhe grupet më të vogla të ilegales shqiptare. Në vazhdim të këtij aktiviteti të lëvizjeve atdhetare, u formuan shumë organizata patriotike shqiptare, me një distancë kohore të caktuar, e, që manifestoheshin sidomos pas vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945. Në këto vite, nga populli i okupuar formohen organizatat më të fuqishme nacionaliste siç ishin: Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH), Besa Kombëtare (BK), Organizata nr.2³¹ dhe Këshilli i të Dymbëdhjetëve³² e disa të tjera më pak të njohura.

³⁰ Dr. Daut Bislimi, Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945, Prishtinë 1997. f. 228

³¹ Organizatën nr. 2, e formoi Ajeti Gërguri në prill të vitit 1945. Prej janarit të vitit 1946, quhet edhe me një emër të ri “Shtabi i Zonës II-të LPLTSH. Gjatë tërësve veprimtarisë së saj ishte e lidhur ngushtë me organizatën patriotike “Besa Kombëtare”. Anëtarët e kësaj organizate ishin njerëz të shquar të lëvizjes shqiptare si në fushën politike, ashtu edhe në atë luftarake. Për këtë arsye, kjo organizatë mori për detyrë përgatitjen e Kongresit të Lipovicës të LNDSH-së, të mbajtur më 25 korrik 1946 në malet e Lipovicës.

³² **Në Kuvendin e Dobërdolit**, u zgjodhën udhëheqësit e sektorëve sipas parimit territorial. Duke mos lënë anash as udhëheqjen ushtarake e politike të sektorëve. Pasi se Kosova në këtë Kuvend u nda në 12 sektorë, andaj ishte krejt e natyrshme të caktohen komandantë dhe po aq komisarë politikë. Ky grup i përbërë prej 12 komandantëve e komisarëve politikë u quajt “Dymbëdhjetë Këshilltarë” apo “Këshilli i të dymbëdhjetëve”.

*QERIM LITA**Studiues, Shkup*

ORGANIZIMI DHE MBAJTJA E KONGRESIT II (IV) TË NDSH-SË NË SHKUP

Në përputhje me programin politik, të hartuar nga Mahmut Duman, Azem Marana dhe Hasan Bilalli, Organizata Nacional Demokratike Shqiptare në Shkup (më tej ONDSH), gjatë tërë vitit 1945 zhvilloi një aktivitet të gjerë e të gjithanshëm. Ndër pikat më të rëndësishme të programit politik të NDSH-së, ishin: a) Lidhja sa ma e shpejtë me organizatat simotra në Kosovë dhe Shqipëri; b) propagandimi dhe zgjerimi i organizatës në trevat shqiptare të Maqedonisë; c) lidhja e organizatës me forcat e armatosura shqiptare që vepronin në këto hapësira; ç) përfshirja e intelektualëve dhe nacionalistëve shqiptarë në organizatë; d) inkuadrimi i anëtarëve të NDSH-së në administratën shtetërore në të gjitha nivelet sidomos në arsim, armatë dhe polici; dh) zhvillimi i një fushate në popullatën shqiptare, e cila do t'i përkushtohet arsimimit shqiptar, etj.³³

Që në fillim duhet të vëmë në pah, se veprimtarët e NDSH-së në Shkup, hasën në shumë probleme e vështirësia, sidomos nga disa elemente orientale, të cilët me ndihmën e pushtetit, bënë fushatë të madhe kundër hapjes së shkollave shqipe në Shkup e më gjerë. Ja se si e përshkruante në hetuesi kryetari i “Juxhel”-it, Shuaip Aziz, fushatën antishqiptare gjatë vitit 1945 në Shkup: “Në vitin 1945 shqiptarët zhvilluan një fushatë të madhe që thuajse të gjithë fëmijët mysliman të shkojnë në shkollat shqipe. Si kundërpërgjigje të kësaj, unë (Shuaip Aziz – Q. L.) së bashku me Refik Sherif, mësuesi Sherafedin, Ali Abdurahman, Fetija Sulejmanpashiq, gjatë bisedës

³³ ДАРМ. 1. 1101.6. 3./12-18; ДАРМ. Ф. Војни историски Институт (мë tej ВИИ), М. 349, Реферат о Националним Демократик Комитетима.

vendosëm ta pengojmë atë aktivitet të shqiptarëve, me atë se do të flasim në Çarshi se secili që e ndien veten turk, le të ngelë si i tillë dhe fëmijët t'i dërgoj në shkollat turke. Këtë vendosëm ta zbatojmë secili përmes miqve dhe dashamirëve të vet. Si rrjedhojë e kësaj propagande u krijua një urrejtje e madhe midis nesh, që ndiheshim si turq, dhe shqiptarëve”³⁴.

Një deklaratë e tillë e dhënë nga kryetari i Juxhel-it, e hedhë poshtë thënien e deritanishme, se Juxhel-i ishte organizatë simotër e NDSH-së, dhe se Shuaip Aziz, si “mik i vjetër” i mulla Idriz Gjilanit, lidhi NDSH-në me konsullin turk në Shkup Emin Vefa Geçek³⁵. Këtë e shohim edhe në letrën me titull “Pikëpanjjet e rinisë shqiptare në Shkup”, që KQ i NDSH-së, e dërgoi në janar të vitit 1946, deri te konsulli i Republikës së Turqisë, Emin Vefa Geçek, e cila në fillim përshkruhej gjendja e mjerueshme e shqiptarëve të robëruar nga klika komuniste jugosllave e më gjerë, ku shprehimisht në të thuhej: “..në Ballkan disa qindra mijëra shqiptarë jetojnë nën robërinë, që të mund ta fitojnë lirinë përfundimtare luftojnë në planin politik dhe shoqëror. Kjo rini shqiptare me dashuri dhe zemër është e lidhur me popullin heroik turk. Nuk e dimë se a ka nevojë t'i nënvizojmë? Rinia shqiptare nga Kosova, Presheva, Kumanova, Shkupi, Tetova, Gostivari, Dibra, Struga, Ohri, Kërçova, Manastiri dhe qytetet tjera. Vëllezërit tanë myslimanë që të arrijnë deri te liria, besojnë se me idenë shqiptare mund të arrihet kjo. Shkupi, që është kryeqendra e Kosovës, të gjitha fshatrat e këtij qarku janë në të njëjtën ide”. Në vazhdim të letrës, udhëheqja e NDSH-së, i ankohej konsullit turk, për aktivitetin antishqiptar nga ana e disa krerëve më me ndikim turk në Shkup, të cilët “me apo pa vetëdije, ata i shërbejnë dhe japin mundësi që popullsia të përçarhet”. “Këta vëllezërit tanë”, thuhet më tej në letër: “shpeshherë i

³⁴ ДАРМ. 1. 885. Пов. стр. пов. бр. 167, Записник од саслушањето на Шаип Азис Исак, скопје 15. 08. 1947 г., Скопје.

³⁵ Dr. Muhamet Pirraku, Mulla Idrizi Gjilani dhe mbrojtja popullore e Kosovës Lindore 1941-1951, Prishtinë 1995, fq. 320.

kemi këshilluar që të bashkohemi dhe të punojmë për një qëllim dhe të krijojmë një vëllazëri të madhe e të vetme shqiptaro-turke dhe të sigurohemi nga cilido rrezik qoftë....Për këtë bëmë përpjekje të shumta, mirëpo të gjitha përpjekjet tona i kanë refuzuar...". Letrën udhëheqja e NDSH-së e përfundon si vijon: "Ja pas refuzimit të tyre, ne mendojmë se rruga jonë është e drejtë dhe duke i marrë parasysh të gjitha rreziqet, ne shkojmë me hapa të vështira për qëllimin tonë. Se ideja jonë është e drejtë, besojmë se edhe Ju do të pajtoheni dhe jemi të bindur se Ju me idetë tuaja idealiste, do të na jepni një mbështetje morale që të mund të mbijetojmë me këshillat tuaja të mira. Ne obligohemi se direktivat tuaja do t'i zbatojmë pikë për pikë"³⁶.

Pranvera e vitit 1946, solli freski në veprimtarinë politike e organizative në udhëheqjen e K.Q. të NDSH-së. Gjithsesi, meritë për këtë do të kenë anëtarët e organizatës nga Shkupi që i prinin Azem Marana, Hasan Bilalli, Qemal Skënderi, Mexhit Zyberi, por edhe veprimtarët tjerë që vepronin në tërë trevat shqiptare, intelektualë dhe nacionalistë të njohur shqiptarë si: Gjon Sereçi, Halim Orana, Kapiden Hysni Rudi, Mehmed Bushi, Hamdi Berisha, Qeram Zllatku, Jetish Vishi, Nexhmedin Besimi, Xhevair Shaqiri, Jonuz Balla, Ajet Gërguri, Muharrem Bajraktari, Sefedin Shabani, Mulla Haki Taibi e shumë e shumë të tjerë.

Në fillim të muajit prill 1946, në Shkup vjen Gjon Sereçi, i cili mbajti një takim të rëndësishme me Azem Maranën dhe Hasan Bilallin. Për ardhjen e Gjonit në Shkup, Azemi u njoftua prej Hamdi Berishës, i cili kohë më parë për shkaqe sigurie, ishte vendosë në këtë qytet të lashtë shqiptar. Gjatë bisedës së zhvilluar kanë rënë dakord që: të bëhet riorganizimi i NDSH-së, respektivisht themelimi i komiteteve nëpër qytete dhe komiteteve që do të veprojnë nëpër fshatra; bashkëpunimi i K.Q. të NDSH-së në Shkup me komitetin e Barit dhe me Zonën-I në Greqi; bashkëpunimi me forcat

³⁶ ДАРМ. 1. 885. Пов. стр. Пв. Бр. 175, Скопје, 2.1.1948 год. Скопје.

nacionaliste në Shqipëri; të vazhdohen kontaktet me konsullatën angleze dhe ate turke në Shkup; kalimin e Gjon Sereçit në ardhjet e armatosura që vepronin në malet e Kosovës, ku K.Q. i NDSH-së kërkoi që Gjoni të vendosej në rajonin e Bujanocit “Guri i zi”, që do të konsiderohej si mision i Gjon Sereçit për t’i penguar forcat drazhiste të mos kalonin nga Serbia në Kosovë. Për çështje sigurie, në të ardhmen të komunikojnë me pseudonime: Gjon Sereçi – “Kthetra”, Azem Marana – “Kushtrimi”, Hasan Bilalli – “Iliri”, ndërsa Sefedin Shabani nga Ferizaji u zgjodh që në të ardhmen të jetë lidhja e Gjosit me Azemin i cili do të njihej si “Dula”.³⁷

Në ndërkohë K.Q. i NDSH-së dërgoi Mehmet Breznicën në Shqipëri dhe Greçi, i cili duhej të përcillte informacione reciproke, e që kishin të bënin me punën dhe aktivitetin e mëtejshëm të K.Q. të NDSH-së³⁸. Mehmet Breznica nga Shqipëria kthehet bashkë me Gani Ndreun (djali i Cen Elezit, që në atë kohë punonte si përkthyes i misionit anglez të vendosur në Tiranë). Në bisedimet që u zhvilluan mes anëtarëve të Komitetit Qendror dhe Gani Ndreut, ky i fundit i njoftoi të pranishmit se krerët nationalist shqiptarë në krahinën e Dibrës dhe të Lumës, pas një takimi që kanë pasur me ndërmjetësimin e anglezëve, kanë vendosur të dalin në mal. Për krahinën e Dibrës përgjegjës janë Cen Elezi dhe Ukë Cami, për Kalanë e Dodës Osman dhe Zenel Lita, kurse për rrafshin e Lumës Muharrem Bajraktari. Këta udhëheqës në mal qëndronin me forcat e tyre të armatosura dhe pas një ndihme që do të vinte prej anglezëve, do të shpallnin kryengritje të përgjithshme kundër regjimit totalitar të Enver Hoxhës.

Duke e pas parasysh se interesimi për organizatën sa vinte e zgjerohet, Azem Marana, Hasan Bilalli, Qemal Skënderi dhe Mexhit

³⁷ ДАРМ.Ф. УДБ-РСВР. Д.198, док.9, 18. 09. 19460 год., л. 10; ДАРМ - по-
aty, Д. 5113 - по-aty; ДАРМ.1.1101.6.12/523-576

16 ДАРМ.1101.6..3./ 593-599; Ismet Dërmaku – “Gjon Sereçi dhe NDSH-ja (Dokumente arkivore)”, Prishtinë, 1996, fq.145-151


³⁸ ДАРМ-по-aty, стр.12-18; Globi, по aty; Нова Македонија, 27. 1.1947 год., стр.1-4.

Zyberi kah mesi i prillit mbajtën një mbledhje konsultative. Mbledhja u mbajtë në lokalin e Mexhitit në të cilën është vendosë që në të ardhmen lidhjet me Kosovën ti mbajë Hasan Bilalli, Azem Marana për Tetovë dhe për viset tjera shqiptare në Maqedoni, Qemal Skënderit si detyrë ju dha që të kontaktoj vetëm me çetat, me atë që lidhjet tjera që i kishte deri në atë kohë tua dorëzonte shokëve, ndërsa Kumanova me rrethinë ju dha Mexhit Zyberit.³⁹ Ky vendim si duket është marrë për shkak se në atë kohë Qemal Skënderi, kryenëvete do të dërgoj disa njerëz të dyshimtë në Drenicë, me detyrë që të formojnë komitete nëpër fshatrat e Drenicës. Këtë informatë në Shkup e solli Gjon Sereçi, i cili nëpërmjet një korieri të besueshëm i dërgonte një letër të shifruar Azem Maranës. Në të përveç tjerash Sereçi shkruante se te ai: “ka arrdhë një doktor⁴⁰ i cili bënë organizimin e komiteteve kryenëvete dhe thot se mban lidhje me Shkupin...”⁴¹

³⁹ ДАРМ.Ф.УДБ-PCBP.Д.5113, po-aty:

⁴⁰ Hamit Emini: I lindur në vitin 1910 në Novi Pazar, familja e tij gjatë viteve 20-të të shekullit të kaluar emigroi në Shqipëri, përkatësisht në Shkodër. Gjatë Luftës së Dytë Botërore është kyçur në aradhet partizane shqiptare. Meqenëse se me profesion ishte infermier ai më vonë angazhohet në brigadën e tetë partizane shqiptare si ushtrues i detyrës mjek. Me të njëjtën brigadë e cila ishte në kuadër të divizionit të gjashtë shqiptare vjen në Kosovë. Në gusht të vitit 1945, Hamiti demobilizohet mirëpo nuk kthehet në Shqipëri, sepse në mungesë të kuadrove ai angazhohet si ushtues i detyrës mjek në Ferizaj. Në rrethana të panjohura ai në prill të vitit 1946, në Shkup takohet me Qemal Skënderin, i cili e angazhon atë që të shkoj në Drenicë për të themeluar komitetet e NDSH-së. Këtu ai nuk pranohet mirë nga Gjon Sereçi dhe Ajet Gërguri, me çka sërish kthehet në Shkup për tu takuar me Qemalin. Ky i fundit i shkruan një letër në emër të KQ të NDSH-së, në të cilën thuhej se Hamit Emini autorizohet nga KQ i Shkupit që të themeloj komitete në Drenicë. Si në takimin e parë ashtu edhe në të dytin, nuk kishin as çfarë njohurie Azem Marana dhe Hasan Bilalli. Kjo shkaktoi huti, me çka pason letra e Gjon Sereçit, i cili do të kërkoj sqarim nga KQ i NDSH-së, lidhur me Hamit Eminin. ДАРМ.1.1101.6.12/579-640.

⁴¹ ДАРМ.Ф.УДБ-PCBP.Д.198, po-aty: në deklaratën e sipërmendur Azem Marana thotë:




Çelësi i deshifrimin të letrave që Gjon Sereçi ia dërgonte Azem Maranës

Njëkohësisht edhe Hamit Emmini nëpërmjet një letre e njoftonte Qemalin se në Drenicë: “qëndron një profesor i cili pohon se mban lidhje me Shkupin”⁴². Për rrjedhojë, pasi u konstatua se Hamit Emmini kishte marrë direktiva nga Qemal Skënderi, në mbledhje u morrën qëndrimet e sipërpërmendura, me atë që Azem Marana nëpërmjet një letre do ta njoftonte Gjon Sereçin, se Hamiti është i dërguar nga KQ i NDSH-së, dhe se ata duhet të bashkëpunojnë⁴³.

⁴² Po-aty

⁴³ ДАРМ-одделение Скопје. 1,81.8/



Letra e shifruar e Azem Maranës dërguar Gjon Sereçit në të cilën kërkohet që të bashkëpunojnë me Hamit Eminin i cili mbante notkën "Doktori"

Sido që të jetë, në atë periudhë anëtarët e K.Q. të NDSH-së do të zhvillojnë aktivitete të njëpasnjëshme. Shpejt atyre do t'u vijë në ndihmë kapiten Hysni Rudi. Burimet e OZN-ës, bëjnë të ditur se Hysni Rudi në Shkup, arrin me 30 janar 1946, dhe se menjëherë me ndërmjetësimin e Hamdi Berishës, lidhet me Azem Maranën, Gjon Sereçin, Qemal Skënderin, ndërsa më vonë edhe me Halim Oranën.⁴⁴

Hysni Rudi në Shkup erdhi nga Korça, ku deri në atë kohë qëndronte si instruktorë i divizionit të V dhe VI shqiptar⁴⁵. Pas sugjerimit të Gjon Sereçit dhe të Azem Maranës, në prill të vitit 1946 vendosi ta braktis ushtrinë jugosllave dhe në tërësi do t'i përkushtohet organizimit sa më të mirë të NDSH-së. Kontributi i

⁴⁴ ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.Д.46000246, САСЛУШАЊЕ, за лице. Хусни Руди, рацено на 30.VII.1946 год., Призрен.

⁴⁵ Po-aty

tij do shpaloset veçanërisht në organizimin ushtarak për çka ishte edhe i specializuar⁴⁶. Aftësitë e tij profesionale, energjia dhe, mbi të gjitha vendosmëria, ishin shkaqet kryesore që K.Q. i NDSH-së ta parashihte personalitetin e tij si komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura të LPLTSH-së.⁴⁷

Në fund të muajit prill K.Q. i NDSH-së përpiloi një proklamatë, e cila kishte të bënte me propagandimin e organizatës, ushtrisë së saj dhe qëllimin final të NDSH-së. Teksti i proklamatës përmbante 9 pika:

1. K.Q. i NDSH-së ka për qëllim që të luftojë për vendin tonë që gjendet nën kthetrat jugosllave.
2. K.Q. i NDSH-së është formuar të mbrojë të drejtat e popullit shqiptar dhe është formuar vetëm për shqiptarë.
3. K.Q. i NDSH-së do të luftojë kundër sllavizmit si dhe kundër atyre që nuk janë asgjë tjetër pos të vjetrit, vetëm që tani janë veshur me lëkurë qengji.
4. Çdo shqiptar që gjendet jashtë kufirit duhet të ketë lidhje me ne. Atëherë, në harmoni me mundësitë të formojnë qeverinë shqiptare etnike, prandaj për këtë arsye të gjithë duhet të punojnë me ne.

⁴⁶ Hysni Rudi akademinë ushtarake e kishte kryer me sukses të shkëlqyer në Itali në vitin 1942, duke e fituar gradën toger. Me t'u kthyer në Kosovë, emërohet komandant batalioni i forcave vullnetare të "Lidhjes II të Prizrenit". Pas mbarimit të Luftës II Botërore, Hysni Rudi u inkadrua në radhët e Armatës jugosllave, fillimisht në kazermën ushtarake në Prizren si zëvendëskomandant, ndërsa me urdhër të shtabit operativ për Kosovë, në dhjetor të vitit 1944 komandant i garnizonit në Istok. Në mars të vitit 1945, ftohet në Prishtinë që të formoj artilerinë ushtarake në Kosovë. Deri në qershor të këtij viti që komandant i divizionit të artilerisë në Prishtinë dhe Pejë, ndërsa nga qershori i vitit 1945 angazhohet si instruktor në divizionin e V dhe VI shqiptar, fillimisht në Ohër, ndërsa më vonë në Korçë. ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.Д.46000246, Саслушање Хусни Рудија, бивш капетана албанске војске, рацено дана

⁴⁷ ДАРМ.1.1101.6.12/577-640; Globi, po aty, num. 7.

5. Shqiptarë, ndihmojeni NDSH—në nga se ajo lufton për të drejtat tuaja. Mos lini asnjë qytet e as një fshat pa e përfshirë në organizatë.
6. Shqiptarët, Lufta e Tretë Botërore është në prag të derës prandaj të jemi të gatshëm që mos të na gjejë të paorganizuar.
7. Shqiptarë, shkatërroi tradhtarët që ua kanë shitur vendin, i cili tani gjendet në kthetrat e Jugosllavisë. Luftoni kundër spiunëve që po luftojnë për interesat e tyre vetjake.
8. Shqiptarë, mos kini frikë si gjatë kohës së Italisë dhe Gjermanisë, se me ne është i tërë blloku perëndimor.
9. Shqiptarë, fitorja është e jona prandaj vetëm vetëm organizoni komitete dhe ndihmoni vëllezërve tuaj që gjenden në mal.

Rroftë, rroftë Komiteti Nacional Demokraci, rroftë ata që po luftojnë në mal, rroftë Shqipëria etnike, rroftë Blloku perëndimor, poshtë gjakëpirësit shqiptarë, që kanë pirë gjakun e bijve më të mirë të popullit shqiptarë.

Poshtë ata që luftojnë për interesat vetjake! Poshtë tradhtarët shqip-tarë, siç janë Fadil Hoxha, Mehmet Hoxha dhe Rifat Berisha!⁴⁸

Këtë proklamata Hysni Rudi ia dorëzoi Gjon Sereçit, i cili siç u tha më sipër në Shkup erdhi për së dyti herë në festat e pashkëve.⁴⁹ Po këtë proklamata Gjoni e dërgoi në Prishtinë, konkretisht pranë komitetit rinor të NDSH—së për Prishtinën, të cilën duhej ta shumëfishonin dhe ta shpërndanin në popullatë⁵⁰.

Në fillim të muajit maj Azem Marana i bëri një vizitë pune Kosovës. Ai së pari ndalet në Prishtinë, ku informohet për

⁴⁸ Qerim Lita. Po aty; Ismet Dërmaku. Po aty fq. 76; Daut Bislimi, Lidhja bashkëprimi midis komiteteve të organizatës së NDSH-së – kumesë e lexuar në sesionin shkencor në Shkup kushtuar 56 - vjetorit të Kongresit II (IV) të NDSH-së në Shkup – Shkup-1 qershor 2002.

⁴⁹ ДАРМ.Ф.УДБ-PCBP.Д.5113, po-aty.

⁵⁰ ДАРМ.Ф.УДБ-PCBP.Д.198.док.9.18.9.46 год. Скопје; ДАРМ. 1.1101.6.12/523-576; Ismet Dërmaku, po aty, fq. 157-158.

aktivitetet e Gjonit në mal, vrasjen e 6 ushtarëve shqiptarë në Zatriqë, si dhe për çështje tjera që kishin të bënin me organizimin e NDSH-së. Pas kësaj ai udhëtoi për Ferizaj, ku mbajti takime të ndara me Abdulla Musliun dhe Sefedin Shabanin – Dula. Gjatë bisedës që kanë pasë Azemi me Sefedinin (i cili ishte kryetar i K. NDSH-së për Ferizaj), përveç tjerash është vlerësuar puna dhe organizimi i shkëlqyeshëm që po bëhej në Komitetin e NDSH-së të Ferizajit, dhe se me këtë dinamikë duhet të veprohet edhe në komitetet tjera. Në fund të bisedës, Azemi e angazhoi Sefedinin që të interesohet për ngjarjet e Zatriçit, vrasjet e 6 ushtarëve shqiptarë, për këtë të informohet K.Q. i NDSH-së nëpërmjet korrierit Sali Aliu⁵¹.

Në kohën kur K.Q. i NDSH-së, ishte në vrullin e aktiviteteve politike, organizative dhe ushtarake, OZN-a ndiqte në hap punën e saj. Me kërkesë të saj, Byroja Politike e K.Q. të PKM-së me 13 maj 1946 mbajti mbledhje të zgjeruar ku morën pjesë: anëtarët e Byrosë Politike, sekretarët e komiteteve të rrethit dhe ai vendor i Shkupit, udhëheqësit e OZN-ës dhe instruktorët e K.Q. të PKM-së. Qëllimi i kësaj mbledhjeje ishte situata politike në Maqedoni, ku përfaqësuesit e OZN-ës kanë raportuar për gjendjen e sigurisë në shtet. Kryeshefi i OZN-ës për rrethin e Shkupit, Tote, gjatë diskutimit vuri në dukje se: "Më e komplikuar është pyetja për shqiptarët, janë kryer burgosje të një pjese jatakësh në Kumanovë. Atje janë lidhë me Shqipërinë e vjetër – Sula ka pranuar letër dhe interesohet për armatën tonë. Kanë bërë përpjekje që nëpërmjet një organizate të paraqiten – duke emëruar një oficer. Qëndrim – të mos shkohet në ushtri, në anën tjetër, popullata shqiptare ka besim të plotë ndaj Sulës dhe disa anëtarëve të Këshillit popullor. Kështu që secili çoban apo fshatarë dinë për lëvizjen e bandave, mirëpo nuk i tregojnë pushtetit. Ndaj frontit dhe pushtetit qëndrojnë anash...!"⁵² Tote, në vazhdim të diskutimit e paraqiti situatën në Dibër, që sipas

⁵¹ ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.Д.198, док..9, ро-ау.

⁵² ДАРМ. 1.427 – 1.73/380-399

tij: “Në Dibër, dalja e Cenë Elezit në Shqipëri ka jehonë të madhe, kështu që rrethet reaksionare në gjithë rrethin e Dibrës kanë filluar të lëshojnë lajme se Cen Elezi ka dalë në mal me direktivën e anglezëve, se si te djali i tij bashkëpunon me anglezët etj. Me këtë ata dëshirojnë t’ju japin kurajo elementeve reaksionare, që ta shohin me simpati dhe shpresë nga dalja e Cenë Elezit ...!”⁵³.

Përfaqësuesi tjetër i OZN–ës, Zllate, paraqet situatën në Shkup, i cili përveç tjerave u shpreh: “Elementet shqiptare dhe turke ku te ne i ka në Shkup, paraqet një ndër problemet më të rëndësishme. Edhe te ata po vërehet ringjallje, dhe ndryshimi i parullës së tyre që më parë ishte bojkotim i pushtetit, ajo tani është sa më shumë të futen në organizatat politike, sa më shumë të futën në aparatin shtetëror. Tani parulla e tyre është asisoj se “Jemi myslimanë” dhe se shqiptarë ka më shumë popullatë, prandaj duhet të kenë rolë udhëheqës, në Maqedoni ka 300.000 banorë që duan t’i bashkohen Shqipërisë, andaj turqit duhet t’ju ndihmojnë sepse ata nuk kanë kushte si shqiptarët ...!”⁵⁴.

Është interesant të theksohet diskutimi i një përfaqësuesi tjetër të OZN–së me nofkën “Darko”, i cili e paraqet situatën në rajonin e Kumanovës, ku ndër të tjera theksoi se: “Pakica shqiptare te ne paraqet problem. Ne në të gjitha ata fshatra shqiptare kemi këshilla të pushtetit, këshilla të frontit, kemi gjithashtu fakte, asi fakte të shumta që ato këshilla i vendosin ballistët prej një vendi në vend tjetër. Dhe të gjithë ato këshilla nuk janë asgjë tjetër vetëm se këshilla balliste ...!”⁵⁵.

Kjo mbledhje zgjati dy ditë ku folën Llazar Kolishevski, Kërste Cërvenkovski dhe shumë të tjerë, në mesin e tyre edhe Qemal Sejfulla, i cili gjatë diskutimit paraqiti kritika të ashpra kundër Bashkësisë Fetare Islame, përkatësisht drejtorinë e Vakëfit, ku

⁵³ Po aty

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Po aty.

shprehimisht deklaroi: “Vakëfin” e mbajnë shqiptaromëdhenjtë: ndër ta ka njerëz, llo-lloj deputetësh të vjetër nga Kaçaniku, të cilët kanë dëshirë të jenë autoritarë ndaj myslimanëve të Shkupit ... Te ne pra kemi një grup tjetër, me baza fetare, dhe ai është grupi i Atulla Hoxhës. Ky grup paraqet sektin që e njohin të gjithë në Shkup. Shef i grupit të tyre është Atulla Hoxha, aga Rizë sekretar politik i Atulla Hoxhës, Feta Raufi është këshilltar i tij... Atulla Hoxha thekson: “Mua nuk më nevojiten shumë njerëz, më mirë të jenë më pak por të jenë të gatshëm të vdesin për fenë. Po kështu në Shkup kemi njerëz të mjerë, hoxhallarë të mjerë, tridhjetë deri dyzet vetë, të cilët me të vërtetë janë të ndarë prej Atulla Hoxhës dhe Zenelit, hoxhallarë të mjerë të cilët jetojnë prej 1000 denar pagë. Këta hoxhallarë kanë xhematë, janë tani të hidhëruar me “Vakëfin” pse ata të “Vakëfit” marrin rrogë, kurse atyre nuk ju japin. Dhe tani ata kërkojnë ndihmë prej nesh, që ta marrin “Vakëfin” në duart e tyre, dhe nëse i shpërblejmë, nëse ju japim një sasi mjete, propozoj, sa për fillim, të jetë 50.0000 dinarë, atëherë ata hoxhallarë do ti fusim ndër sqetull...”⁵⁶.

Duke u bazuar në mbledhjen e 13 majit, të dhënat që i paraqiten përfaqësuesit e OZN-së, Byroja Politike e K.Q. të PKM-së me 28 maj 1945, shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në rajonet e krizës, në të cilat do të ndërmerren këto masa:

- a) Përforcimi i çështjes politike në përgjithësi, veçanërisht në rajonet e ndryshme.
- b) Përforcimin e udhëheqjes partiake në qarkun e Shtipit, Kërçovës dhe Gostivarit.
- c) Njëlloj të bëhet edhe në udhëheqësit e OZN-së në ato vende.
- d) Në vendet ku më së shumti paraqiten bandat armiqësore të merren masat më të rrepta administrative, të krijohen baza ushtarake që do ta mirëmbajnë popullata vendore, krijimi i policisë

⁵⁶ Po aty.

vullnetare, të ndërtohen istikame në kthesat dhe udhëkryqet dhe vendet më të rrezikshme, të shpërndahet armatim tek aktivistët e frontit popullor.

dh) Të merren masa për sigurimin e familjeve të dëshmorëve nga bandat balliste dhe bandat tjera.

e) Të përmirësohet udhëheqja e këshillave popullore, gjyqet dhe prokuroritë publike në ata vende.

Për të gjitha këta punë të shkruhet letër direktive deri tek organizatat partiake të rretheve ...!⁵⁷.

Në kushtet kur pushteti “popullor” maqedonas shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në trojet shqiptare të RP të Maqedonisë, duke i shtuar masat policor-ushtarake, administrative dhe partiake, ndaj K.Q. të NDSH-së dhe gueriljes shqiptare në përgjithësi. Në një situatë kur shqiptarët në Maqedoni gjendeshin nën trysninë e një shtetrrethimi në Shkup, saktësisht më 1 qershor 1946 mbahet Kongresi II (IV) i NDSH-së. Lajmin për mbajtjen e Kongresit në Shkup e solli Halim Orana, i cili pas vizitës që bëri në Bari të Italisë me 15 maj 1946 arriti në Shkup⁵⁸. Këtu ai takohet me Azem Maranën, Hysni Rudin dhe Qemal Skënderin. Pasi informohet gjerësisht për aktivitetin e deriatëhershëm të organizatës, të nesërmit ai udhëtoi për në Dibër, gjoja për mjekim në banjën e Banjishtit. Në fakt shkuarja e tij në këtë qytet shqiptar kishte të bëjë rreth themelimit të komitetit regjional të NDSH-së, për çka që më parë ai e kishte angazhuar Dr. Qeram Zllatkun, me të cilin njihej mirë nga koha e Luftës së Dytë Botërore kur ai ishte konsull i qeverisë shqiptare në Zagreb, ndërsa Qerami student i mjekësisë⁵⁹.

⁵⁷ ДАРМ. 1.427.1.2./4

⁵⁸ ДАРМ. Ф. УДБ-РСВР.Д.198.док.9, по-атy.

⁵⁹ ДАРМ.1.1101.6.16/325-399: Qeram Zllatku me 31 janar 1947, në pyetjen e kryetarit të gjyqit Panta Marina se çfarë bisede është zhvilluar mes tij dhe Halim Oranës në Dibër, ai jep këtë përgjigje: “Dy ditët e para folëm rreth shemës së organizatës. Ai filloi të më flas, prezent ishte edhe Osman Cami dhe Femi

Me 21 maj, në shtëpinë e Hysni Rudit takohen: Azem Marana, Qemal Skënderi dhe Hysni Rudi. Aty përveç tjerash është vendosur që Kongresi të mbahet me 1 qershor në Shkup. Kjo datë ishte caktuar për shkak se Halim Orana para se të nisej për në Dibër ia bënë me dije Rudit se në Shkup do të arrijë një apo dy ditë para 1 qershorit.⁶⁰ Përgatitjet e Kongresit i bënë AZEM MARANA, Hasan Bilalli, Qemal Skënderi, H. Mexhit Zyberi. Për çështjen e lokalit përsipër do ta merrte Qemali, ndërsa thirrjen e delegatëve Azem Marana, Halim Orana dhe Hysni Rudi⁶¹.

Punimet kongresi i filloi me 1 qershor 1946, në lagjen Serava të Shkupit, me rend dite: a) paraqitja e programit të NDSH-së, b) paraqitja e skemës së strukturës organizative të NDSH-së, c) leximi i tekstit të betimit, d) referati mbi gjendjen dhe nevoja e politikës ditore për kontakte të domosdoshme me misionet ushtarake dhe diplomatët anglo-amerikanë në Shkup dhe gjetiu dhe f) aktiviteti i lirë⁶².

Pjesëmarrës në Kongres ishin: Halim Orana, Azem Marana, Hasan Bilalli, Qemal Skënderi, të cilët përfaqësonin Shkupin, Jonuz Balla, përfaqësues i komitetit të Tetovës, Osman Cami, përfaqësues i komitetit të Dibrës, Haki Taibi, përfaqësonte komitetin e Gjilanit, Faik Këpuctari si delegat i komitetit të Prishtinës dhe kapiten Hysni Rudi⁶³. Pas himnit të organizatës së NDSH-së, nën drejtimin e Azem Maranës kongresi fillon punimet sipas rendit të ditës.

Referatin politik e lexoi Halim Orana në cilin veç tjerash thuhej: “Ky kongres që po mbahet sonte në Shkup, ka një rëndësi të madhe për organizatën tonë dhe për shqiptarët në përgjithësi, sepse

Ballçishta. ai filloi të flas për disa komitete që ekzistonin në Kosovë dhe në të gjitha viset me mbi 65% Shqiptar... Më pas më tha se në Shkup ekziston ndonjë organizatë me komitete.”

⁶⁰ ДАРМ.Ф.УДБ-PCBP.Д.5113, po-aty

⁶¹ Po aty, Д.198-po-aty.

⁶² Dr. Daut Bislimi – Një Vështrim Historik i Organizatës së NDSH-së-LpLTSH-së, Shkup 1997, fq.55

⁶³ ДАРМ.1.1101.6.12/523-576; ДАРМ.Ф.УДБ-PCBP.Д.5113, po-aty.

këtu do të shtrohen vendime shumë të rëndësishme për çështjen shqiptare, ku më i rëndësishëm është vendimi për luftën e pa kompromis për bashkëngjitjen e Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore me Shqipërinë. Organizata jonë do të ketë rol më të rëndësishëm nëse shpërthen lufta mes aleancës perëndimore dhe BRSS-së. Aq më tepër kur dihet se në Kroaci ekziston organizata për pavarësinë e Kroacisë, një gjë e tillë është edhe në Serbi e cila lufton për rrëzimin e sistemit dhe kthimin e sistemit të vjetër. Pasi ne jemi kundërshtarë të këtij sistemi, njësoj nuk duam të kthehet as Jugosllavia dhe mbreti, prandaj ne duhet të punojmë për organizatën që ta bëjmë bashkimin e shqiptarëve dhe formimin e shtetit demokratik shqiptar. Në rast se ky bashkim bëhet realitet, nuk duhet ta kthejmë Shqipërinë në shtet monarkik, por edhe udhëheqja e tanishme bolshevike duhet të largohet ... Ky është Kongresi i parë i lëvizjes për çlirim dhe bashkim të Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore me Shqipërinë, andaj në të ardhmen nuk duhet ta quajmë “Lëvizje nacionale demokratike shqiptare”, por vetëm si “Lëvizja për çlirim dhe bashkim”, sepse në instancë të fundit kjo lëvizje do të përfshihet në gjithë territorin shqiptar...”⁶⁴.

Referatit të Halim Oranës, do t’i kundërvihen Qemal Skënderi dhe Hasan Bilalli, të cilët u shprehën se ky kongres nuk ishte i pari por i katërti, sepse Kongresi i tretë i NDSH-së është mbajtur në verën e vitit 1945, në Tanushë, në të cilin kanë qenë vetë të pranishëm. Kjo vërejtje është pranuar dhe është konstatuar se Kongresi i NDSH-së që mbahet në Shkup ishte i katërti sipas radhës. Kongresit do t’i drejtohet edhe Azem Marana, i cili pasi i informon për punën që e kanë kryer anëtarët e Komitetit Qendror deri në kongres, masës do t’i drejtohet me fjalët: “Vëllezër të dashur, tek ne ekzistojnë një grupe që vetveten e quajnë turq, të cilët të përkrahur nga pushteti, me të madhe po propagandojnë nëpër vendbanime shqiptare për turqizimin e tyre. Kjo propagandë më së shumti ndikon në qytetin e Shkupit, ku fatkeqësisht shumë shqiptarë nuk e

⁶⁴ ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.Д.198, док.9, ро-ау.

ndiejnë veten si shqiptarë. Mundësia e vetme për t'iu kundërvënë kësaj propagande është që të punohet sa më shumë me masën, duke e bindur atë se civilizimi i një populli varet se sa ai popull i jep rëndësi arsimit. Prandaj, duhet të insistojmë që sa më shumë të hapim shkolla shqipe, ku mësuesit shqiptarë do të udhëzohen që të punojnë me nxënësit e tyre për ngritjen e nivelit kombëtar...”⁶⁵. Kongresi do t'i paraqiten të gjithë pjesëmarrësit, që me diskutimet e tyre kontribuuan për përfundimin e suksesshëm.

Kongresi II (IV) i NDSH-së miratoi dy dokumente të rëndësishme për organizatën: “Skema e organizatës” dhe “Programi i Lëvizjes për lirin e tokave shqiptare”.

Skema e organizatës, parashihte: në çdo vend (qytet e katund) të formohet “komiteti i vendit për lirin e tokave shqiptare”; për koordinim pune mes këtyre komiteteve të vendit janë “komitetet eprore”; “komiteti epror” varet nga “Komiteti Qendror”. Të parët janë në lidhje me komitetet eprores e këta me komitetet qëndrues: çdo komitet formohet nga kryetari, sekretari, anëtari i parë, anëtari i dytë dhe përgjegjës të ndryshëm sipas nevojës; këta i ndajnë detyrat edhe përgjegjësinë sipas nevojës e zotësisë. Drejtimin e përgjithshëm e mban kryetari, i cili administron dhe zbaton urdhrat e komiteteve eprore; sekretari bashkë me dy anëtarët kanë shërbimin e propagandave të lajmeve, edhe si detyrë kryesore, ndërlidhjen, ashtu edhe shërbimin ekonomik dhe politik; shërbimit politik i takon kujdesia e posaçme. Për këtë çdo komitet formon një trupë nën emrin “SIP” (sigurimi politik). SIP-i ka për detyrë mbledhjen e informatave mbi personat e ndryshëm dhe heton sigurimin e mbarëvajtjes së veprimtarisë së komiteteve; komitetet e vendit veprojnë në marrëveshje në mes anëtarëve. Komitetet eprore kanë po këta persona; por nga shkaku se do të kenë më shumë

⁶⁵ Po aty

punë anëtarët do t'i ndajnë detyrat dhe në rast nevojë të formojnë seksione me referentë dhe përgjegjës⁶⁶.

Skema e organizatës është përgatitur prej Hysni Rudit, i cili e lexon para delegatëve dhe si e tillë njerëzit e kanë pranuar.⁶⁷

Dokumenti i dytë është programi i LPLTSH-së që përbëhej prej pesë pikave:

1. Liri dhe pavarësi të plotë me të drejtë vetëqeverimi në bazë të vullnetit të popullit të shfaqur lirisht.
2. Me trojet shqiptare kuptohen krejt vendet ku banojnë shqiptarë me 60%, pa dallim se si quhet krahina e vendi dhe nga është i pushtuar.
3. Lëvizja nuk ka qëndrim armiqësor kundër asnjë populli fqinj as kundër ndonjë partie politike, vetëm insiston në mënyrë kulturore dhe me armë do të përpiqet t'ia arrijë idealit shekullor të kombit shqiptar, që të jetë i lirë dhe vetësundues në shtet të vet me kufijtë etnikë.
4. Pasi të vendosen kufijtë etnikë, pa marrë parasysh tjera kushte të kufijve siç janë ato: strategjike, ekonomike, politike etj., në mënyrë miqësore do të shkëmbehet popullata e pakicave nacionale, duke i tërheqë shqiptarët që do të mbeten jashtë kufijve në vend të atyre që do të shpërngulen dhe do të përcillen jashtë.
5. Në kohë paqeje lëvizja nuk do të pushojë, por do të vazhdojë si shërbim roje i të drejtave të popullit shqiptar, si të atyre të brendshme, ashtu edhe të atyre të jashtme, ndërkombëtare duke u


⁶⁶ Arkivi i Kosovës. F. Gjyqi i Qarkut të Kosovës, Dos.Procesi gjyqësorë ndaj anëtarëve të NDSH-së në Gjiilan, Viti 1947, fl.1; Daut Bislimi – Një vështrim historik i Organizatës së NDSH-së-LpLTSH-së, Shkup 1997, fq. 56-57; Muhamet Pirraku. Vep. e cit. fq. 335, Qerim Lita.- Po aty.

⁶⁷ ДАРМ.Ф. УДБ-РСБР. Д.198, док.24.16.08.1946 год..л.2- Në deklaraten që e jep Azem Marana para hetuesisë me 16.08.1946, thekson se fjalimi i kapiden Rudit u pranua të jetë skema e organizatës – “Globi”. Po aty, num. 7 – Нова Македонија, po aty, 31.01.1947 год., стр. 3-4

organizuar për regjim me të vërtetë demokratik dhe për relacione miqësore me popujt fqinjë ballkanikë.

Nga Kongresi i katërt i Lëvizjes për lirin e tokave shqiptare.

Rroftë Shqipëria e vërtetë me kufijtë e saj etnik! ⁶⁸, përfundon programi.



Skema dhe programi i Lëvizjes

(Originali i dokumentit gjendet në arkivin e qytetit të Shkupit)

⁶⁸ ДАРМ-оделение Скопје.1.81.8/571, списи кои се однесуваат на доказната постапка и натамошното движење на казната против 2-ро обвинетиот Азем Идриз Морана, учител роден во село Моране околија Драчевска а живеел во Скопје; Архиви i Kosovës-po aty; ДАРМ.Ф. УДБ-РСВР.Д.198, док.9, po-aty.; Daut Bislimi – Vep. e cit. fq. 57-58, Muhamet Pirraku. Vep. e cit. fq. 335-337


Kongresi II (IV) të lëvizjes për lirimin e tokave shqiptare zgjodhi sekretariatit e Komitetit Qendror të NDSH-së: Halim Orana – kryetar, Qemal Skënderi – zëvendëskryetar, dhe Azem Marana – sekretar kurse për anëtarë të K.Q. u zgjodhën: Jonuz Balla, Mehmet Bushi, Hamdi Berisha, Hysni Rudi, Mahmut Dumani, Osman Cami, Medat Tërshana, Hasan Bilalli, Haki Efendi Hogoshi⁶⁹.

Në fund, punimet e Kongresit do t'i mbyllë Halim Orana me parullën: “Liria e shqiptarëve vdekja e tradhtarëve”, që ishte përshëndetje e “Ballit Kombëtar”. Dy dokumente që i solli Kongresi, që ishin në dorëshkrim, i mori Azem Marana, i cili i shtypi dhe i shumëfishoi në disa kopje, e më pas ua dorëzoi delegatëve, të cilët kishin marrë si detyrë t'i përcjellin në bazën e tyre për t'i njoftuar anëtarët e NDSH-së me vendimet e kongresit⁷⁰.



⁶⁹ ДАРМ.Ф. УДБ-РСВР.Д.198, док..24., ро-ау; Dr. Daut Bislimi. Vep. e cit. fq.55.

⁷⁰ По ату





Hasan Bilalli

SABIT SYLA & IZET MIFTARI

Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë

REZISTENCA KUNDËR RIPUSHTIMIT JUGOSLLAV TË KOSOVËS NË RAJONIN E SHALËS (1944–1947)

Regjioni i Shalës shtrihet në pjesën veriore të Kosovës, konkretisht përfshinë komunat e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe disa fshatra të komunës së Podujevës. Gjatë periudhave historike, vazhdimisht ka rezistuar në forma të ndryshme kundër pushtuesve të huaj, duke dhënë edhe kontribut të veçantë në çlirimin kombëtar. Me këtë rast, duhet përmendur: a) Vrasjen e konsullit rus, Grigorije Stepanoviq–Shqerbin, në Mitrovicë, më 1903⁷¹; b) Zonën Neutrale Dumnice– Zogaj gjatë viteve 1923–1924; c) Masakra e Zogorisë, më 10 shkurt 1924, me ç’rast u vranë 23 anëtarë të familjes së Mehmet Konjuh⁷², etj.

Vitet 1942–1944 ishin kohë kur shqiptarët kanë pasur mundësi për krijimin e organizatave politike dhe ushtarake me qëllim të bashkimit të trojeve shqiptare në një shtet. Andaj, sikurse në pjesët e tjera edhe në regjionin e Shalës, u formua Organizata Nacional Demokratike Shqiptare, qëllimi i së cilës ishte bashkimi kombëtar. Kështu, në veri të Kosovës, ku përfshiheshin: Mitrovica, Podujeva dhe Vushtri u themelua Komiteti Qarkor i ONDSH–së, të cilin e udhëhiqnin: Ferat Abit Novolani, Vehbi Bajraktari dhe Haki Mustafa. Deri në nëntor 1944 Komitetin në fjalë të ONDSH–së e kanë udhëhequr: Ferat Abit Novolani, Adem Voca, Jahja Maxhuni, Halit Çuka, Jakup Badivuku, Hysen Llapashtica, Ramiz Ali

⁷¹Jusuf Osmani, *Vrasje e konsullit rus në Mitrovicë*, Prishtinë, 2012; Izet Mifari, *Shqiptarët përballë invazionit pansllavist (Shekulli XIX - 1913)*, Prishtinë, 2013,

⁷²Grup autorësh, *Vushtrria-Vicianë me rrethinë*, Vushtri, 2003, 162.

Buçinca, Fejzullah Saraçi, Aqif Xhelili, Ajet Lahu, Imer Jashanica, Halil Osmani, Jusuf Shabani, Jonuz Zhilivoda, Muharrem Onbashiçi dhe Kasem Gërdovci⁷³. Të zgjedhurit e Komitetit të ONDSH-së, ishin betuar se “do të luftojnë me të gjitha mjetet kundër kolonizimit serb të viseve etnike shqiptare, kundër shpërnguljeve dhe dëbimit me dhunë të shqiptarëve nga trojet e veta stërgjyshore, kundër komunizmit, se deri në vdekje nuk do të lejojnë vendosjen e pushtetit çetnik dhe përherë do të përpiqen për ribërjen e Shqipërisë Etnike Demokratike, të tipit anglez”⁷⁴.

Me vendim të Sektorit Ushtarak të regionit të Shalës, komandantë Ahmet Selaci dhe Adem Voca, në bazë të Programit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, në shtatorin e vitit 1944 formohet edhe Komiteti i Rinisë Nacionaliste Shqiptare për Mbrojtjen e Tokave Shqiptare. Me këtë rast u themelua edhe Batalioni i të rinjve në Vushtrri, “Hasan Prishtina” me komandant, toger, Hamdi Abdurrahmani, dhe Kompania e Parë me komandant, Hilat Jakup Badivuku, Kompania e Dytë, me komandant Hajrullah Sunguri, Kompania e Tretë, Ahmet Dobërluka dhe Kompania e Katërt me komandant, Osman Maxhuni⁷⁵. Kështu, në këtë pjesë të trojeve shqiptare, u kundërshtua copëtimi i territoreve shqiptare, duke kundërshtuar në forma të ndryshme vendosjen e pushtetit komunist. Prandaj, ky region pa asnjë hezitim ju bashkëngjit LNDSH-së, duke organizuar mbledhje, kuvende, e luftime të ashpra kundër vendosjes së regjimit komunist jugosllav.

Kuvendet e LNDSH-së në Shalë të Bajgorës

Në fillim të muajit tetor 1944, në fshatin Kovaçicë, përkatësisht në odën e Ukshin Kovaçicës, ishte mbajtur një tubim, që njihet si

⁷³Ferid Dibrani, *Rrëfime për krimet serbe dhe qëndresën shqiptare 1*, Vushtrri, 2014, 77.

⁷⁴Hakif Bajrami, *Organizimi dhe veprimtaria e partisë Nacional Demokratike Shqiptare*, “Bujku”, 22 shkurt 1997.

⁷⁵F. Dibrani, *Vep. cit.*, 77.

Marrëveshja e Kovaqicës, dhe si qëllim parësor kishte pasur organizimin e luftës kundër brigadave çetniko-komuniste serbe e bullgare. Në këtë tubim, përveç të tjerëve, kishin marrë pjesë edhe: Ahmet Selaci, Adem Voca, Ukshin Kovaqica, Faik Boletini, Bislim Bajgora, Mulla Mustafa, etj. Ky kuvend, apo në këtë marrëveshje, ishte vendosur edhe formimi i brigadave vullnetare në regjionin e Shalës, si dhe lidhja e këtij regjioni me Llapin, Drenicën e Prishtinën⁷⁶. Një mbledhje tjetër e përmasave të mëdha ishte mbajtur edhe në verë të vitit 1945, ku kishin marrë pjesë rreth 400 delegatë, vendimet e së cilës kanë qenë: Vazhdimi i rezistencës kundër ripushtimit jugosllav të Kosoëvs, kundër administratës ushtarake të Titos; Organizimi sa më mirë i rezistencës; Identifikimi i spiunëve të pushtetit komunist; Zgjerimi i radhëve të rezistencës⁷⁷.

Në fillim të vitit 1945, përkatësisht më 22 janar 1945, u mbajt një kuvend, që ka hyrë në historinë e asaj treve, si Kuvendi i Vidishiqit. Në këtë tubim morën pjesë rreth 500 delegatë, me ç'rast, Adem Voca, ishte zgjedhur edhe komandanti i Brigadës së Rezistencës. Për nga pjesëmarrja e personaliteteve të kohës dhe vendimeve që ishin marrë, ka qenë një nga kuvendet më të rëndësishme në atë kohë⁷⁸. Të dhënat historike, na informojnë se është mbajtur edhe Kuvendi i Malit Gërdec në fshatin Dumnice e Epërme, në maj të vitit 1945. Nga të dhënat e hulumtuar në terren, u konstatua se në tubimin e Gërdecit, kanë marrë pjesë: Ajet Gërguri, Nazif Revuqi, Aziz Zhilivoda, Adem Bellaqefci, Ukshin Kovaqica, Osman e Shaban Bunjaku, Sherif Tëstena, Islam (Lam) Igrishta, Abdullah Mihaliqi, Fejzullah e Emin Saraqi, Hajzer Strofci, Mehmet Gradica, Bislim Bajgora, Sadri e Emin Bajgora, Hashim Lushta etj. Sipas dëshmitarëve të kohës, në këtë kuvend kanë qenë prezent rreth 300 delegatë. Në fillim të punimeve të kuvendit, ishte zgjedhur Kryesia

⁷⁶Fehmi Pushkolli, *Ukshin Kovaqica-Bajgora*, Prishtinë, 1997, 66; Fahri S. Buçinca - Ferid B. Dibrani, *Mizoritë serbe në Vushtrri me rrethinë (1918-1956)*, Prishtinë, 2009, 87 dhe 88.

⁷⁷Intervistë e Rexhep Igrishtës, dhënë Izet Miftarit në Vushtrri më 15.04.2016.

⁷⁸*Po aty*; F. Buçinca - F. Dibrani, *Vep. cit.*, 184.

e Punës e përbërë nga 33 anëtarë, me kryetar Ajet Gërgurin, praktikisht, udhëheqës të Kuvendit. Personaliteti që kishte ndikuar shumë që ky Kuvend të mbahet në Gërdec të Dumnicës së Epërme, ka qenë Bajram Miftari–Musliu⁷⁹.

Në Kuvendin e Gërdecit, flamuri kombëtar shqiptar ishte ngritur në shtëpinë e Bajram Miftarit, dhe më pas në një lis të madh në afërsi të oborrit të personalitetit në fjalë. Vazhdimisht, flamuri është ruajtur dhe janë bërë nderime kombëtare para tij. Në Gërdec ishte vendosur që të vazhdohet me rezistencën kundër pushteti komunist, dhe bashkimin e shqiptarëve në një shtet. Me qëllim të organizimit të rezistencës ushtarake, komandant ishte caktuar Aziz Zhilivoda⁸⁰. Në kuvend ishte vendosur që të vazhdohet rezistenca kundër pushtetit sllavo–komunist dhe të luftohej për bashkimin e trojeve shqiptare në një shtet. Punimet ky Kuvend i ka vazhduar disa ditë⁸¹. Duhet përmendur faktin se para se të ngrihet flamuri kombëtar dhe të mbahet Kuvendi i Gërdecit, në fshatin Dumnicë e Epërme, si përkrahës të mbretit Ahmet Zogu (kështu ishin paraqitur para popullit, S. S dhe I. M), kishin shkuar: Nexhmija, Faiku (burri i Nexhmijes), Vera, Shefqeti (burri i Verës), Muharremi (më vonë është vërtetuar se ka qenë në shërbim të OZN–së), Tefiku dhe Rizahi. Këto personalitete, që edhe sot nuk janë të identifikuar saktë se kush me të vërtetë kanë qenë, kishin sjell flamurin e shqiptarëve në Dumnicë të Epërme, dhe ishte ngritur në shtëpinë e Bajram Miftarit. Ky grup kishte qëndruar në Dumnicë rreth një muaj, dhe me prezencën e tyre ishte mbajtur Kuvendi i Gërdecit⁸². Pas përfundimit të punimeve të Kuvendit në fjalë, përkatësisht në muajin qershor 1945, Nexhmija ishte plagosur në Malin Gërdec. Për plagosjen e saj, ekzistojnë dy versione: se kishte plagosur rastësisht vetveten ose qëllimisht, në mënyrë që të largohej nga

⁷⁹Ferid Dibrani, *Rrëfime për krimet serbe dhe qëndresën shqiptare* (Monografi), Vushtri, 2014, 105.

⁸⁰Hilmi Saraqi, *Aziz Zhilivoda 1912-1994* (Monografi), Prishtinë, 2005, 92.

⁸¹Intervistë e Rexhep Igrishtës, dhënë Izet Miftarit në Vushtri më 15.04.2016

⁸²*Po aty*.

Dumnica dhe të dërgoj raportin e plotë në OZN, sepse veç i kishin identifikuar të gjithë kundërshtarët e regjimit komunist. Sipas rrëfimeve të dëshmitarëve të kohës, më i afërt është konstatimi se Nexhmija ka plagosur qëllimisht vetveten⁸³.

Vazhdimësi e kuvendeve dhe kongreseve të LNDSH-së ka qenë edhe Kongresi i Pestë (5) i Lipovicës (Lipijan), i mbajtur në korrik 1946. Krahas regjioneve tjera, në këtë Kongres ishte formuar edhe Divizioni i Ibrit, në kuadër të të cilit bënë pjesë këto zona: Shala, Drenica, Mitrovica, Vushtrria me rrafsh dhe Llapi e Novi Pazari. Divizioni i Ibrit ishte i ndarë në pesë brigada apo grupe, me komandant Ahmet Selacin⁸⁴.

Rezistenca për çlirim kombëtar

Gjatë viteve 1944–1947 në Shalë me rrethinë, janë zhvilluar luftime të rrepta ndërmjet forcave komuniste dhe atyre të LNDSH-së, si në fshatin Sumë (Vushtrri), në Lupq (Podujevë), në mes të fshatrave Dumnice–Samadrexhë dhe Zagorie (Vushtrri), në Bistricë–Vllahi (Mitrovicë), etj. Përshkrimin e Vocajve në Sumë kundër forcave komuniste jugosllave na e përshkruan Bajram Sherif Voca⁸⁵, nipi i Adem, Hetem dhe Jashar Vocës. Adem Voca bashkë me një grup prej shtatë vetash, ditën e 8 apo 9 shkurtit 1945 kaloi në fshatin Rashan në shtëpinë e Adem Rashanit. Grupi në fjalë kishte vendosur që në asnjë mënyrë të mos dorëzohen për së gjalli. Në grupin e Ademit bënë pjesë tre vëllezër dhe tre shokë të tij, gjithsej shtatë vetë: Adem Voca, Hetem Voca, Jashar Voca, Tahir Voca, Mon Ahmati nga Staritërgu, Ferat Ahmati dhe Abdullah Musliu. Në mbrëmjen e 8 apo 9 shkurtit 1945 grupi i Ademit vendoset në Sumë, në kullat e Vocajve. Posa forcat ushtarake komuniste, e kuptuan se Ademi me shokë ishte kthyer në shtëpinë e tij, menjëherë rrethuan shtëpinë dhe kullën e Vocajve në Sumë.

⁸³Po aty.

⁸⁴Vushtrria-Vicianë me rrethinë, 189.

⁸⁵Intervistë e Bajram Vocës, dhënë Izet Miftarit në Mitrovicë, më 12 shkurt 2003.

Komunistët jugosllavë kërkuar nga Ademi dhe grupi i tij që të dorëzohen. Mirëpo, Ademi e kundërshtoi kategorikisht një kërkesë të tillë. Pasi kishin dështuar përpjekjet – bisedimet për dorëzimin e grupit të Ademit, përfaqësuesit komunist kërkuar nga Ademi që të largojnë fëmijët dhe gratë nga shtëpia – kulla e tyre. Kështu, Ademi, Hetemi dhe Jashari larguan 26 anëtarët e familjeve të tyre nga shtëpia ku ishin vendosur. Pas kësaj rreth orës 12:00 të datës 10–11 shkurt 1945, filluan luftimet. Gjatë asaj dite, luftimet zgjatën deri në mbrëmje. Në këto luftime u plagosën Abdullah Zasella dhe Mon Ahmati. Grupi i Ademit, përveç disa bombave të dorës, posedonte vetëm pushkë (manxerka) dhe municion të mjaftueshëm për këto armë. Në mëngjesin e 11 apo 12 shkurtit luftimet përsëri rifilluan. Që në fillim të këtyre luftimeve vritet Hetemi. Ndërsa pak më vonë vritet edhe Ademi. Të ndodhur përpara një gjendje të tillë, pesë ushtarët e mbetur të grupit largohen rreth një kilometër larg nga Kulla e Vocajve. Gjatë tërheqjes së grupit, ushtarët jugosllavë kishin shtënë pandërprerë mbi ta. Fatbardhësisht nuk vritet as nuk plagoset asnjëri prej tyre. Posa arritën në Prnorin e Sumës, Moni nga plagët e marra më herët vdes. Pastaj, në përpjekje për të dalë nga përroi vritet Ferati. Më vonë vriten Tahiri dhe Abdullah Musliu. Nga të gjithë, arriti të shpëtoi vetëm Jashar Voca, edhe pse kishte pasur shtatë plumba në trup. Katër plumba i hoqi, ndërsa tre të tjerë i mbajti në trup derisa vdiq në vitin 1991. Në fund u dogjën edhe kullat e Vocajve, dhe kështu u shpartallua grupi i Adem Vocës. Familjet e të vrarëve i burgosën dhe i dërguan në Vushtrri, pastaj në Mitrovicë. Pas dy javësh lirohen dhe vendosen në shtëpinë e Bajram Vocës në Mitrovicë.

Në dimrin e vitit 1947, luftime të rrepta ishin zhvilluar përgjatë lumit Bistricë. Ukshin Kovaçica, përveç të tjerëve, kishte vrarë edhe komandantin e brigadës komuniste–çetnike, Vojo Jankoviqin. Sipas Rexhep Igrishtës (84–vjeçar, i cili në atë kohë ka qenë 13–vjeç, dhe që kishte shkuar për ta kërkuar babin e tij, Sherifin), luftimet ishin zhvilluar në shkurt të vitit 1947. Nga lumi Bistricë, luftimet qenë zhvendosur te Kërshi i Vllahisë (Bajgorë). Pas

luftimeve, më 19 shkurt 1947 kishin rënë heroikisht: Ahmet Selaci, Bajram Selaci, Mehmet Selaci, vëllezërit Hajrullah e Hetem Selaci, Qazim Selaci, Faik Boletini (djali i Isa Boletinit), Jusuf Boletini, kurse ishte plagosur rëndë Imer Selaci, i cili ja arrin ta çajë rrethimin. Ndërsa, më 20 shkurt 1947 vritet edhe Ukshin Kovaqica me të birin Hashimin, Bislim Bajgora dhe Smajl Sfarça⁸⁶. Pasditen e 20 shkurtit 1947, forcat pushtuese partizano-çetnike serbe para postës së qytetit në Mitrovicë do të ekspozojnë për shtatë ditë me radhë kufomat e kolosëve dhe prijësve të shqiptarizmit të rënë për lirinë e vendit.

Gjatë vitit 1947, ofensiva e forcave komuniste jugosllave për të zhdukur rezistencën e forcave antikomuniste, kishte arritur kulmin. Në kuadër të grupit që vazhdonte ende rezistencën antikomuniste ishte edhe grupi i Osman dhe Shaban Bujakut. Sipas shumë burimeve në këtë grup bënin pjesë rreth 20–25 vetë, si: Osman Bujaku (Samadrexhë), Shaban Bujaku (Samadrexhë), Hashim Basholli (Samadrexhë), Brahim Luta (oficer), Ajete Gjeli (Likoshan), Hajdin Haxhiu, Nebih Zasella, Rrahim Isa (Majac), Qamil Pakashtica, Qazim Pakashtica, Hazir Shala, Hashim Rama–Izmaku (Ceceli), Lah Rama–Izmaku (Ceceli), Bahtir Perçuku (Ceceli), Islam Igrishita (Dumnicë e Epërme), Bajram Tërbunja (Studime e Epërme), Rrahman Selaci (më i vjetri në grup), Hajriz Klina, Bejtë Perçuku (Ceceli), Avdyll Perçuku (Ceceli), Sejdi Gillobari (Krasniqi), etj. Të ndodhur para një gjendje jo të mirë, kur nëpër tërë territorin e Vushtrisë me rrethinë ishte vendosur pushteti i forcave komuniste, grupi në fjalë kalonte kohën më të madhe në Malin Gërdec në Dumnicë të Epërme. Për t'u mbrojtur më mirë në rast të ndonjë sulmi nga forcat ushtarake jugosllave, grupi i Osmanit dhe Shabanit kishte hapur dy bunkerë në fshatin Lupq i Epërm të Podujevës, në Malin Gërdec. Ushtria komuniste jugosllave kishte kuptuar për hapësirën se ku qëndronin ushtarët e grupit të Shabanit dhe Osmanit. Prandaj, për të saktësuar lokacionin e vendqëndrimit

⁸⁶A. Istrefi, *Vep. cit.*, 150.

të grupit në fjalë, ushtarët jugosllavë kishin torturuar dhe vrarë disa fshatarë të Majacit dhe Lupqit.

Posa morën vesh për vendqëndrimin e grupit të Osmanit dhe Shabanit, ushtarët jugosllavë menjëherë rrethuan atë vend. Kështu, më 13 shkurt 1947 filluan luftimet në mes të dy palëve. Që në fillim të luftimeve u vra Bajram Tërbuja. Ndërkaq, sipas Adem Izmakut⁸⁷, gjatë luftimeve në bunker kishte rënë edhe Bejtë Perçuku. Atë ditë luftimet kishin vazhduar deri në mbrëmje. Ndërsa, gjatë përpjekjeve për të larguar bombat nga dera e bunkerit ishte plagosur Shaban Bujaku. Kurse, sipas kujtimeve që ruhen në popull në këtë anë, nga ana e armikut kishte shumë të vrarë. Rreth orës 3:00 ose 4:00 të mëngjesit të datës 14 shkurt 1947, grupi i Osmanit dhe Shabanit filloi tërheqjen nga bunkerët në Lupq. Pas tërheqjes nga bunkerët e Lupqit, Osman Bujaku, Rrahman Selaci dhe Hajriz Klina, kishin shkuar për në Shalë të Bajgorës. Ndërkaq, Lah Izmaku, Bahtir Perçuku dhe Avdyl Perçuku, kishin qëndruar në malet e Cecelisë, kurse, Islam Ramë Igrishta nga Dumnica e Epërme ishte kthyer në shtëpi. Dhjetë (10) ushtarët e tjerë, që filluan tërheqjen për në Nermjetës, ishin: Shaban Bujaku, Hashim Basholli, Brahim Luta, Ajet Gjeli, Hajdin Haxhiu, Rrahim Isa, Qamil Pakashtica, Qazim Pakashtica dhe Hazir Shala. Me qenë se, gjatë tërheqjes së grupit, kishin mbetur gjurmët e gjakut që rridhte nga trupi i plagosur i Shaban Bujakut, atëherë, ushtria jugosllave përmes gjurmëve të gjakut mbi borë, kuptoi se ku ishin vendosur pjesëtarët e grupit në fjalë. Kështu, menjëherë i rrethuan dhe filluan t'i sulmojnë pjesëtarët e këtij grupi, të cilët ishin vendosur brenda në një "kështjellë" në Nermjetës (vend në mes tre fshatrave Dumnice, Zogaj dhe Samadrexhë, andaj quhet Nermjetës). Duke parë që përmes armatimit ekzistues nuk po arrini që t'i thyenin pjesëtarët e grupit, atëherë ushtria jugosllave morën topin ushtarak nga Shkupi. Kështu, filluan granatimet mbi shtëpinë ku ishin vendosur 10 ushtarët e Shaban Bujakut. Brenda në shtëpi, ishte

⁸⁷ Intervistë e Adem Izmakut, dhënë autorit, Izet Miftarit, më 8 shkurt 2002.

edhe i zoti i shtëpisë. Si pasojë e granatimit me anë të topit ushtarak, vriten 10 ushtarët që ishin me Shabanin dhe i zoti i shtëpisë, gjithsej 11 vetë. Më vonë u detyruan të dorëzohen në organet gjyqësore të Jugosllavisë së atëhershme Osman Bujaku (dorëzohet në Kqiq) dhe Islam Igrishta, i cili dorëzohet në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Të dy, me vendim të gjykatës së atëhershme u dënuan me vdekje – pushkatim. Pasi u shpartallua grupi i Shaban Bujakut, kishin mbetur edhe Lah Izmaku–Rama, Bahtir dhe Avdyl Perçuku. Kështu, Lahu dhe Bahtiri ishin vrarë në malet e Cecelisë. Kurse Avdyli ishte nxënë i gjallë nga forcat komuniste jugosllave, ishte dërguar në Prishtinë dhe kurrë nuk është ditur se si është pushkatuar dhe ku gjenden eshtrat e tij.

Vrasjet dhe masakrat

Para, dhe sidomos pas vendosjes së administrimit ushtarak në Kosovë (shkurt 1945), edhe në zonën e Shalës u kryen vrasje e masakra të ndryshme ndaj shqiptarëve, të bëra nga çetnikët, të veshur si komunistë. Burimet historike, na njoftojnë për një gjendje tejet të rëndë që mbretëronte gjatë viteve 1944–1947 në Shalën e Bajgorës. Dëshmitarët e kohës, tregojnë se kryesit më të njohur të atyre masakrave kanë qenë kolonët malazezë të fshatit Breznice, që deri në vitin 1956 kanë qenë në kuadër të Vushtrrisë, e më pas në kuadër të Kastriotit (Obiliqit). Organizatori kryesor ishte koloni malazeze (nga Breznica), Ilia Maroviq, që ishte edhe komandant i Vushtrrisë. Ky njeri konsiderohet personi kryesor i vrasjes pa gjyq të qindra shqiptarëve në zonën e Shalës. Gjithashtu, ka qenë e njohur edhe “Crna trojka” (Treshja e zezë): Vojo Vukosavleviq, Vojo Poshtaridhe dhe Slobodan Tanaskoviq⁸⁸. Në OZN të Vushtrrisë që nga themelimi i saj kanë punuar: Qazim Nuka i Mitrovicës, Kemal Kelneri (Maliqi) nga Mitrovica, Ratko Murganiqi, Kërsta Kërstiqi (Tushi), Shabo Gutiqi, Sima Milosavleviqi, Mirko Mihallovqiqi, Urosh Kërstiqi etj. Në fillim të vitit 1945, operativist

⁸⁸Fahri S. Buçinca - Ferid B. Dibrani, *Vep. cit.*, 129.

zë keq në Vushtri përmendet edhe Enver Hoxha⁸⁹. Në këtë anë, si bashkëpunëtorë të pushtetit dhe pjesëmarrës në shumë operacione kundër LNDSh-së përmenden edhe Ali Shukriu, Desimir Joviqi, Vojo Jankoviqi etj⁹⁰.

Dëshmitarët dhe të dhënat e botuara, na njoftojnë se qindra shqiptarë u pushkatuan në oborrin e Kazermës Ushtarake në Vushtri, në Fidanishte, në shtëpinë e Isak Llapashticës (shtëpia ishte kthyer si burg), shtëpia e Pop Zdrakoviqit afër Kalasë së Vushtrrisë, në fshatin Gojbul (Vushtri), në Sllakoc (Vushtri). Në këto vrasje të shqiptarëve, krahas Ilia Maroviqit, kishin marrë pjesë edhe: Ratko Murganiqi (shef i OZN-së), Mile Gjalloviqi, Velimir Jovanoviqi, Trifun Çaviqi, Mihajlo Iliq etj⁹¹.

Vrasjet në Gojbulë – Krahas shumë lokacioneve tjera në nivel Kosove, edhe fshati Gojbulë, (fshati në verilindje të Vushtrrisë) i banuar me serbë, ishte bërë vend ku ekzekutoheshin padrejtësisht qindra shqiptarë. Dëshmitarët dhe të mbijetuarit e kohës kanë rrëfyer se në lumin e fshatit Gojbulë në fillim të vitit 1945 ishin gjetur 9 djem të moshës 12–15 vjeç, të lidhur me tel dhe e të mbytur barbarisht. Edhe në Gojbulë nuk dihet se sa shqiptarë janë ekzekutuar, por që numri e kalon shifrën qindra. Gjithashtu, duhet shtuar se në këtë kohë, lumi i fshatit në fjalë, kishte bartur me vete qindra plisa të shqiptarëve, që dëshmonte se ata ishin ekzekutuar në brendësi të Gojbulës⁹².

Vrasjet në Sllakoc – Nga intervistat e bëra me njerëz që kanë përjetuar këtë masakër, si dhe nga librat e botuara që flasin për këtë periudhë, është vërtetuar se në fshatin Sllakoc (fshat në verilindje të Vushtrrisë), ishin pushkatuar pa asnjë vendim gjyqësor qindra shqiptarë të pafajshëm. Duhet shkruar se në vitin 1946 Brigada e

⁸⁹Po aty, 139.

⁹⁰AsllanIstrefi, *Ahmet Selaci - komandant i divizionit "Ibri" i Ushtrisë Nacional-Demokratike Shqiptare të "Besës Kombëtare"*, Prishtinë, 2012, 147.

⁹¹F. Dibrani, *Rrëfime për krimet serbe...*, 109 - 113.

⁹²F. Buçinca - F. Dibrani, *Vep. cit.*, 149 dhe 150.

27-të serbe me mbi 1 000 ushtarë, selinë e vet e kishte në Sllakoc⁹³. Në këtë masakër, përveç shumë të tjerëve, mizorisht ishin ekzekutuar: Bajram Miftari–Musliu, Rexhep Bunjaku, Xhemë Salihu, Abedin Zabërxha, Zenë Arif Menxhiqi, Mursel Muharrem Dushi, Hajdin Rama, Xhemë Lani, Sulejman e Jahir Perçuku, Abdullah e Xhemajl Nika, Mustafë Mulaku etj⁹⁴. Ka edhe shumë vende tjera ku janë kryer vrasje kundër shqiptarëve të Shalës nga pushteti i regjimit komunist jugosllav. Në vazhdim po japim një pasqyrë të të vrarëve në Shalë gjatë viteve 1941–1947.

*Regjistri i luftëtarëve të vrarë në Shalë,
gjatë viteve 1941–1947⁹⁵*

Nr.	Article I. Emri dhe mbiemri	Vendlindja	Vendi i rënies	Viti i rënies
1	Ajet Barja	Bare	Grekajë - te Lumi i Cerajës	1941
2	Bajram Miftari	Vllahi	Novi Pazar	1941
3	Bislim Uka	Vllahi	Novi Pazar	1941
4	Çun Miftari	Vllahi	Vidaricë-Çabër	1941
5	Demë Rama	Selac	Borçan	1941
6	Feriz Magjera	Magjerë	Ura e Vuçës - te Lumi i Cerajës	1941
7	Jahir Bistrica	Bistricë	Ura e Vuçës - te Lumi i Cerajës	1941
8	Kadri Zahiti	Bistricë	Ura e Vuçës - te Lumi i Cerajës	1941
9	Kamer Tushila	Tushilë	Novi Pazar	1941
10	Kurtesh Shabani	Ofçar	Sllatinë-Albanik	1941
11	Man Beqiri	Vllahi	Grekajë - te Lumi i Cerajës	1941
12	Miftar Hërja	Bistricë	Ura e Vuçës - te Lumi i Cerajës	1941
13	Halil Ferizi	Stantërg	Ura e Vuçës - te Lumi i Cerajës	1941
14	Miran Hajra	Batahir	Ura e Vuçës - te Lumi i Cerajës	1941
15	Muharrem Kurti	Vllahi	Ura e Vuçës - te Lumi i Cerajës	1941

⁹³Po aty, 212; Ibrahim Mulaku - Ferki Perçuku, *Cecelia (Monografi)*, Prishtinë, 2006, 57.

⁹⁴I. Mulaku - F. Perçuku, *Vep. cit.*, 60; F. Buçinca - F. Dibrani, *Vep.cit.*, 57.

⁹⁵Asllan Istrefi, *Ahmet Selaci - komandant i divizionit "IBRI" i Ushtrisë Nacional-Demokratike Shqiptare të "Besës Kombëtare"*, Prishtinë, 2012, 199 - 205.

16	Nuhë Isa	Cerajë	Ura e Vuçës - te Lumi i Cerajës	1941
17	Ramë Xhandari	Mitrovicë	Novi Pazar	1941
18	Rifat Dedia	Dedi	Ura e Vuçës - te Lumi i Cerajës	1941
19	Shaban Ofçari	Ofçar	Grekajë - te Lumi i Cerajës	1941
20	Sherif Voca	Melenicë	Mitrovicë - te Ura e Shupkofcit	1941
21	Zenel Kopiliqi	Kopiliq	Sllatinë-Albanik	1941
22	Hamit Ramadani	Shupkofc	Shupkofc	1942
23	Kamer Hasani	Vllahi	Rashkë	1942
24	Muharrem Tafë Shyti	Ashlan	Novi Pazar	1942
25	Arif Ofçari	Ofçar	Te Mullini i Arifit - Ofçar	1943
26	Halim Rushiti	Cerajë	Te Mullini - Cerajë	1943
27	Halit Osmani	Bare	Te Zekovitë - Gumnishtë	1943
28	Hamit Osmani	Bare	Te Zekovitë - Gumnishtë	1943
29	Sahit Osmani	Bare	Te Zekovitë - Gumnishtë	1943
30	Ajet Sejdi Peci	Rahovë	Fund Prronit të Vidishiqit - Selac	1944
31	Demë Hasani	Kopiliqi	Sllatinë - Albanik	1944
32	Hajrë Imeri	Batahir	Batahir	1944
33	Hajriz Lupcja	Kaqanoll	Barel-Bajgorë	1944
34	Hajzer Halit Zeqiri	Kaqanoll	Te Radovani - Kaqanoll	1944
35	Halil Cenë Ferizi	Stantërg	Grekajë - te Lumi i Cerajës	1944
36	Halim Bahtiri	Bare	Barel-Bajgorë	1944
37	Halit Vidishiqi	Vidishiq	Barel-Bajgorë	1944
38	Hamdi Doktor	Vushtrri	Xhidovë-Kaqanoll	1944
39	Hasan Boshnjaku	Lisicë	Sllatinë-Albanik	1944
40	Jahir Lih Uka	Bajgorë	Qafa e Koçicës-Rëzhanë	1944
41	Jusuf Fejzullahu	Vidishiq	Vushtrri	1944
42	Kap. Muharrem Ombashi	Vidishiq	Vushtrri	1944
43	Lah Rëzhana	Rëzhanë	Gërdec i Musinces-Murgull	1944
44	Mehmet Zukë Hajrullahu	Kaqanoll	Logu i Lupçës-Kaqanoll	1944
45	Nazif Jonuzi	Vinarç	Sllatinë-Albanik	1944
46	Një luftëtarë i Bares	Bare	Te Livadhi i Zeqirit - Kaqanoll	1944
47	Rizah Zhitia	Zhiti	Qafa e Koçicës-Rëzhanë	1944
48	Sadik Boshnjaku	Lisicë	Sllatinë-Albanik	1944
49	Selim Idriz Hasani	Rëzhanë	Rudaku i Sylshit-Rëzhani	1944
50	Selman Mehmet Jonuzi	Revuq	Bajgorë	1944
51	Shana Musa	Bajgorë	Xhidovë-Kaqanoll	1944
52	Vesël Llapi	Mitrovicë	Sllatinë - Albanik	1944

53	Zenel Begu	Vllahi	Vushtrri	1944
54	Adem Shaqir Zeka	Gumnishtë	Llazi i Ujit - Cernavern	1945
55	Adem Voca	Melenicë	Pasomë	1945
56	Ahmet Jashar Parduzi	Vesekofc	Gojbulë	1945
57	Ajet Azem Zeka	Gumnishtë	Llazi i Ujit-Cernavern	1945
58	Ajet Fazliu	Vidishiq	Llaz Uqe-Kaqanoll	1945
59	Arif Ajet Parduzi	Vesekofc	Gojbulë	1945
60	Avdi Begu	Vllahi	Bistricë	1945
61	Avdi Fekë Ferati	Bare	Boronjakë-Bajgorë	1945
62	Avdullah Zasella	Zasellë	Pasomë	1945
63	Bajram N. Haziri	Kaqanoll	Fund Prronit të Vidishiqit - Selac	1945
64	Bajarm Revuçi	Revuç	Guri i Sokolit - Vesekofc	1945
65	Bejtush Sylejman Ismajli	Gumnishtë	Llazi i Ujit-Cernavern	1945
66	Bekë Fazliu	Vidishiq	Fund Prronit të Vidishiqit - Selac	1945
67	Beqir B. Cimili	Melenicë	Fund Prronit të Vidishiqit - Selac	1945
68	Beqir Bahtir Istrefi	Kovaçicë	Qershia e Çaushtit	1945
69	Beqir Selim Parduzi	Vesekofc	Gojbulë	1945
70	Dibran Halili	Pasomë	Te Laqtë - Melenicë	1945
71	Djai i Hajzer Koshtovës	Koshtovë	Guri i Tupanit - Rahovë	1945
72	Ferat Ferizi	Stantërg	Pasomë	1945
73	Feriz Dobërdoli	Dobërdol	Rakinicë-Bajgorë	1945
74	Fetah Ajet Xhafa	Bare	Gurisht-Bare	1945
75	Fetah Hajdar Mehmeti	Gumnishtë	Gojbulë	1945
76	Hajrullah Miftari	Vllahi	Fund Prronit të Vidishiqit - Selac	1945
77	Halil Shashivar Mehmeti	Gumnishtë	Llazi i Ujit - Cernavern	1945
78	Hamzë Musa Mehmeti	Gumnishtë	Gojbulë	1945
79	Hashim Hamit Ibishi	Bajgorë	Gojbulë	1945
80	Hetem Voca	Melenicë	Pasomë	1945
81	Ibish Bekë Zeka	Gumnishtë	Llazi i Ujit - Cernavern	1945
82	Isa J. Kaqanollli me vëlla	Kaqanoll	Fund Prronit të Vidishiqit - Selac	1945
83	Isë Melenica	Melenicë	Kodër e Rahovës	1945
84	Ismail Ahmet Murtezi	Lushtë	Mitrovicë	1945
85	Ismajl Kadri	Gumnishtë	Llazi i Ujit - Cernavern	1945
86	Maliq Hamzë Mehmeti	Gumnishtë	Gojbulë	1945
87	Maliq Sahit Parduzi	Vesekofc	Gojbulë	1945
88	Man Ferizi	Stanterg	Pasomë	1945
89	Mustafë Mursel Hyseni	Gumnishtë	Tërstenik	1945

90	Nazif Revuçi	Revuç	Kroi i Hajrullahut - Kovaçicë	1945
91	Nebih Jahë Ismajli	Gumnishtë	Llazi i Ujit - Cernavern	1945
92	Nezir Rrahmani	Cerajë	Kutlllofc	1945
93	Një luftëtarë i Rahovës	Rahovë	Fund Prronit të Vidishiqit - Selac	1945
94	Qazim Shaban Gjaraku	Katunishtë	Lama e Bahtirit - Kovaçicë	1945
95	Ramadan Sahit Parduzi	Vesekofc	Gojbulë	1945
96	Ramiz Islam (Duku)	Selac	Selac	1945
97	Rifat Hamzë Mehmeti	Gumnishtë	Gojbulë	1945
98	Rifat J. Cimili	Melenicë	Fund Prronit të Vidishiqit - Selac	1945
99	Rifat Latif Mernica	Vesekofc	Gojbulë	1945
100	Rizah Dibran Çela	Rashan	Te Gurishta - Gumnishtë	1945
101	Salih Dibran Hyseni	Gumnishtë	Tërstenik	1945
102	Salih Jahë Ismajli	Gumnishtë	Llazi i Ujit - Cernavern	1945
103	Sejdi R. Tahiri	Selac	Fund Prronit të Vidishiqit - Selac	1945
104	Sejdi Sahit Parduzi	Vesekofc	Gojbulë	1945
105	Shaban Ali Mehmeti	Gumnishtë	Llazi i Ujit - Cernavern	1945
106	Shaqir Hetem Ismajli	Gumnishtë	Llazi i Ujit - Cernavern	1945
107	Sinan Ali Fejzullahu (Çaku)	Bajgorë	Boshlan	1945
108	Smaji Selim Parduzi	Vesekofc	Gojbulë	1945
109	Sokol Tahir Ismajli	Gumnishtë	Llazi i Ujit - Cernavern	1945
110	Sylë Salih Peci	Zhazhë	Bistricë	1945
111	Tahir Voca	Melenicë	Pasomë	1945
112	Ukë Rrahmani	Cerajë	Dedi	1945
113	Vëllai i Ferat Cimilit	Melenicë	Fund Prronit të Vidishiqit - Selac	1945
114	Vesel B. Cimili	Melenicë	Fund Prronit të Vidishiqit - Selac	1945
115	Xhemë Asllan Salihu	Starasellë	Ceceli	1945
116	Bislim Sallahu	Kaqanoll	Gojbulë	1946
117	Mursel Halil Beqiri	Kaqanoll	Dobratin	1946
118	Ahmet Selaci	Selac	Konaqet e Vllahisë	1947
119	Bajram Selaci	Selac	Lugu i Çadrave - Kozmaticë	1947
120	Bajram Tërbusja	Studime	Gërdec - Lupq i Poshtëm	1947
121	Bislim Bajgora	Bajgorë	Kodra e Kokolit – Koprivë	1947
122	Faik Boletini	Boletin	Konaqet e Vllahisë	1947
123	Hajrullah H. Islami	Selac	Konaqet e Vllahisë	1947
124	Haradin Vidishiqi	Vidishiq	Shullëri (Shulla)-Tërstenë	1947
125	Hashim Ukshin Kovaçica	Kovaçicë	Shpella e Ariut - Vllahi	1947
126	Hetem H. Islami	Selac	Te Konaqet e Vllahisë	1947

127	Imer Potpuri	Bistricë	Konaqet e Vllahisë	1947
128	Imer Shaqir Selaci	Selac	Tauk Bahçe - Prishtinë	1947
129	Jusuf Boletini	Boletin	Konaqet e Vllahisë	1947
130	Mehmet Selaci	Selac	Konaqet e Vllahisë	1947
131	Nebih Buta	Pirç	Vaganicë	1947
132	Nuhë Hajzeri	Vllahi	Vllahi	1947
133	Nuredin Hajzeri	Vllahi	Vllahi	1947
134	Osman Bunjaku	Samadrexhë	Tauk Bahçe - Prishtinë	1947
135	Qazim Islami	Selac	Kozmaticë - Vllahi	1947
136	Rexhep Mustafë Bunjaku	Samadrexhë	Samadrexhë	1947
137	Rizah Rexhep Selaci	Selac	Te Prroni i Osmanit - Selac	1947
138	Rizah Veseli	Smrekonicë	Vaganicë	1947
139	Rrahman Selaci	Samadrexhë	Samadrexhë	1947
140	Sadri Bajgora	Bajgorë	Vaganicë	1947
141	Shaban Halil Bunjaku	Samadrexhë	Samadrexhë	1947
142	Smajl Sfarça	Nadakofc	Shpella e Ariut - Vllahi	1947
143	Tusha Vllahia	Vllahi	Vllahi	1947
144	Ukshin Kovaçica	Kovaçicë	Shpella e Ariut - Vllahi	1947
145	Xhemë Smajl Peci	Zhazhë	Shtetku i Makvs - Zhazhë	1947

*HAKI KASUMI**Prishtinë*

VEPRIMTARIA ATDHETARE E GJON SERREQIT

Në gjysmën e dytë të muajit nëntor të vitit 1944, zhvillimet politike dhe luftarake në Kosovë kishin marrë kahje tjetërfare, në krahasim me tri vitet e para të periudhës së Luftës së Dytë Botërore. Forcimi i krahut të koalicionit kundër nazifashizmit, ku ishin të përfshirë edhe një pjesë e shqiptarëve në Mbretërinë e Bashkuar të Shqipërisë, të cilët ishin të rreshtuar në aradhet partizane të udhëhequra nga organizatat komuniste, të cilat ishin shumë të ndikuara nga elementet komuniste serbe e malazeze, po e luftonin hapur orientimin e drejtë kombëtar të popullatës shumicë të kësaj krahine. Duke vërejtur veprimet të cilat çonin në aneksimin e Kosovës nga Serbia, si dhe veprimet e shumta kriminale ndaj popullatës shqiptare nga forcat e njësiteve partizane të përziera me njësitet çetnike të cilat në këtë kohë ishin amnistuar nga ana e Kryesisë së KAÇKJ-së, më 21 nëntor 1944⁹⁶, nacionalistët shqiptarë u detyruan të formojnë edhe organizata të tjera patriotike shqiptare me qëllim të kundërvënies tendencave të tilla të rrezikshme për interesat nacionale të shqiptarëve dhe të viseve të tyre etnike. Në mesin e organizatave që u formua në këto momente të vështira, e cila tuboi shumë atdhetarë dhe intelektual të dalluar, që zhvilloi veprimtari të dendur, që la gjurmë të pashlyera në histori dhe që bëri jehonë të madhe dhe që tronditi forcat antishqiptare komuniste serbo malazeze e maqedonase të kësaj periudhe, ishte Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSh). Kjo organizatë nacionale politiko–ushtarake shqiptare bashkoi dhe mobilizoi forcat

⁹⁶ Hakif Bajrami, *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës (1844- 1995)*, Prishtinë, 1995, 145- 146.

më të përkushtuara intelektuale dhe patriotike shqiptare të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare të cilat ishin të gatshme të luftonin deri në vdekje për një shtet shqiptar ku do të përfshiheshin të gjitha viset etnike dhe popullata shumicë shqiptare me një qeverisje demokratike të ngjashme me shtetet e Evropës Perëndimore dhe të Amerikës.

Në radhët e LNDSH-së, përveç shumë patriotëve dhe intelektualëve shqiptarë të Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore herët u rreshtua edhe i riu Gjon Serreqi, intelektual dhe patriot i dalluar.

Gjon Serreqi u lind me 11 shkurt 1920 në Ferizaj, në një familje zejtare nga e ëma Anica dhe i ati Gjergji⁹⁷. Shkollën fillore në gjuhën serbe e kreu në vendlindje. Shkollimin e vijoi në “Seminarin Ipeshkvnor” në Prizren. Nga dëshira e madhe për shkollën ai i ndoqi mësimet edhe në gjimnaz ku u diplomua në vitin shkollor 1939/40. Në vijim, Gjoni regjistrohet në Fakultetin Filozofik në Zagreb. Studimet u detyrua t'i ndërpres, në vitin 1941 për shkaqe ekonomike dhe politike. Në prill të po atij viti, pas shpërbërjes së Mbretërisë Jugosllave arriti të shkoi në Piza të Italisë, për t'i vazhduar studimet në Fakultetin Filozofik. Pas gjashtë muajsh, kaloi në Firence ku do të vazhdoi studimet deri në vitin 1943⁹⁸.

Gjon Serreqi edhe pse po studionte jashtë vendit, nuk i kishte shkëputur lidhjet me rininë studentore të Kosovës. Prej së largu përcillte zhvillimet në vendlindje dhe vazhdimisht mendonte për çështjen e lirisë dhe të bashkimit kombëtar të popullit shqiptar. Këto ndjenja i kishte shprehur në korrespondencën me bashkëvendësit e tij⁹⁹. Nga studimet e rregullta në Itali, Gjoni u kthye në Ferizaj në gjysmën e dytë të vitit 1943. Edhe pse ende nuk i kishte përfunduar studimet, ai në rrethanat e asaj kohe çmohej dhe

⁹⁷ Ismet Dermaku, Gjon Serreqi dhe NDSH-ja (dokumente arkivore), Prishtinë, 1996, fq. 145; Hysen Azemi, LNDSH-ja dhe sigurimi shtetror serb, vëllimi II (1945- 1947), Prishtinë, 2014, 74.

⁹⁸ Si shënimi 2, 146.

⁹⁹ Muhamet Pirraku, *Gjon Serreqi - idealisti shembullor nga lagja e martirëve të kombit*, fjalim me rastin e tubimit përkujtimor të mbajtur në Prishtinë më 11 shkurt 2010.

konsiderohej si intelektual i dalluar. Në këto rrethana nga nomenklatura politike lokale emërohet kryetar i komunës së Babushit¹⁰⁰. Deri sa ushtronte këtë detyrë, ai pati kontakte dhe mundësi të krijojë lidhje me pushtetarë të niveleve të ndryshme si dhe të afirmojë talentin e tij intelektual dhe përkushtimin atdhetar. Kur gjithë kësaj i shtohet edhe veprimtaria e forcuar e individëve të bashkuar në “Lidhjen e Dytë të Prizrenit” për të realizuar idenë e ribashkimit të viseve shqiptare, profili i Gjon Serreqit dhe i bashkëmendimtarëve të tij fuqizohet dhe zgjerohet në hapësirën kombëtare. Rritja e autoritetit të këtij të riu të talentuar dhe drejt të rreshtuar u pengonte individëve dhe grupeve të ndryshme të interesit. Ky fakt dhe të tjerë u shfrytëzua nga strukturat komuniste lokale, të cilët e denoncuan Gjonin në Gestapo, si “fashist italoofil, të dëmshëm për mirëqenien naziste në Nënprefekturën e Ferizajt”?!¹⁰¹

Kjo shërbeu si shkak për ta arrestuar, në maj të vitit 1944 edhe Gjon Serreqin. Si i burgosur një kohë vuajti në “Kampin e Përqendrimit” në Prishtinë, prej nga pastaj me grupin e të internuarve u dërgua në Kampin “K-16” të Vjenës, e gjetkë në Austri, prej nga pas një viti lirohet dhe kthehet në Kosovë në qershor të vitit 1945¹⁰².

Gjendja në viset shqiptare ku ishte vendosur diktatura komuniste, ishte përkeqësuar përtej çdo mase. Skamja dhe zija ishte e pranishme në çdo familje shqiptare. Në këtë gjendje, Gjoni e gjeti edhe familjen e tij. Pushtetarët serb ia kishin vrarë vëllanë e vogël, Redin 16 vjeçar¹⁰³, dhe disa të afërm të tjerë. Kjo gjendje e forcoi edhe më tepër bindjen e Gjonit të rreshtohej sa më parë në krahun e forcave politike e luftarake kundër ripushtimit jugosllav.

Punësimi i Gjon Serreqit në Gjinnazin “Sami Frashri” në Prishtinë, në vjeshtën e vitit 1945¹⁰⁴, atij i krijoi mundësi të reja të veprimt.

¹⁰⁰ Po aty, 2.

¹⁰¹ Si shënimi 5, 2.

¹⁰² Si shënimi 2, 146.

¹⁰³ Si shënimi 5, 2.

¹⁰⁴ Ahmet Qeriqi, Gjon Serreqi (1920-1947) prijatar i Levizjes Nacional Demokratike Shqiptare, shkrim ne rastin e 90 vjetorit të lindjes, Prishtinë, 11. 02. 2010,1.

Në këtë çerdhe të arsimit shqip kishte kohë që vepronte një bërthamë e organizimit politik kombëtar të Komitetit Vendor të ONDSH-së të Prishtinës. Valët e njëjta të energjisë kombëtare e lidhën atë me aktivistët e këtij orientimi politik. Pasi u njoftua me programin politik dhe me platformën e saj, Gjon Serreqi dha betimin me deklaratën e tij të famshme për ONDSH-në: *“Kjo organizatë angazhohet për çlirimin e popullit të robëruar shqiptar, për rend demokratik, siç ekziston në një pjesë të Evropës Perëndimore dhe në SHBA. Prandaj, unë përqafoj dhe do të luftoj për një Shqipëri etnike, demokratike, e jo për një Shqipëri zogiste apo komuniste”*¹⁰⁵.

Me rreshtimin e Gjon Serreqit në Organizatën e Rinisë Nacionaliste Shqiptare, antikomuniste e antijugosllave, e cila vepronte edhe më parë, ajo e shtoi aktivitetin, dhe forcoi e zgjeroi radhët veta. Gjithashtu edhe ngritja ideopolitike dhe strategjike e anëtarëve të përfshirë në ONDSH nga kjo kohë u bë edhe më e organizuar. Me angazhimin e drejtëpërsëdrejtë të Gjonit, në prill të vitit 1946, u formua organizata e të rinjve në Ferizaj. U themelua Komiteti i Rrethit i NDSH-së, në të cilin u përfshinë kryesisht të rinj, zejtarë, tregtarë, nxënës të shkollave, e të tjerë të këtij qyteti¹⁰⁶.

Gjatë veprimtarisë së organizuar në terren, Gjon Serreqi në pranverën e vitit 1946 kishte krijuar lidhje edhe me disa anëtarë të Komitetit Qendror të NDSH-së në Shkup nga të cilët ai sillte udhëzime e materiale të shkruara për aktivitetin e këtyre organizatave¹⁰⁷.

Shtimi i mbështetësve dhe zgjerimi i veprimtarisë së ONDSH-së, në hapësirën e tokave shqiptare po e mbanin gjallë dhe po e ushqenin shpirtin atdhetar e liridashës të Gjon Serreqit dhe të bashkëmendimtarëve të tij. Por këto rrjedha të mbara të veprimtarisë kombëtare të këtij organizimi politik shqiptar, në fund të muajit prill të vitit 1946 përfetojnë një goditje të rëndë nga i ashtuquajtimi

¹⁰⁵ Si shënimi 2, 322

¹⁰⁶ Po aty.

¹⁰⁷ Po aty.

“shërbimi i sigurimit popullor” i pushtetit partizano komunist jugosllav i cili kishte filluar një fushatë të përndjekjes dhe të arrestimit të anëtarëve të ONDSH-së. Me sugjerimin e disa anëtarëve të KQ-së në Shkup, Gjon Serreqi duhej të kalonte në ilegalitet dhe t’i bashkohej Shtabit numër 2 në Drenicë, të cilin e udhëhiqte Ajet Gërguri¹⁰⁸.

Pas ndërmarrjes së këtij veprimi, përfundon faza e parë e veprimtarisë së bujshme politike—atdhetare, gjysmëlegale e Gjon Serreqit në ONDSH.

Faza e dytë e veprimtarisë politike atdhetare e këtij veprimtari të rrallë shqiptar vazhdon pa asnjë ndërprerje në kushte dhe rrethana të tjera, të jetës në ilegalitet të plotë, por me një përkushtim dhe guxim edhe më të madh se më parë. Përderisa “Organizatën numër 2” e udhëhiqte Ajet Gërguri, sekretar ishte zgjedhur Gjon Serreqi, i cili organizoi punën dhe barti barrën kryesore gjatë mbajtjes së Kongresit V-të të NDSH-së. Në kushte shumë të rënda, të një përndjekjeje natë e ditë nga njësitet e sigurimit shtetëror jugosllav, u vazhdua puna dhe u mbajt Kongresi i V-të i NDSH-së, me 25 korrik 1946, në malet e Blinajës (Lipovicës) të Lipjanit. Gjendja vazhdonte të rëndohej pas zbulimit dhe burgosjeve të një numri të anëtarëve të kësaj organizate në të gjitha nivelet. Ky kongres u mbajt në rrethana të jashtëzakonshme dhe u përqendrua në çështjet më kryesore si:

- Riorganizimi i Ushtrisë Shqiptare të Maleve të Lira të Kosovës;
- Marrja e vendimit që kjo ushtri të kalonte në Greqi përkohësisht, për tu forcuar, për t’u armatos me armë më efikase dhe për ta kaluar dimrin atje¹⁰⁹.

Pas përfundimit të punimeve të Kongresit të V të NDSH-së, filluan përgatitjet për realizimin e vendimit të dytë. Pjesa dërmuese e kësaj ushtrie, e udhëhequr nga Ajet Gërguri dhe Gjon Serreqi derisa po tërhiqeshin për në Greqi u penguan dhe pas një lufte

¹⁰⁸ Po aty.

¹⁰⁹ Hysen Azemi, LNDSH-ja dhe siguri shtetëror serb, vëllimi II (1945- 1947), Prishtinë, 2014, 90 (Aktakuza ndaj Gjon Serreqit).

njëditëshe me njësitet e forcave ushtarake e policore jugosllave në malet afër fshatit Hoqë e Qytetit të Prizrenit në gusht të vitit 1946 u thyen këto grupe të pjesëtarëve të NDSH-së¹¹⁰.

Gjon Serreqi pas luftimeve i shoqëruar nga Osman Abazi u tërhoq në drejtim të maleve të Jezercit, në rrethin e Ferizajit dhe në malet e Karadakut (ku u takuan me grupin e Sylë Hotlës e të Hajriz Kajollit), ku qëndruan deri në fillim të shtatorit të vitit 1946. Gjatë shtatorit të po këtij viti, këta dy veprimtarë kaluan nëpër Mramor e Gllugovicë dhe arritën në fshatin Laçiç të Kamenicës (vendlindje e Osmanit). Me 3 tetor, këta dy burra, sipas deklaratave të dëshmitarëve, ndodhen në Shipashnicë të Epërme, në shtëpinë e Ramadan Beqirit. Në këtë mbrëmje, Gjoni arrin që nga mysafirët e pranishëm të formojë Komitetin Komunal të NDSH-së për Komunën e Rogoçicës¹¹¹. Ato ditë në rrethinën e Gjilanit dhe të Kamenicës ishin burgosur disa anëtarë të ONDSH-së, gjë që e kishte shtuar ndjenjën e frikës në këto anë. Në këto rrethana në javën e parë të tetorit 1946 Gjon Serreqi me Osman Abazin kalojnë në Tërrnoc të Madh afër Bujanocit, ku po ashtu ekzistonte Komiteti i Vëndit i NDSH-së. Në këtë fshat ata qëndruan dy javë. Numri i të arratisurve në këto vise ishte shtruar në 12 veta. Ky grup kishin përgatitur një ish strehimore–bunker ku planifikonin të kalonin dimrin. Në këtë strehimore grupi qëndroi deri me 10 shkurt 1947. Pas dekonspirimit të këtij vendqëndrimi, grupi u largua dhe më pastaj u shkapërderdh¹¹². Ndërkohë, Gjoni dhe Osmani ishin strehuar në Laçiç e Desivojcë. Me 24 shkurt Osman Abazi iu kishte dorëzuar organeve të OZN-së në Muçivercë me urdhër të Gjunit. Ndërsa natën në mes të 24 e 25 shkurtit, patrioti Gjon Serreqi do të kapet nga OZN-a në një kasolle mali në Desivojcë, i shoqëruar nga djaloshi trim e besnik Riza Shkodriqi¹¹³. Gjurmët për kapjen e

¹¹⁰ Po aty

¹¹¹ Si shënimi 14, 90,

¹¹² Si shënimi 2, 169.

¹¹³ Arkivi i Kosovës, Dosja Gjon Serreqi, sig. AK. XXVI- K2-99; Si shënimi 2, 169.

Gjonit i zbuloi shoqëruesi më besnik prej 25 korrikut 1946, Osman Abazi, pasi ishte thyer nga organet e sigurimit.

Pas burtosjes, Gjon Serreqi qëndroi stoikisht dhe i pathyeshëm para hetuesisë dhe trupit gjykues komunist të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, dhe me krenari deklaroi se kishte përkrahur dhe vepruar në Organizatën Nacional Demokratike Shqiptare për krijimin e Shqipërisë Etnike. Për këtë dhe veprime të tjera patriotike Gjon Serreqi dhe bashkëveprimtarët e tij: Ukë Sadiku, Ajet Gërguri, Hilmi Zariqi dhe Osman Bunjaku, u shpall fajtor dhe u dënuan me dënimin më të rëndë – pushkatim¹¹⁴. Sipas procesverbalit të dënimit me vdekje (pushkatim), me 31 gusht 1947 u ekzekutuan:

1. Ukë Sadiku;
2. Ajet Gërguri;
3. Gjon Serreqi; dhe
4. Osman Bunjaku.

Vendi i pushkatimit nuk është shënuar në dokumentin e përmendur, por në bazë të hulumtimeve të bëra kohëve të fundit mendohet se ai akt makabër dhe i padrejtë është kryer në vendin e quajtur Strelishtë – Tauk Bahqe në Prishtinë.

Se çfarë disponimi dhe planesh kishte politika serbe–jugosllave e Jugosllavisë së Titos ndaj shqiptarëve pjesëtarë të Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare, mund të kuptohet edhe nga listat e shumta me emër e mbiemër të tyre të cilët planifikohej të likuidoheshin gjatë viteve 1945– 1948, shiko në librin e Dr. Hakif Bajramit, Politika serbe për rikolonizimin e Kosovës me sllavë 1945– 1948, Prishtinë, 2002, fq. 208– 213.

¹¹⁴ Si shënim 14,91; Ismet Dermaku, Gjon Serreqi dhe NDSH-ja, vep. e cituar, 223.

DAUT BISLIMI

Prishtinë

HALIM ORANA – NJË JETË PËR SHQIPËRI ETNIKE

E gjithë historia gjatë Luftës Çlirimtare Antifashiste dhe menjëherë pas saj, është e krijuar me luftëra kundër armiqve rreth e rrotull, dhe tragjedia e kësaj historie ka trokitur në derën e çdo shqiptari të këtyre trojeve. Bartësit e dhunës, terrorit dhe e të gjitha të këqijave kundër shqiptarëve, ishin ekspansionistët fqinjë: bullgarët, serbët me yllin e Stalinit, dhe së fundi “real-socializmi” shoven-ekstrem i “pushtetit popullor” komunist.

Poqëse analizojmë vëmendshëm dhe me objektivitet retrospektivën historike të të gjitha ngjarjeve dhe luftërave të lëvizjeve çlirimtare kombëtare të shqiptarëve në trojet e tyre etnike, kundër armikut shekullor-hegjemonizmit ekspansionist dhe kolonializmit serbomadh, duke filluar që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878), lëvizjet kaçake dhe regjimit të Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene (1918–1941), Lufta Çlirimtare Antifashiste (1941–1945) e deri te lufta e fundit e UÇK–UÇPMB–së, do të shohim se historiografia dhe politika e të gjitha regjimeve sllave, (bizantine, monarkiste, mbretërore, socialiste, komuniste, diktatoriale) dhe Kisha Ortodokse Serbe, çdo lëvizje çlirimtare kombëtare shqiptare, i ka quajtur “turko-fundamentaliste islamike”, “terroriste”, “separatiste” “shqiptaro-mëdha” dhe si të tilla i ka luftuar me të gjitha fuqitë, si ushtarake ashtu edhe diplomatike në, të gjitha kohrat në format e saja gjenocidiale.

Shqiptaret në trojet e tyre etnike, çdoherë që kërkoi kombi, organizuan rezistencën dhe e luftuan këtë ekspansionizëm ekstrem të farës së keqe, deri ne ditët tona.

Natyrisht, këto veprime kombëtare nuk lindën vetvetiu. Ata së pari shkrepën në mendjen e qindra ithtarëve të ndërgjegjes shqiptare, për t'u sendërtuar më pas, në lëvizjen ilegale ç'prej Prishtinës e Shkupit, deri në fshatrat më të largëta të Kumanovës, Tetovës, Gostivarit, Kërçovës, Strugës etj., në vargun pambarim, të atyre burrave të cilët parapanë tek lëvizjet ilegale, të radhitura në fillim në njësi vullnetare mandej të rreshtuara në formacionet e Forcave Kombëtare për të vazhduar më pas në Komitetet e Lidhjes së II-të Prizrenit, e cila reflektoi fuqishëm në të gjitha prefekturat e nënprefekturat ku ishin shqiptarët, së fundi edhe në ONDSH-së, e cila veprimtarinë kombëtare e filloi atëherë kur ishte e qartë se fati i kombeve në Ballkan ishte lënë në mëshirën e Stalinit dhe Titos, si dhe për të drejtat në liri të shqiptarëve kishin mbaruar sepse, "nacional-çlirimtarja", tregoi ftyrën e vërtetë të saj, duke konsideruar problemin shqiptar të mbyllur dhe në vazhdim për të filluar një tragjedi të re për shqiptarët e këtyre trojeve.¹¹⁵

Në këto kushte, mënyrën e vetme të zgjedhjes së problemit shqiptar – çlirimin nga kjo e keqe e madhe, ndërgjegjia shqiptare e këtyre trojeve, e panë në organizimin politiko-ushtarak në nivel kombëtar, që u ofronte koha.

Në vitet e Luftës Çlirimtare Antifashiste, kishte demokratë të cilët kishin kundërshtuar çdo lloj force të totalitarizmit, a kishte edhe nacionalistë të tillë si Balli Kombëtar të cilët, pa marrë parasysh a ishin ithtar të italianëve apo të gjermanëve, synonin të mbajnë aleancën nazifashiste kundër komunizmit, por më çdo kusht atdheun dhe popullin e vet e kishin vendosur në interesimin dhe vendin e parë. Kishte edhe antikomunistë, të cilët për nazifashizmin nuk çanin fort kokën, por llogaritnin në komunizmin duke konsideruar mbrojtjen më të mirë prej saj. Dhe, përfundimisht, ekzistonin "antidemokrat", aso të cilët dëshironin shtet revolucionar dhe autoritar. Të tillët më shumë admironin dhe më epitet shikonin kah

¹¹⁵. Dr.Daut Bislmi, Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945. Prishtinë 1997, f.114-119.

Bashkimin Sovjetik se sa në demokracitë liberale. Mendoj se pikërisht kjo kategori e fundit i dha Shqipërisë etnike nazifashistët më të mëdhenjë dhe më agresiv, e që për shkak të tyre, nacionalizma shqiptare progresive, emrin e mirë e kishte fituar me sjelljen, mençurinë dhe luftën pa kompromis kundër çdo okupatori të Shqipërisë etnike, pa marrë parasysh se cilës shtresë, etnitet, komb apo ideologjie të shoqërisë shqiptare i takonte.

Për nacionalizmin shqiptar, atdheu ishte gjëja më e shtrenjtë, ishte altari i shpirtit, ishte drita ushqyese, ishte krenaria më e madhe dhe pasuria më e çmuar. Atdheu ishte tërësia e popullit të një gjuhe dhe të një gjaku. Ishte tërësia e tipareve e virtyteve kombëtare. Nacionalistët thonin: “Na po e shpallim haptas, se nuk kemi as ma të voglin pretendim mbi asnjë copë toke që nuk është e jona. Duam, pra, vetëm gjithçka është tokë arbërore, e banuar prej një popullate shqiptare. Prandaj, fqinjët tanë nuk kanë çka druajnë prej nesh....”¹¹⁶

Kombi shqiptar kërkonte prej nacionalizmit akt patriotizmi dhe urtësi politike. Të bënin detyrën për te mirën e atdheut dhe çdo i huaj që vjen për ta nënshtruar popullin Shqiptar e ka fatin të caktuar: del me këpucë të kuqe, sepse kur iu ofrohej ora vendimtare e fatit të Shqipërisë etnike, nacionalizma përmbledhë të gjitha forcat morale me qëllim që t’i drejtojë kah një qëllim i vetëm: Shpëtimin e Shqipërisë etnike dhe çdo shqiptarë me orientime kombëtare e ndiente si vëlla dhe të pandarë prej shoku-shokut, për të vetmin qëllim; të ketë Shqipëri të lirë dhe të bashkuar.

Prijësit e nacionalizmit vazhdimisht thonin: “Vetën tonë do ta shpëtojmë ne vet, me sakrificat tona, me përpjekjet tona, me dëshirën tonë. Dhe Zoti ka për të na ndihmuar”.¹¹⁷

Sa herë sjellim ndër mend zhvillimet e ngjarjeve historike në trojet shqiptare në ish Jugosllavi gjatë Luftës së Dytë Botërore, kujtesa

¹¹⁶. *Parti komuniste apo parti terroriste. Organ i Ballit Kombëtar*. Tiranë, 1943.

¹¹⁷. Po aty.

historike na ngulitët thellë në përpjekjet e mëdha të intelektualëve, atdhetarëve, mësuesve dhe nxënësve, të cilët në këto troje, mes rrebesheve të kohërave, kanë ruajtur përherë identitetin e tyre kombëtar.

Personalitete të mëdha kombëtare historikisht lindin me zgjimin e kombit dhe pavarësisht nga situata, që gjendet kombi, ato fuqimisht ndërtojnë dhe kultivojnë moralin kombëtar në gjeneratat që ka mbështetjen kombi. Kështu, duke kujtuar historinë e viteve të fundit të Luftës Çlirimtare Antifashiste dhe vitet e para pas luftës në këtë Konferencë shkencore, pikërisht me rastin e 70–Vjetorit të Kongresit të II–të të NDSH–së, mendja na shkon të flakadani i këtyre ngjarjeve Halim Orana, nacionalistin e orëve të opara, atdhetarin e sakrificës për çështjen kombëtare, të cilin karakteri i lartë moral e shpirtëror e bëri personalitet të shquar historik në luftë për Shqipërinë etnike. Halim Orana si intelektual, veprimtarinë e vet patriotike e kurorëzoi në kulmin e veprimtarisë së LNDSH–së, e që kjo Lëvizje kombëtare tek ai shikonte përfaqësuesin e denjë të karakterit të fortë të shqiptarit, i cili ka lënë gjurmë të mëdha në historinë dhe diplomacinë shqiptare.¹¹⁸

Halim Orana u lind në Gjiilan në vitin 1914, në një familje të njohur në territorin e Anamoravës dhe ma gjërë, ku ishte kultivuar me kohë tradita, morali dhe ndërgjegja kombëtare. Shkollën Normale, të filluar në Banjallukë e përfundoi në Shkup, në vitin 1932. Aty njohu shokët e parë të tij, njohu historinë e kombit, të ngjizur në truallin e vendlindjes. Aty, ai hodhi hapat e parë të suksesit dhe të punës. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Tradita familjare arsimdashse dhe patriotike e familjes, e kishte bërë të sajën. Në kohën kur Halim Orana shkollohej në Shkup, ky qytet ishte bërë arë dhembjeje, prej nga shqiptarët merrnin rrugën pa kthim të shpërnguljes në Turqi. Këto tortura dhe përsëkitime kundër

¹¹⁸. Dr.Daut Bislimi, vepr. e cit., f.146-148.

popullit shqiptar, të cilat kishin marrë formën e gjenocidit, kishin rënduar mbi Halim Oranën.¹¹⁹

Pa u zgjatur në ato zhvillime e ngjarje, regjistrohet historia e përvuajtur por krenare e Halim Oranës. Pas përfundimit të Shkollës Normale në vitin 1932, punoi si mësues në fshatrat shqiptare të rrethit të Gjiçanit. Që në fillim mësuesi Halim u ndesh me një paradoks tjetër që po i ndodhte atij dhe popullit të tij. Edhe pse punonte me nxënës shqiptar, mësimin ishte i detyruar ta mbante në gjuhën serbe! Mirëpo nxënësve të vet ua mësoj edhe shkrimin shqip, kurse në popullsinë e këtyre fshatrave, fuste frymën patriotike dhe ngrite vetëdijen kombëtare. Ky qëndrim i tij kundër regjimit të pushtetit bëri që ai të përcillej hap pas hapi si i dyshimtë. Për t'u larguar nga kjo përndjekje ai shkoi përsëri në Bosnjë dhe u pranua në punë si mësues në Velika Klladushë–Cazin. Aty punoi deri në vitin 1941. Pas kapitullimit të Mbretërisë SKS, sërish u kthye në Kosovë.

Pas një qëndrimi të shkurtër në Gjiçan pranë familjes, Halimi, në vjeshtë të vitit 1941 regjistrohet në Universitetin e Zagrebit. Si student në Zagreb, mbante lidhje të përhershme me Ministrinë e Arsimit në Tiranë dhe me krerët e nacionalizmës shqiptare në trojet etnike.

Halim Orana ishte një antifashist i përbetuar. Pushtimi i Shqipërisë nga të huajt e tronditi, dhe e bëri ta ndjejë edhe më fort përgjegjësinë ndaj atdheut dhe mori fuqi të re në luftën për liri. Mori pjesë në demonstratat kundër pushtuesve italianë në Shqipëri, për çka ishte arrestuar dhe mbajtur në burgun Porto–Romano në Durrës.

Qeveria shqiptare, duke njohur personalitetin e Halim Oranës në fushën e patriotizmit dhe të dijes, si dhe si demokrat i përmasave evropiane, në vitin 1943, e propozoi përfaqësues të shetit Shqiptar në Kroaci. Në këtë post qëndroi pak dhe për atë kohë qëndrimi në

¹¹⁹. Hamdi V. Thaqi, Gjinnazi “Sami Frashëri” Prishtinë 1941-1944 I. Prishtinë 2011, f. 579-590.

Zagreb, Halimi Orana i kapërceu shumë kufijtë e një diplomati dhe vuri kontakte me diplomatë perëndimor për mbrojtjen e interesave kombëtare, për ta aktualizuar çështjen e pazgjidhur shqiptare, dhe për njohjen e Shqipërisë në kufijtë ku përfshinte Kosovën dhe pjesën më të madhe të tokave shqiptare, Shqipërinë Etnike.¹²⁰

Për Shqipërinë Etnike, vendosja e sistemit komunist ishte varr i hapur. Kjo situatë e rënduar, kur kombi ishte në rrezik dhe kur gjithë populli shqiptar ishte plagë, koha historike nxori në sipërfaqe personalitetin e Halim Oranës, personalitet cili i kuptoi ndryshimet e kohës dhe u parapriu atyre, misionar i frymës dhe lëvizjes së shqiptarizmit, që kishte si focë shpirtërore frontin kombëtar, erudit i shkëlqyqar dhe atdhetari i madh, i cili ia kushtoi krejtësisht jetën e vet veprimtarisë diplomatike dhe historisë në dobinë e çështjes shqiptare si NDSH-së, madje edhe si kryetar i KQ të NDSH-së, i zgjedhur në Kongresin e II-të, me 1 qershor 1946 në Shkup.¹²¹

Dokumenti më i rëndësishëm i aprovuar në këtë Kogres, është: *“Skema e Organizimit”* dhe *“Programi i Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare”*. Këto dy dokumente i konceptoi Halim Orana i ndihmuar nga Abdulla Musliu, të cilët edhe ishin ngarkuar në Kongresin e I-rë të ONDSH të gushtit të vitit 1945.

Halim Orana strukturoi *“Skemën e Organizimit”* të ONDSH-së mbi një skemë të thjeshtë por domëthënëse, ku parashikonte me hollësi çdo detaj bashkëpunimi dhe ndihma reciproke ndërmjet njerëzve dhe të komiteteve të vendeve për lirimin e tokave shqiptare. Këto akorde bashkëpunimi me të gjitha komitetet, nuk mbetën vetëm në letër, por u konkretizuan në bashkëveprimin kundër ideologjisë së kuqe dhe çdo okupatori tjetër.

Shikuar në esencën e strukturimit, skema shtronte tri detyra themelore: *1. Restaurimin e pavarësisë së Shqipërisë; 2. Vendosja e*

¹²⁰. Hamdi V. Thaqi, vep. e cit., f. 647-654

¹²¹. Dr. Daut Bislimi, vep. e cit., f. 151.

një regjimi pune dhe të aktivitetit të denjë kombëtar të Komiteteve për LTSH; dhe 3. Përgjegjësitë për moskryerjen e detyrave.¹²²

Dokumenti tjetër me rëndësi shumë të madhe për mendimin politik shqiptar të kohës është: *“Programi i Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare”*, i cili përmbante 5 pika:

- 1. Liri dhe pamvarësi të plotë me të drejtë vetqeverimi në bazë të vullnetit të popullit të qfajqun lirisht.*
- 2. Në tokat Shqiptare kuptohet në krejt vendet ku banojnë shqiptarët në 60% pa dallim se si quhët krahina e vendi dhe nga kush është i pushtuem.*
- 3. Livizja nuk ka qëndrim armiqësor kundër asnjë populli fqinjë as kundër partije politike, vetëm insiston në mënyrë kulturore dhe me armë do të përpiqet m’i arrijt idealet shekullore të kombit Shqiptar, që të jetë i lirë dhe vetësundues në shtet të vet me kufijt etnik.*
- 4. Mbasi të vendosën kufijt etnikë, pa marrë parasysh tjerat kushte të kufijve si jan ato: Strategjik, ekonomik, politik etj., në mënyrë miqësore do të shkëmbehet popullata e pakicave nacionale, duke i tërheq Shqiptarët që do të mbetën jasht kufijve, në vend të atyre që do të shpërngulën dhe do të përcjellën jashtë.*
- 5. Në kohë paqe Lëvizja nuk do të pushoi por do të vazhdoj si shërbim roje të drejtave të popullit shqiptar, si të atyre të mbrendëshem, ashtu edhe të atyre të jashteme, ndërkombëtare tue u organizue për regjim të vërtetë demokratik dhe për relacione miqësore me popujt fqinjë Ballkanik. Nga Kongresi i Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare. Rrnoftë Shqipnija e vërtetë me kufijt e sajë etnik! – përfundonte program.¹²³*

¹²². Qerim Lita, Dr.sc. Fejzulla Shabani, Dr.sc.Daut Bislimi, KQ i NDSH-së dhe Azem Morana. Shkup, Prishtinë, Tiranë 2011, f.104.

¹²³. Qerim Lita, Dr.sc.Fejzulla Shabani, Dr.sc.Daut Bislimi, vep. e edit., f. 57-58.

Programi i LNDSH ushqehej nga dashuria për Shqipërinë Etnike, përpjekja për popullin shqiptar dhe respekti për popujt e tjerë. Ky ishte qëllimi i shenjtë i LNDSH-re. Disa nga idetë e Programit të LNDSH-së e kapërcejn kohën kur u shfaq dhe janë aktuale edhe sot dhe mbeten udhërrëfyese edhe për nesër. Në shumë pika programi i Halim Oranës takohet me Dekalogun e Ballit Kombëtar të Mid'hat Frashërit, sepse edhe fushëveprimtarinë diplomatike dhe ushtarake e kishin të përbashkët. Halim Orana kultivonte idenë se “na nuk duhet të pushojmë së punuari deri sa çdo shqiptar të jet brenda trojeve të veta dhe trojet shqiptare të jenë brenda kufijve të shtetit shqiptar” (pika 4 e programit). Bashkimi kombëtar është ideal për çdo shqiptar. Prandaj Halim Orana vendosi në fund të programit një thirrje për gjithë kohërat që është edhe një mesazh për shqiptarët: “*Rrnoftë Shqipnija e vërtetë me kufijt e sajë etnik*”!

Kongresi, përveç vendimeve të tjera, nxori edhe konkludimin që sa më parë të thirret Kongresi V i LNDSH, i cili duhej të mbahej në një vend ku mund të merrnin pjesë përfaqësuesit e të gjitha kra-hinave shqiptare, me qëllim që të merret një vendim i përbashkët për një kryengritje të përgjithshme shqiptare.

Për tërë aktivitetin kombëtar që zhvillonte Halim Orana, OZNA ishte e njoftuar dhe së çdo lëvizje të tij e përcillte me një kujdes të veçantë. Ajo mori masa ndëshkuese kundër tij dhe anëtarëve të familjeve të tij.¹²⁴

Në kohën kur ishin burgosur pothuajse të gjithë anëtarët e KQ-së të Shkupit, Halimi Orana përsëri do t'i mbante lidhjet me jashtë përmes Zagrebit dhe me prof. Ymer Berishën i cili vepronte në Kosovë.

Halim Orana burgoset për të dytën herë në vitin 1947. Ekzistojë dy variante lidhur me burgosjen e Halim Oranës. *E para*, është

¹²⁴ . Dr.Daut Bislimi, vep. e cit., f. 148; sdhij edehe: Qerim Lita, vep. e cit., f. 165-168.

burgosur në më 10 shkurt 1947 në Zagreb, ndërsa varianti *i dytë*, sipas të dhënave (*Dosja 50-I-00002*)¹²⁵, sipas të cilit Halim Orana është burgosur më 15 shkurt 1947 në stacionin hekurudhor të Beogradit, i identifikuar tashmë si udhëheqësi kryesor i LNDSH-së. Arrestimi i tij ishte mbajtur i fshehtë nga familja deri në vitin 1948, kur gjatë vizitës së fundit që i kishte bërë i vëllai, Xhelali, kishte marrë vesh se Halimi ishte dënuar me vdekje, dhe se ky dënim iu kishte vërtetuar në të gjitha instancat. Halim Orana nga Burgu i Beogradit, me përcjellje të rreptë, vjen në Tetovë, në marsin e vitit 1947, për t'u ballafaquar me të burgosurit e KQ të LNDSH-së së Shkupit.

Data e saktë e ekzekutimit nuk dihet, por kur familjarët kishin shkuar në vizitë në prill të vitit 1948, personeli i burgut iu kishte thënë së më nuk mund ta vizitonin Halimin, sepse ai ishte pushkatuar. Ende nuk dihet vendi i pushkatimit dhe as varri i Halim Oranës.¹²⁶

8. Referat o "Nacionalno demokratskim komitetima. (e shkroi Kryeshefi i OZN-ës Luba Popović).

¹²⁶.Hamdi V.Thaqi, vep. e cit., f.649.

IZBER HOTI*Prishtinë***AJET GËRGURI SIMBOL I LUFTËS PËR
ÇLIRIM DHE DEMOKRACI**

Më vjen mirë që këtë jubile të Nacional Demokratikut Shqiptar po e shënojmë me përparime të konsiderueshme të trajtimit të së kaluarës së tij që nga koha e depërtimit të demokracisë edhe në këto anë, dëshirë kjo dhe pjesë e platformës së kësaj organizate për të cilën u angazhuan dhe u flijuan gjatë gjithë veprimtarisë pjesëtarë të shumtë të saj. Në fillim patëm, siç e dini, rropatje të ndryshme, sa me vendin e kohën e formimit, aq me karakterin, orientimin, synimin dhe veprimtarinë e saj. Bile, në këtë kohë shkarjet ishin aq të mëdha sa binim dhe përdornim me e pa vetëdije edhe semantikë dhe semasiologji armiqësore, ndërsa për vlerësime dhe studime shkencore as që mund të flitej.

Pas çlirimit të Kosovës dhe fillimit të depërtimit të demokratizmit të Shqipërisë dhe të viseve etnike shqiptare dhe hapjes "këndej e andej" kufirit artificial shqiptar,¹²⁷ si dhe pas shkrimit të kujtimeve e veprave të konsiderueshme mbështetur në vullnetin e madh të individëve pjesëmarrës dhe pasues të kësaj organizate, situata ka ndryshuar në të mirë të rrjedhave historiografike, duke iu afruar vlerësimit sublim të pjesëtarëve të rënë, të vdekur e të gjallë për liri e demokraci të të gjitha viseve shqiptare e pastaj edhe të bashkimit të tyre, që ishte dhe mbeti synim i vetëm edhe i njërit nga anëtarët dhe udhëheqësit e spikatur të Organizatës Demokratike Shqiptare –

¹²⁷ Arkivi e Kosovës, Fondi Gjqy i Qarkut Prishtinë 1946 (huazuar nga Shazije Gërguri – Hasanxhekaj, e bija e Ajet Gërgurit); Hysen Azemi, *LNDSh-ja dhe Sigurimi Shtetëror Serb 1945-1947*, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Prishtinë, 2014.

Ajet Gërgurit.¹²⁸ Këtu qëndron edhe mbështetja që jam përcaktuar për këtë personalitet, i cili, mendoj, nuk është vetëm anëtar e pastaj udhëheqës i Organizatës Nr. 2, por edhe përfaqësues i denjë i gjithë Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare, prandaj këtë qasje time e titullova: “Ajet Gërguri simbol i luftës për çlirim dhe demokraci”. Jam i sigurt se ky nuk është fare titull me vlerësim të tepruar as për Ajet Gërgurin dhe as për organizatën e Lëvizjen Nacional Demokratike Shqiptare. Veç kësaj, ky synim ishte dhe mbeti aktual për patriotë kudo që gjenden.

Çlirimi dhe bashkimi kombëtar si i vetmi synim jetësor e shpirtëror dëshmohen edhe nga jeta dhe veprimtaria e Ajet Gërgurit. Me luftën kundër robërisë dhe për çlirim u edukua dhe u arsimua nga të vjetrit dhe nga rrjedhat historike të cilat i përjetoi dhe në të cilat mori pjesë. Për shpërnguljen e madhe të shqiptarëve më 1877/1878 nga Toplica kishte dëgjuar nga të afërmit e tij që e kishin përjetuar dhe assesi ta harronin,¹²⁹ ndërsa robërinë dhe shtypjen e pamëshirshme e përjetonte vetë, prandaj, siç thotë populli “pa i ra brisk fytyrës”, Ajet Gërguri iu bashkëngjiti forcave të armatosura të Lëvizjes Kombëtare të udhëhequr nga Azem Bejta. Mirëpo, siç dihet kjo lëvizje nuk e përjetoi plotësimin e dëshirës për çlirim dhe bashkim. Ajeti dhe shokët e pasuesit e tij nuk u gjuhëzuan ngase konsideronin se “fryma e nënshtrimit ndaj të huajve e dëmton Shqipërinë, prandaj nacionalizmi shqiptar duhej kultivuar me krenarinë kombëtare, sepse po u shua kjo, dëmtohej kombi”, prandaj patriotët e tillë që në fillim të vitit 1945 filluan luftën politike dhe ushtarake kundër ripushtimit jugosllav dhe vendosjes së sistemit socialist me formimin e Organizatës së Lëvizjes Nacional

¹²⁸ Mehmet Gërguri, *Ajet Gërguri dhe Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare (1945-1947)*, Prishtinë, 2007, f. 33.

¹²⁹ Po aty, f. 9.

Demokratike Shqiptare (OLDNSH), njëri nga themeluesit e së cilës ishte Ajet Gërguri.¹³⁰

Kthimi i i sërishëm në Kosovë i Ajet Gërgurit, që deri atëherë ishte i natyrshëm dhe në përputhje me qëllimet dhe synimet e tij jetësore. Ai nuk angazhohej vetëm për interesin e tij individual, sepse atë, pa dyshim, do ta gjente në Shqipëri, të cilën ai shumë e donte, por u kthye që të veprojë për bashkimin e vendlindjes së tij në kuadër të një shteti shqiptar – ëndërr e pashuar e Ajetit dhe bashkëmendimtarëve të tij. Mirëqenie për vete dhe familjen e tij ngushtë ky patriot mund të siguronte edhe si drejtor i Pemishtes së Podujevës, sepse kjo nuk ishte pozitë e parëndësishme për kohën dhe i përgjigjej plotësisht përgatitjes së tij shkollore. Megjithatë, ai zgjodhi rrugën e kundërvënies së hapur dhe luftës së armatosur, sepse me rrjedhat shoqërore ndërmjet dy luftërave pas shuarjes së Luftës së Armatosur të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare (më 1928), si dhe të Luftës së Dytë Botërore, nuk u pajtua asnjëherë. Pas formimit të OLNDSSH – së Ajet Gërguri nuk do të kursejë asgjë për kauzën e tij. Me bashkëmendimtarë dhe bashkëveprimtarë do të krijojë komitete në fshatrat e qytetet të Kosovës, do të vejë lidhje me forcat kombëtare në anë të ndryshme të Kosovës dhe me gjerë, veçanërisht me Maqedoninë, sepse konsideronte se vetëm kështu do të formohej Shqipëria Etnike. Ai po kështu nuk do ta ndajë veprimtarinë politike nga veprimtaria e armatosur që u pa jo vetëm me organizimin dhe mbajtjen e Kongresit të Pestë në Blinajë, më 25 korrik 1945, por edhe me diskutimin e tij për veprim të armatosur, që u dëgjua me interesim nga të pranishmit.¹³¹

Qëndrimi i patundur i Ajet Gërgurit për të dy orientimet e luftës për çlirim dhe bashkim kombëtar – të luftës së armatosur dhe të politikës, dëshmohet nga puna e tij në rrethana të rrezikshme e

¹³⁰ Sabile Keçmezi-Basha, *Formimi dhe veprimtaria e Organizatës Ilegale Patriotike Shqiptare "Besa Kombëtare" në Kosovë* (www.shqiperiaetnike.de)

¹³¹ Dr. Sabile Keçmezi-Basha, *Lëvizja Ilegale Patriotike Shqiptare në Kosovë (1945-1947)*, Rilindja, Prishtinë, 1998, f. 26.

përherë të përcjellë nga pushteti pushtues dhe bashkëpunëtorët e tij. Ai, vetë, por edhe me shokë bashkonte individë të dëshmuar me qëndrimet patriotike e demokratike, por edhe duke formuar komitete e nën komitete, si dhe forca të armatosura, të cilave nuk u mungonin as aksionet konkrete të armatosura, veçanërisht ndaj pushtuesve dhe bashkëpunëtorëve të tyre që dalloheshin me ndjekjen, frikësimin, torturimin dhe vrasjen e atyre që i kundërviheshin pushtimit dhe të të ashtuquajturit pushtet popullor.¹³²

Vendosmërinë dhe përkushtimin shpirtëror të Ajete Gërgurit për zbatimin e platformës dhe programit të OLND SH e çmonin shumë edhe bashkëmendimtarët dhe bashkëveprimtarët e tij. Për këtë arsye pas riorganizimit dhe të ristrukturimit të kësaj lëvizjeje ai u caktua që të udhëhiqte me Organizatën nr. 2, ndërsa u bë edhe anëtar i Komitetit Qendror dhe Byrosë Politike të kësaj organizate, besim ky të cilin Ajete Gërguri e kreu me nder dhe sukses. Ajeti shquhej veçanërisht si demokrat që nuk mbyti nismat e të tjerëve, por që kur merren vendimet nga bashkëlufëtarët dhe përkrahësit e tyre i zbatonte dhe kërkonte të zbatoheshin me përpikëri. Ai nuk urdhëronte si ndonjë burokrat apo prijtar i rremë popullorë, por vetë i printe veprimtarisë dhe veprimeve të saj. Për këtë arsye ai sa gjendej në Drenicë, sa në Maqedoni, sa në Llap e Gallap... Për përhapjen e kauzës së tij nuk zgjidhte njerëz, vend e kohë. Bashkëpunonte edhe me ata që kishin synime kombëtare, por hë për hë ishin në organet e “pushtetit popullor”, por edhe me ata që ishin të dëshmuar gjatë Luftës si antifashistë dhe ishin zhgënjyer, apo edhe me ata të orientimeve si anti nacionalçlirimtare si p. sh. Me ata që kishin punuar në qeveritë e përkohshme apo Lëvizja e Kryezinjve. Me vullnet dhe i prire nga vendimet demokratike do të pajtohej që një pjesë e LND SH—së të kalojë në Maqedoni e Greqi, ndërsa vetë vazhdoi veprimtarinë në Kosovë. Qëndrimin e tij të patundur për këtë çështje do ta pranojë edhe në deklaratat e tij në

¹³² Si shënim 1, f. 306 e tutje (Biografi të disa personalitetëve të lëvizjes së ndsh-së).

hetuesi, nga të cilat shihet se për një qëndrim dhe vendim të tillë fare nuk ishte penduar. Në këtë frymë Ajet Gërguri në çdo veprim dëshmohej demokrat i mirëfilltët dhe prandaj veprimtaria e tij dhe e lëvizje, përkatësisht organizatës së tij u përhap shumë shpejt dhe me përmasa të mëdha, ndërsa u zu falë tradhtisë për të cilën nuk foli dhe nuk ndërroi mendje se Kosova ka një histori të madhe të cilën do ta dëshmojë brezi i ri. Me këtë qëndrim dhe sjellje të demokratit dhe atdhetari ai zhveshi propagandën e të ashtuquajturit pushtet popullor dhe ua tërhoqi vërejtjen të lajthiturve shqiptarëve për veprimet e qëndrimet e tyre. Njëherazi në këtë mënyrë bindi opinionin e brendshëm se edhe ndër shqiptarë ka njerëz të tillë që populli, prandaj Ajet gurguri u pushkatua tinëz sa as sot e kësaj dite nuk dihet vendi i sakët i pushkatimit.

Vendi i pushkatimit i Ajet Gërgurit dhe bashkëlufetarëve të tij, sikurse edhe vetë lufta e tyre për çlirim, bashkim kombëtar dhe demokraci, u fsheh deri vonë, por flijimi dhe synimi i tyre do të jetë frymëzim dhe udhërrëfyes për gjeneratat e pastajme. Që nga ajo kohë në Kosovë dhe në viset e tjera etnike shqiptare nuk do të mungojnë e patriotë, të cilët do të flijojnë edhe jetën për t'i dalë zot atdheut të robëruar dhe që këta do të mbeten për jetë shembuj të shkëlqyer të atdhetarizmit. Po kështu, intelektualë të fushave të ndryshme në forma dhe mënyrë të llojllojshme nuk do të harrojnë dhe do t'i kujtojnë këta patriotë dhe, edhe pse fshehtas, efekti i ndikimit të synimeve dhe sakrificës së tyre do të jetë i madh.

Edhe diçka vetëm për Organizatën Nr. 2.

Historiografia e Organizatës Nr. 2, është e ngjashme me atë të vetë Lëvizjes, përkatësisht Organizatës NDSH. Formimi dhe veprimtaria e saj filloi të ndriçohej vetëm kohëve të fundit, veçanërisht pas hapjes së arkivave për këtë periudhë dhe për këtë lëvizje. Vërtet, përditë e më shumë po dëshmohet se kjo organizate jo vetëm që mbante numrin simbolik 2, por edhe për kah rëndësia dhe përgjegjësia ishte e dyta. Ajo u shtri në pjesën më të madhe të Kosovës, duke formuar organizata të njëpasnjëshme dhe duke

bindur masat shqiptare për platformën dhe kauzën e vet – luftën politike dhe ushtarake kundër ripushtimi të viseve shqiptare, si dhe që këtu të vihej një pushtet demokratik properëndimor.

Ani pse kjo organizatë nuk ishte plotësisht kundër largimit nga trevat shqiptare, nën ndikimin e mendimit të kryetarit të saj, angazhohej që të shfrytëzoheshin dhe zbatoheshin të gjitha mënyrat dhe mjetet që sa më shumë që qëndrohej e veprimeve në këto vise. Veç kësaj, sekretari i Organizatës Nr. 2, Gjon Serreqi, ishte i njohur si intelektual dhe personalitet me famë, që nuk mund dhe nuk injorohej nga anëtarët e këtij subjekti kombëtar. Ndoshta, në këtë frymë do shquar edhe të dhënë se terreni ku vepronte kjo organizatë ishte dëshmuar me zhvillimin e luftës së armatosur dhe me qëndrimin e papërkulur, prandaj ndikimi ishte i madh.¹³³ Natyrisht, nuk mendoj se hulumtimeve dhe trajtimeve të deritashme i është vënë pikë. Ato do të vazhdojnë dhe brezi i ri do thellohet dhe zgjerohet edhe më shumë në këto çështje.

¹³³ Emil Kastrioti, *Epopeja e Besëlidhjes Kombëtare Demokratike Shqiptare (B.K.D.Sh) që nga themelimi i saj më 12 shtator 1943 e deri sot* (www.zemra-shqiptare.net, e premte, 03.10.2008)

NAIM HALIMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

HISTORIOGRAFIA SHQIPTARE DHE AJO E HUAJ PËR DHE RRETH VEPRIMTARISË ATDHETARE TË NDSH-SË

Shkuarja e një sistemi (monist) dhe ardhja e një tjetri (pluralist), mundësoi që edhe shkencë e historisë të pësojë ndryshime, të zhvillohet më shkencërisht, sidomos historia jonë kombëtare. Këtë liri mendimi e shprehjeje, e shfrytëzuan edhe disa studjues tanë, historianë entuziastë, bashkohorë, të cilët me seriozitetin më të madh iu rrekën punës për rishikimin, rivlerësimin dhe publikimin e historisë sonë kombëtare, e cila për shkaqe të njohura nuk ishte shkruar ashtu si duhej, madje as nuk ishte mësuar.

Fjala është për një pjesë të historisë sonë kombëtare që nuk i konvenonte klasës politike sunduese (socialiste-komuniste), e cila e caktonte shkrimin e historisë ashtu si i konvenonte asaj, ashtu që shumë personalitete e ngjarje, u definuan si armiqësore, anti-popullore, anti-shtetërore, anti-shkencore, etj.etj., dhe si të tilla, u anashkaluan, u marginalizuan, u lanë në harresë, nuk u studiuan, nuk u mësuar mirë, apo mbrapshtë u shkruan, u studiuan e u shpjeguan. Kështu, këtyre ngjarjeve, padrejtësisht iu bë hile dhe nuk iu dha vendi i merituar në histori.

Një ngjarje e tillë që edhe NDSH-ja shqiptare.

Kësaj ngjarje të madhe të pas luftës mbarëbotërore (të viteve ‘45–‘51), e cila që vazhdim i Lëvizjes sonë kombëtare dhe e luftës për liri e bashkim që u zhvillua në trevat shqiptare lindore, që mbetën padrejtësisht jashta shtetit amë, në Jugosllavi, po i jep një vend të merituar historiografia shqiptare, respektivisht historianë tanë të

liruar nga e kaluara, me publikimet e tyre, të mbështetura në faktografi të qëndrueshme të kohës (në burime arkivore të proveniençës së OZN–ës, në procesverbalet e dala nga hetuesia, nga aktgjykimet, nga proceset gjyqësore të prijësve dhe të antarëve të komiteteve të NDSH–ës, në vendet ku vepronin ato, kuptohet edhe në Shkup, ku qe një kohë edhe qendra e saj, si dhe studimi i subjektit njeri, pjesëmarrës aktiv në këto ngjarje me peshë historike), disa prej të cilave po i paraqesim sot këtu:

–Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve, (Redaktor përgjegjës: Prof.dr.Hysni Myzyri), Prizren, 2001.

–Dr. Muhamet Pirraku, Mulla Idriz Gjilani dhe mbrojtëja kombëtare e Kosovës Lindore 1941–1951, Prishtinë, 1995.

–Në 50–vjetorin e Kongresit të Lipovicës, Rilindja, Tiranë, 28.08.1996.

–Lëvizja për lirin e tokave shqiptare, “Zëri” nr.1468, Prishtinë, 1992.

–Dr.Sabile Keçmezi–Basha, Lëvizja Ilegale patriotike shqiptare në Kosovë (1945–1947), Prishtinë, 1998.

–Dr.Daut Bislimi, Formacionet politiko–ushtrake në Kosovë (1945–1947), Prishtinë, 1997.

–Një vështrim historik i organizatës së NDSH–së LPLTSH–së, Shkup, 1997.

–Prof.dr.Ismet Dërmaku, Gjon Sereçi dhe NDSH–ja (dokumente arkivore), Prishtinë, 1996.

–Qerim Lita, Organizata Nacional–Demokratike Shqiptare në Shkup, ITSHKSH–Shkup, “Studime Albanologjike”, nr.6.

–Personaliteti i Azem Maranës dhe KQ i NDSH–së, fehton i „Flakës”Shkup, 4–6.09.2002.

- Qerim Lita, F.Sh.D.B., Azem Marana dhe veprimtaria e NDSH–ës–LpLTSH në Maqedoni, Shkup, 1997.
- Qerim Lita, Shaban Efendia, atdhetar i devotshëm, Kumanovë, 2010.
- Qerim Lita, Kontributi i H.Mexhit Zyberit në organizimin e NDSH–ës në rajonin e Karadakut, (fejton i Flakës), Shkup, 6–7 mars 2003.
- Qerim Lita, Mulla Hajdari i Orizarës, bashkëluftëtar i Sulë Hotlës, kumesë në “Qëndresa shqiptare në Karadakun e Kumanovës gjatë Luftës së Dytë Botërore”, Kumanovë, 2005.
- Qerim Lita, *Naçertania, K.Cërvenkovski dhe identiteti shqiptar në Maqedoni (1945–1954)*, Shkup, 2007.
- Qerim Lita, Inkuadrimi i antarëve të NDSH–ës në arsimin dhe kulturën shqiptare, “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 30 shtator 2004.
- Qerim Lita, Azem Marana, themelues i shkollave shqipe në Karshiakë, “Fakti”, Shkup, 7 mars 2006.
- Qerim Lita, Territoret shqiptare lindore 1912–1960 (punime studimore), Vatra, Shkup, 2016.
- Muhamet Pirraku: “Mulla Idris Gjilani dhe mbrojtja kombëtare e Kosovës Lindore 1941–1951”, Prishtinë, 1995
- Muhamet Pirraku: “Ripushtimi jugosllav i Kosovës, 1945”, Prishtinë, 1992
- Eugen Shehu: “Piedestale që thërrasin”, Tiranë, 2000
- Fejzulla Shabani: “Organizimi, veprimtaria dhe formimi i Ballit Kombëtar në Maqedoni”, Tetovë, 2004
- Tefik Jahiu: “Masakrat serbosllave–maqedonase ndaj shqiptarëve në Karadak”, Shkup, 2000

- “Qëndresa Shqiptare në Karadakun e Kumanovës gjatë Luftës së Dytë Botërore”, (përgatiti për botim: S.Demiri), Kumanovë, 2005
- Sevdail Demiri, “Flakadani i rezistencës karadakiane”, KSH Jehona e Karadakut, Kumanovë, 2006
- “Kumanova për flamur, NDSH–UÇK” (botim i plotësuar), Kësh. red: V.Sejdiu, S.Demiri, S.Shabani, Kumanovë, 2008
- Ibrahim Kelmendi: “Një shtyllë e Kosovës quhet Preshevë”, Preshevë, 2006
- Vebi Xhemali: “Forcat kombëtare në mbrojtje të Shqipërisë etnike (1941–1945)”, Tetovë, 2006
- “Lidhja kosovare, kongresi i parë botnuer, Chikago 24–25 nanduer 1973”, (nuk ka vend dhe datë të botimit)
- “Bllaca mes dhembjes dhe krenarisë”, botim i B.L. –Bllacë, Shkup, 2004
- Nazmi Beqiri: “Këngët e kaçakëve në malësinë e Karadakut”, Kumanovë, 2006
- Nafi Çegrani: “Ballë për ballë me vdekjen – 1”, Shkup, 2000
- Ibrahim Krosi: “Qemal Skenderi dhe NDSH–ja në Dërven të Shkupit”, Shkup, 2002
- Begzat Begzati: “Xhemë Hasa, ushtarak – demokrat”, Tetovë, 1995
- Esat Bilali: “Shkrime historike, (Kosovë, Tetovë, Gostivar, Kërçovë)”, Tiranë, 2001
- Rexhep Bunjaku, 50–vjetori i likuidimit fizik të LNDSH–së, “Bujku” (Rilindja), Prishtinë, 23–gusht–5 shtator 1996.
- Muhamet Dushku, Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare 1943–1965, Prishtinë, 2001.

–Sabri Maxhuni–Novosella & Behxhet I.Thaçi, Vizioni i NDSH–së madhështore po realizohet, Prishtinë, 2011.

–Azam Dauti, Procesi gjyqësor kundër aktivistëve të Komitetit Nacional Demokratik Shqiptar në vitin 1947 në Shkup, “Globi”, nr.1. Tetor 1994, nr.2, Dhjetor 1994, Shkup.

–Hilmi Shehu, Si e njoha Azem Moranën, “Globi”, nr.8, Shkup, 1997.

–Shema e organizimit të Komiteteve për Lirimin e tokave shqiptare dhe Programi i “Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare”, KQ i NDSH–së, 1.VI.1946, nr.1.

–Gazeta “Rilindja”, Prishtinë, 7.II.1947, Organizata terroriste e partisë Nacional–Demokratike Shqiptare para gjyqit të popullit në Shkup.

–Fejtoni i „Globit”, Shkup, 1996/97 (Procesi gjyqësor kundër aktivistëve të NDSH–ës, në vitin 1947 në Shkup).

–Besim Kajtazi, Gjurmëve të “Komitetit Nacional Demokratik Shqiptar”, “Ora”, nr.10–20, Prishtinë, 1991.

–Fejzi Bojku, Tetë ditë gjykimi – dënime edhe me vdekje, “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 27.02.1995.

–Tetë ditë gjykimi të anëtarëve të NDSH–së 1947(28.01.–09.02.1947), Procesi gjyqësor i përcjellë nga gazeta maqedonase „Nova Makedonija”, Shkup.

Për sa i takon historiografisë së huaj, botërore, kjo ngjarje që për historinë duket e vogël, por për ne, dhe për shkencat shoqërore bashkohore, e madhe, me vlera njerëzore, çlirimtare, demokratike, liridashëse e progresive, po i jepë vendin e merituar.

Fatkeqësishtë, vetëm historiografia sllave, edhe ajo maqedonase, e ka minimizuar dhe vlerësuar si armiqsore, në mënyrë jo shkencore (si psh. Vepra “Velikoalbanskata igra vo Makedonija”, Skopje, 1994, e Dr.Tome Batkovskit dhe e të tjerëve si ky).

Pavarësisht nga kjo, historiografia shqiptare, dhe ajo bashkohore botërore, po e thotë të vërtetën, fjalën kryesore për këtë, për NDSH-në, po i jepë vendin e merituar, kuptohet në bazë të meritës, vlerat e të cilës u prezantuan edhe në Shkup, në këtë konferencë.

NURIDIN AHMETI

Instituti Albanologjik – Prishtinë

KONTRIBUTI I KRERËVE FETARË NGA KOSOVA NË LËVIZJEN NACIONAL- DEMOKRATIKE SHQIPTARE

Hyrje

Njëra ndër lëvizjet me karakter nacional gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, në mesin e së cilës kishte të inkuadruara edhe figura fetare, deri edhe në postet më të besueshme, ishte edhe Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare.

Ky fenomen, nuk është i rastësishëm në historinë e lëvizjeve nacionale e shoqërore të shqiptarët, sepse nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e vitit 1878, Lidhja e Pejës e vitit 1899, kryengritjet e vitit 1908–1912, Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë më 1912, Komiteti Mbrojta Kombëtare e Kosovës e vitit 1918, Lidhja e Dytë e Prizrenit e vitit 1943 etj., personalitete nga radhët e klerikëve na figurojnë si pjesëmarrës, udhëheqës, ideologë etj. Kjo gjë tanimë është e vërtetuar katërcipërisht edhe përmes dokumentacionit të kohës, që krerët fetarë shqiptarë të të gjitha feve kontribuan në lëvizjet tona me karakter nacional dhe kombëtar.

Edhe pse nuk mund të flasësh në mënyrë përgjithësuese për asnjë komunitet fetar, politik e shoqëror, që të gjithë ata ishin në vijën kombëtare, apo e kundërta. Fatkeqësisht, një ndarje e tillë në historiografinë tonë ka qenë evidente, e me disa përjashtime edhe sot ka trajtime të tilla nga disa historianë, ku një komunitet i caktuar shihet bardh dhe zi, apo vlerësohet një komunitet i caktuar të shqiptarët dhe komuniteti, apo figurat fetare të një komuniteti të caktuar, pothuajse injorohen.

Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare

Viti 1943 kur shënon edhe fillet e formimit të Lëvizjes Nacionale Demokratike Shqiptare në Kosovë, dhe më pas formimin më 1945, e cila organizatë vazhdon veprimtarinë me këtë emër deri më 1947.¹³⁴ Me formimin e NDSH-së, udhëheqësit e kësaj organizate do t'u ofronin poste edhe krerëve tanë fetarë. Për mendimin tim, ky veprim për t'u ofruar poste udhëheqëse edhe njerëzve me dije dhe formim shpirtëror, ishte mjaft largpamës, sepse shoqëria jonë në kohën për të cilën po flasim, ende kishte një bazament të fortë shpirtëror, dhe faktori fetar ishte i rëndësishëm, sikurse edhe mentaliteti fisnor ishte mjaft prezent. Prandaj, inkuadrimi i të parëve të shoqërisë dhe të një komuniteti fetar, sigurisht që këtë lëvizje do ta bënte edhe më të afërueshme te popullata. Me një fjalë, populli do ta merrte si diçka të vetën, që në fakt edhe ashtu ndodhi. Populli ynë këtë lëvizje, pra NDSH-në e përkrahu duke e mbështeti me të gjitha mundësitë që kishin në dispozicion.¹³⁵

Nuk dua të thellohem në analizë të secilit person që do të përmend më poshtë, për arsye se për pjesën dërmuese të emrave të cilët do t'i cekim më poshtë, janë shkruar punime,¹³⁶ monografi, janë mbajtur organizime shkencore, janë mbrojtur tema të diplomës, masterit e doktoraturës.

Ndër prijësit fetarë që u inkuadruan në këtë organizatë ishin: Hfz. Ymer Shemsiu, i cili ndoqi mësimet e mesme fillimisht në Medresenë e Prishtinës e pastaj në atë të Shkupit, Idriz Hajrullahu – apo siç është i njohur në historiografinë e re shqiptare si Mulla Idriz

¹³⁴ Sabile Keçmezi-Basha, "Formimi dhe veprimtaria e organizatës Nacional Demokratike Shqiptare 1945-1948", *Kosova*, nr.18/19, Prishtinë 1996, f. 171-185

¹³⁵ Muhamet Shtari, "Mbi Lëvizjen Nacional Demokratike Shqiptare në Kosovë dhe në trevat tjerat shqiptare 1945-1947", *Kosova*, nr. 20/21, IH, Prishtinë, 1998/1999, f. 185-208

¹³⁶ Ramdan Shkodra, "Roli i imamëve dhe i ulemave në Lëvizjen Nacional Demokratike Shqiptare", *Myderriz Sadri ef. Prestreshi jeta dhe vepra (1917-2002)*, BIK, Prishtinë, 2013, f. 37-51


Gjilani, Ibrahim Lutfiu nga Prizreni, sekretar i përgjithshëm i Rijasetit të Bashkësisë Islame të asaj kohe me seli në Sarajevë, ndërsa gjatë Luftës së Dytë Botërore prefekt i Mitrovicës. Haki Taib Salihu apo siç njihet në popull, Myderriz Haki ef. Sernaxhaj u lind më 14 tetor 1914, në Hogosht të Kamenicës, nxënës i Medresesë “Meddah” të Shkupit, në vitin 1927/28, dhe student i myderrizit Atallah ef. Kurtishi nga Shkupi. Mulla Iljaz (Hysen) Broja i lindur në fshatin Brojë të Drenicës, nxënës i medresesë në Gjakovë, i cili shërbeu imam në Brojë dhe në disa vende të tjera të Drenicës. Mulla Januz Abazi – Lubishta nga Lubishta e Vitisë, Arif ef. Shala, nga Drenica . Mulla Zekë Bërdynaj, u lind rreth vitit 1918, në fshatin Novosellë të Pejës. Haxhi hafiz Jakub Dukagjini – Muqeziu, Mulla Nuredin (Halit) Gjinovci (1895–1954) ishte kryetar i Komunës së Therandës dhe veprimtar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ndërmjet dy luftërave botërore (1918–1941). Në vitin 1943 u zgjodh kryetar i Komitetit Qarkor të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe deputet i Therandës në Kuvendin e Shqipërisë (1943–1944). Mulla Hamit Sllovia, u lind më 1919, në fshatin Sllovi të Lipjanit. Myderriz Sadri Prestreshi, u lind më 17 tetor 1917, në katundin Mazgit, në rrethin e Prishtinës, i njohur nga NDSH–istët me nofkën “Shpresimi”.

Në radhët e prijësve nga tarikatet dallohen me veprimtarinë në këtë organizatë Sheh Myhedini i Rahovecit dhe Sheh Hasani i Prizrenit, udhëheqës të tarikait “Halveti”.

Ndërsa, nga radhët e klerit katolik spikatin emrat e At Bernard Llupit, me origjinë nga Shkodra, ndërsa më 8 qershor 1942 fillon detyrën e meshtarit në Pejë. Ai kryente detyrën edhe të eprorit françeskan për famullinë e Zllakuqanit, të Zymit, të Hasit, si dhe për dy kisha katolike në Gjakovë. Më 24 nëntor 1946 pushkatohet nga forcat komuniste, me akuzën se ishte bashkëpunëtor i NDSH–së dhe shumë klerikë të tjerë.

Në këtë punim kemi veçuar disa figura përfaqësuese të krerëve fetarë të kohës, të cilët ishin inkuadruar LNDSh dhe dhanë kontribut të çmuar.

Mulla Nuredin (Halit) Gjinovci (1895–1954)



(AK, F. Gjykata e Qarkut në Prizren, Lënda—penalja 38/48, V. 1948, D. Nuredin Haliti, f. 1)

Është nga ata prijës fetar, që krahas kontributit shpirtëror, veprimtarisë në NDSH, ishte ndër mësuesit e parë të gjuhës shqipe në vendlindjen e tij dhe ndër iniciatorët kryesor për shkollimin e femrës në vendon ku jetoi dhe veproi, edhe sot e kësaj dite nuk i

dihet varri. Mendoj, se kundruall veprimtarisë së tij shpirtërore e kombëtare, nuk është shkruar shumë për jetën dhe veprën e tij.

Të dhënat e ofruara për këtë prijës fetarë nga dokumentet arkivore, thuhet se ka lindur më 1895 në fshatin Gjinovc të Suharekës.¹³⁷ Vjen nga një familje e njohur e rrethit të Suharekës, të cilët ishin të përkushtuar në të mirë të komunitetit ku jetuan. Babai Haliti,¹³⁸ kishte ndërruar jetë kur Nurdini ishte i në moshë të re. Ndërsa, përkujdesjen ndaj tij e merr xhaxhai Sherif Bajram Haxhijaj. Ishte i rritur në një familje të madhe të Agajve të Suharekës, në oden e të cilëve gjenin konak përherë figura të njohura të Lëvizjes Kombëtare. Ky ishte edhe kontakti i parë i Nuredin Halitit me krerët e Lëvizjes Kombëtare të kohës. Në këtë rrethana, jo fortë të favorshme në aspektin, Nuredin Haliti, kryen shkollën fillore në vendlindje, për të vazhduam më pas në Medresenë e Shkupit.¹³⁹

Pas mbarimit të Medresesë në Shkup, kthehet në vendlindje në detyrën e imanit dhe ligjëruesit. Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore një pjesë e konsiderueshme e prijësve fetarë të shqiptarët, e kryen edhe detyrën e mësuesit në gjuhën shqipe. Në mesin e prijësve fetarë myslimanë të cilët krahas detyrës së imanit, kryen edhe punë e pedagogut për mësim në gjuhën shqipe ishte edhe Mulla Nura i Gjinovicit të Suharekës, apo siç njihet edhe ndryshe Mulla Nuredin Haliti. Vlen të potencohet se ky njeri, me pëlqimin e xhaxhit të tij, shtëpinë ku jetonin e adaptoi në shkollë mësimin e gjuhës shqipe për fëmijët e fshatit të tij dhe fshatrave të tjerë për rreth. Mulla Nura u bë ndër promotorët e parë të mësimin në gjuhën shqipe në këtë anë. Nga të dhënat biografike për këtë personalitet, por edhe nga kujtesa që sot ruajnë të moshuarit e

¹³⁷ Arkivi i Kosovës (më tej: AK), Fondi(më tej: F), Gjykata e Qarkut në Prizren, Lënda-penalja 38/48, Viti(më tej: V), 1948, Dosja (më tej: D), Nuredin Haliti, f. 1

¹³⁸ AK, F. Gjykata e Qarkut në Prizren, Lënda-penalja 38/48, V. 1948, D. Nuredin Haliti, f. 1

¹³⁹ Rrahman Rexhaj, “Nuredin Halit Haxhijaj sakrifikoj veten për liri e bashkim kombëtar”, *Kosova Sot*, Prishtinë, 30, 31, dhjetor 2009, 1 e 2 janar, 2010, f. 145

rrethinës së Suharekës për Mulla Nuren, është se ky njëri ishte nga të paret që inicioi shkollimin e femrës në gjuhën shqipe të kësaj ane, duke propaganduar në mas dhe dërguar të bien e tij në shkollë.¹⁴⁰

Veprimtaria e tij kombëtare dhe autoriteti në rrethinën ku jetonte dhe vepronte Mulla Nura, i bindi autoritet e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, që t'ia besonin edhe postin udhëheqës të kësaj organizate për Suharekë dhe rrethinë dhe ta mbajnë afër si njeri të besueshëm.¹⁴¹ Përveç postit të kryetarit të LDP, Mulla Nures, i besohet edhe posti i kryetarit të shoqatës “Besa”, e cila aso kohe vepronte në Suharekë dhe rrethinë dhe në veprimtarin e sajë përfshinte edhe pajtimin e gjaqeve.¹⁴²

U angazhua në Organizatën Nacional Demokratike Shqiptare si udhëheqës për Suharekë dhe rrethinë. Veprimtaria e dëndur e tij kombëtare, bie në sytë të OZNA-së, më 1944 arrestohet dhe dënohet më 9 vjet burg.¹⁴³ Nga torturat vdes në burgun e Nishit, gjashtë muaj para kryerjes së dënimit të rregullt. Edhe sot e kësaj dite nuk dihet varri i tij.

Ishte nga ata veprimtarët e njohur të asaj ane, edhe sot popullata e Suharekës e kujton me mjaft pietet veprimtarinë e tij kombëtare dhe shpirtërore. Në nderim të kësaj figure pas luftës së fundit në Kosovë, Kuvendi komunal i Therandës, për kontributin e dhënë çështjes kombëtare dhe në të mirë të vendit ku lindi dhe shërbeu, një rrugë në qendër të qytetit, ia vendosin emrin e tij.¹⁴⁴ Këto

¹⁴⁰ Rrahman Rexhaj, *Pun. i cit.*

¹⁴¹ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, IH, Prishtinë, 1997, f. 2003

¹⁴² Zeliqe Shala, *Suhareka gjatë Luftës së Dytë Botërore 1941-1945*, ASHAK, Prishtinë, 2016, f. 102

¹⁴³ AK, F. Gjykata e Qarkut në Prizren, Lënda-penalja 38/48, V. 1948, D. Nuredin Haliti, f. 8

¹⁴⁴ <http://kk.rks-gov.net/suhareke/getattachment/Files/VENDBANIMET/Suhareke.pdf.aspx>

veprime janë edhe një tregues se personalitetit të Mulla Nures, do t'i jepet vendi merititor edhe në librat e historisë.

Shejh Myhedini nga Rahoveci dhe Shejh Hasani nga Prizreni

Është për tu theksuar se në mesin e krerëve fetarë myslimanë të inkuadruar në Organizatën Nacional Demokratike Shqiptare, ishin edhe Shejh Myhedini nga Rahoveci dhe Shejh Hasani nga Prizreni.¹⁴⁵ Për më tepër Shejh Myhedini mbante nofkën “Jemen” në organizimet ilegale.¹⁴⁶ Dy këto personalitete, vinin nga radhët e tarikateve, konkretisht të tarikatit “Halveti”. Sheh Myhedini nga organet e sotme shtetërore të Kosovës u vlerësua “si personalitet i rëndësishëm në organizimin e të gjitha formave të rezistencës kombëtare në periudhën 1941–1999. Burim frymëzimi jo vetëm për Rahovecin, por edhe më gjerë”.¹⁴⁷ Ndërsa zyra e presidentit të Kosovës, këtij personaliteti i ka ndarë dekoratën “Urdhri i lirisë”.¹⁴⁸ Sheh Myhedini, ekzekutohet në Tegenë e Madhe të Halvetive në Rahovec, aty ku shërbeu terë jetën më 21 korrik të vitit 1998.

At Bernard Llupi (1886–1945)

Në radhët e NDSH-së, kishte pjestarë edhe nga krerët fetarë katolik, të cilët u bënë ndihmesë e mirë e këtyre pjesëtarëve. Kemi shkruar për At Bernard Llupim sepse nga literatura dhe dokumentacioni arkivor, rezulton te jetë i dënuar në Kosovë, si pjesëtar që përkrahu, krahun nacionalist shqiptar. Ajo që dihet nga biografia e tij, është se ky njeri ishte i veshur me petkun e krerit fetar katolik dhe i lindur në Shkodër më 1886.

Në kohën kur arrestohej, nga organet e atëhershme të sigurimit në Kosovës, ky ishte në shërbim në famullinë e kishës katolike në Pejë.

¹⁴⁵ AK, F. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, Lënda-penalja 172/46, V. 1946, f. 1

¹⁴⁶ Ethem Çeku, *Shekulli i ilegales*, Prishtinë, 2004, f. 112, 127

¹⁴⁷ <http://kryeministri-ks.net/?page=1,9,3666>

¹⁴⁸ <http://www.president-ks.gov.net/?page=1,128>

Njohësit e veprimtarisë së tij, potencojnë se pas arrestimit të tij, dhe torturimeve të vazhdueshme nga organet e sigurimit, me qëllim të nxjerrjes së informatave edhe për veprimtarë të tjerë, At Bernard Llupi tregohet i palëkundur ndaj shkoje dhe miqve me të cilët bashkëpunoi, nuk nxori asnjë informatë, për çka i kushtoj edhe me jetë, pushkatim.¹⁴⁹

Në aktakuzën ndaj tij dhe grupit me të cilët u dënuan, për At Bernard Llupe thuhej se ka qenë aktiv në çlirimin e vendit, dhe shihej qartë se ka ndihmuar pjesëtarët e nacionalistë shqiptarë, në organizim dhe në forma të tjera të organizimit, me një fjalë për organet e atëhershme hetuese ky njeri ishte” një nga shtyllat ma te forta të krejt veprimit amniqsuer...”,¹⁵⁰

Për përkrahjen e dhënë dhe vendosmërinë e tij, për mos të nxjerrë emra të shokëve të ilegales shqiptare, me të cilët bashkëpunoi, Gjykata e Prizrenit e dënoi më 1945 me pushkatim.

Duke u mbështetur në dhënat nga terrenit, mendojmë se duhet të ketë pasur edhe pjesëtarëve tjerë nga radhët e krerëve katolikë shqiptarë, që ndihmuar organizatat nacionaliste shqiptare në këtë kohë, por si i dënuar për këtë veprimtari në Kosovë, na del vetëm emri i Bernard Llupe.

Si përfundim

Nga burimet arkivore të shfletuara dhe nga literatura e konsultuar na rezulton se numri i krerëve fetarë në radhët e organizatave me karakter nacional, por edhe në NDSH, është më i madh se ky që përmendëm më sipër. Ata, në këtë lëvizje i gjejmë si përkrahës, anëtarë aktiv, e një pjesë e tyre edhe mendimtarë dhe ndër themeluesit e kësaj lëvizjeje.

¹⁴⁹ Sabile Keçmezi-Basha, *Lëvizja ilegale patriotike shqiptare në Kosovë*, Rilindja, 1998, f. 175

¹⁵⁰ Ethem Çeku, *Vep. e cit.*, f. 160-162

Kontributi i krerëve fetarë shqiptarë ishte domethënës si me pjesëmarrje aktive në aksione, udhëheqje, por edhe duke u dhënë forcë pjesëtarëve të kësaj organizate përmes këshillave e veprave dhe reputacionit që ata kishin imponuar në masë ku jetonin dhe vepronin. Krerët tanë fetarë, i vunë në dispozicion të lëvizjes, dijen, mundin fizik, objektet ku shërbenin, si: xhamitë, teqetë e kishat.

Dhe krejt në fund me lejoni të them se krerët fetarë shqiptarë nuk ishin politikanë me profesion, por për çështje madhore kombëtare, në të mirë të vendit ata pranuan të bëjnë veprimtari të dyfishtë, veprimtari nën petkun e klerikut dhe veprimtarinë e njeriut të përkushtuar ndaj veprimtarisë kombëtare, andaj edhe obligimi i shkencës dhe i njerëzve të dijes ndaj këtyre figurave duhet të jetë i dyfishtë.

SEVDAIL DEMIRI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

ARRESTIMET DHE GJYKIMET E ANËTARËVE TË KOMITETIT TË NDSH-SË SË KUMANOVËS (1946/47)

Pushteti i ri komunist i instaluar në këto treva në vitin 1945, kishte sjellë ndryshime të mëdha në të gjitha strukturat shtetërore. Derisa ky pushtet me shumë vështirësi po tentonte të instalohej nëpër vendbanimet shqiptare, po krijonte edhe strukturat e veta informatore, përmes të cilave synonte kontrollimin e “elementeve armiqësore”.

Në anën tjetër, krahu kombëtar shqiptar, i cili nuk pajtohej me ideologjinë e kuqe pansllaviste, pikërisht në këto rrethana shumë të rënda për fatin e popullit tonë, kishte themeluar Organizatën Nacional-Demokratike Shqiptare, e cila shkurt thirrej NDSH. Kjo organizatë, të cilës i prinin emra të njohur të veprimtarëve dhe intelektuaëve të të gjitha trevave shqiptare, të mbetura nën Jugosllavi, vazhdoi përpjekjet për ta realizuar aspiratën shekullore të shqiptarëve për të qenë në krah të pupujve të avancuar europaerëndimor. Ata, zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare e shihnin përmes bashkimit të të gjitha trojeve shqiptare në një shtet të vetëm etnik shqiptar.

Që në fillimet e organizimit politik dhe ushtarak, NDSH-ja kishte shtrirë aktivitetin e saj edhe në rajonin e Karadakut të Kumanovës, si njësi kufitare dhe vazhdimisht e kërcënuar nga armiqtë grabitqarë të tokave shqiptare. Në atë kohë, në emër të “çlirimit”, aradhat e kuqe partizane, maqedono-bullgare, bënë kërdi nëpër dhjetëra

vendbanime shqiptare të Karadakut, duke djegur, vrarë e masakruar qindra shqiptarë të pafajshëm.

Në këtë kohë, figura kryesore e rezistencës kombëtare shqiptare në këto anë, ishte Sulë Hotla, me bashkëluftëtarët besnikë. Ai pati rolin kryesor edhe në themelimin e NDSH-së për këto anë.

Siç është zbardhur me kohë nga studiuesi Qerim Lita, Komiteti i NDSH-së për rajonin e Kumanovës themelohet në fshatin Orizare, në tetor të vitit 1945. Pas dy takimeve të ndara që i mban kreu i NDSH-së së Shkupit me Sulë Hotlën në Dimcë dhe Mulla Hajdarin në Shkup, në fund të tetorit 1945 formohet komiteti i NDSH-së për Kumanovë. Mbledhja mbahet në fshatin Orizare, saktësisht në shtëpinë e Zija Shabedit, ku marrin pjesë: Sulë Hotla me shokët e tij, Eshtrefin dhe Destanin, pastaj Mulla Hajdari, Hafuz Sali Ameti, Mulla Selveri, Sami Shabedini, Ali Aliu, Zija Shabedini dhe Çelebi Sulejmani. Me mbledhjen udhëheq Zija Sabedini, ndërsa fjalim mban Sulë Hotla i cili me këtë rast do të theksojë: *“Çështja shqiptare nuk ka mbaruar, por ajo së shpejti do të jetë në vëmendje të faktorit perendimor. Ju njoftoj se në Shkup funksionon organizata politike shqiptare e cila ka lidhje të ngushta me diplomacinë angleze dhe turke. Anglezët janë të interesuar për të na ndihmuar, mirëpo për këtë nevojitet organizimi jonë politik dhe ushtarak. Prandaj, ne sonte jemi mbledhur këtu për ta formuar Komitetin e NDSH-së për këtë regjion i cili do të merr përsipër të mirëmbajë çetën tonë ushtarake si në ushqim ashtu edhe në armatim, të formojë nënkomitetet e saja në të gjitha vendbanimet shqiptare, të mbajë lidhje të drejtëpërdrejta me Qendrën në Shkup, etj.”* Pas fjalimit të Sulë Hotlës zgjedhet kreu i Komitetit të NDSH-së për Kumanovën, ku kryetar me propozim të Sulës zgjedhet Mulla Hajdari, nënkryetarë Hafuz Sali Ameti dhe Mulla Selveri, sekretar Sami Shabedini, arkëtar Ali Aliu, ndërsa anëtarë Zija Shabedini dhe Çelebi Sulejmani¹⁵¹. Kjo strukturë ishte e

¹⁵¹ Qerim Lita, kumtesë në “Rezistenca Kombëtare Shqiptare në Karadakun e Kumanovës gjatë Luftës së Dytë Botërore”, Kumanovë, 2005.

përbërë kryesisht nga veprimtarë të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, të cilët në shtator të vitit 1944, për herë të parë ngritën flamurin kombëtar shqiptar në Mateç, dhe e shpallën këtë zonë të lirë dhe të bashkuar me trojet tjera shqiptare.

Ndërkohë, pas formimit të Komitetit të Kumanovës në Orizare, u intensifikuan aktivitetet për themelimin e nënkomiteteve në të gjitha vendbanimet shqiptare të këtij rajoni, si: Sllupçan, Likovë, Mateç, Hotël, Vishticë, Llojan, Vaksincë, Nakushtak, etj. Kontribut të jashtëzakonshëm për afirmimin e organizatës krahas Mulla Hajdarit dhe Sami Shabedinit, dhanë edhe atdhetarët tjerë, që ishin mbështetës të fuqishëm të Sulë Hotlës, si: Shaban ef. Jashari dhe Faik Shala nga Kumanova, Shukri Shabedini nga Vaksinca, Enver Destani nga Llojani, Sadik Haliti nga Sllupçani, Esat Kurtishi nga Orizarja, Selim Ademi nga Likova, mulla Hamdi Arifi nga Vishtica, mulla Xhemail Xhemaili nga Nakushtaku, Ibrahim Hoxha nga Opaja, Hevzi Tahiri nga Sllupçani, Adem Ismaili, Ahmet Zymberi, Rexhep Shabani, Shaban Demiri, Rexhep Rushiti, Haxhi Ramadani nga Sllupçani, Banush Haziri, Shaip Haziri, Haxhi Hasipi, Nevzat Hasipi, Daut Hyseni, Haxhi Bexheti, Faik Saliu, Fejzi Saliu, Bejzat Kurtishi nga Orizarja, Haxhi Saliu, Haxhi Dauti, mulla Besim Hoxha nga Hotla, Avni Neziri, Riza Aliu, Mulla Ahmeti, Zejardini nga Ramanlia, Ibraim Hamiti, Ahmet Xhemaili nga Nakushtaku, Haxhi Zeneli, Haxhi Demiri nga Gllëga, Mefail Grushina, Ismaili..., Ahmeti..., Sadiku... nga Grushina, e shumë të tjerë¹⁵².

Me gjithë jehonën shumë pozitive që e pati organizimi politiko-ushtarak i NDSH-së në këto troje, ajo shumë shpejtë dekonspirohet. Në të vërtetë, në pranverën e vitit 1946, organet shtetërore maqedonase, si organizatat partiake ashtu edhe OZN-a, i shtuan masat kundër aktivistëve të NDSH-së. Ata bënë për vete disa persona nga fshati Likovë, të cilët nisën të angazhohen për zbulimin e krerëve të NDSH-së dhe të përkrahësve të Sulë Hotlës.

¹⁵² Qerim Lita, kumtesë në “Kumanova për Flamur, NDSH-UÇK”, Kumanovë, 2007, 27-28.

Në anën tjetër, në Orizare pa dijeninë e kreut të Komitetit të NDSH-së së Orizares, një aktivist i NDSH-së nga Shkupi, Xhavit Abdullau, kishte filluar të veproj për formimin e një komiteti tjetër. Lidhur me këtë, ashpër reaguan udhëheqësit e Komitetit të Orizarës, të cilët dërgojnë sekretarin Sami Shabedini në Shkup, për ta njoftuar Komitetin Qendror. Këto mosmarrëveshje, ndikuan negativisht, saqë, sipas gjitha gjasave, OZN-a, nëpërmjet grupit të lartpërmendur të informatorëve, arriti të zbulojë veprimtarinë e organizatës, dhe me 24 prill 1946, arrestoi krerët e Komitetit të NDSH-së për Kumanovë. Arrestimi i tyre u bë në mektebin e fshatit Orizare, ku mbahej një mbledhje. Aty u arrestuan: Mulla Hajdar Kurtishi, Zija Shabedini, Shefki Shabedini, Çelebi Destani, Destan Destani, Ali Aliu (Rexhepi, v.j), dhe Sali Ahmeti. Megjithëse u arrestua kreu udhëheqës i NDSH-së për rrethin e Kumanovës, OZN-a nuk arriti të marrë informacione për veprimtarinë e KQ të NDSH-së dhe guerilen shqiptare¹⁵³.

Kështu, në procesin gjyqësor që u zhvillua në Shkup kundër aktivistëve të NDSH-së së Kumanovës, në janar të vitit 1947, ndër akuzat kryesore radhiteshin ato të ndihmës që u kishin dhënë Sulë Hotlës dhe ushtrisë së tij, sidomos gjatë vjeshtës së vitit 1944, kur u shpall bashkimi i këtyre trevave me Shqipërinë. Aktakuza kundër mulla Hajdar Kurtishit, ishte se “menjëherë pas çlirimit, ishte anëtar i grupit ballist të Sulë Hotlës, dhe se pas kthimit në fshatin e tij Orizare, i ka vazhduar lidhjet me atë grup, të cilin e ka ndihmuar me ushqime, të holla e nevoja të tjera, dhe si hoxhë ka predikuar që t’i ndihmohet këtij grupi. Me formimin e komitetit të organizatës terroriste NDSH në fshatin Orizare, Mulla Hajdari ishte kryetar. Në vjeshtën e vitit 1945, u lidh me Komitetin qendror të organizatës në Shkup dhe udhëheqësit Hasan Bilalli, Qemal Skenderi dhe

¹⁵³ Po aty, 29.

Mexhit Haki Zyberi, nga të cilët merrte detyra për mbajtjen e lidhjeve me grupet dhe për zgjerimin e organizatës”¹⁵⁴.

Në procesin gjyqësor kundër krerëve të NDSH-së, më 7 shkurt 1947, Mulla Hajdari i Orizarës dënohet me 12 vjet burg të rëndë.

Zija Qamil Shabedini, si kryetar i fshatit Orizare, ndër themeluesit e NDSH-së së Kumanovës, u dënua nga Gjyqi Ushtarak në Shkup me 7 vjet burg dhe 3 vjet humbje e të drejtave qytetare¹⁵⁵. Po kështu dënime të rënda morën edhe anëtarët e tjerë të Komitetit të Kumanovës.

Enver Destani (1917–2005), nga fshati Llojan, bashkëluftëtar i Sulë Hotlës, më 1947–tën u burgos dhe u dënua me 14 vjet burg¹⁵⁶.

Gjatë kësaj kohe do të pësojnë edhe shumë prijës fetarë, të cilët e kishin ndihmuar luftën e Sulë Hotlës në këto anë. Kështu, më 4.6.1947, burgoset Xhemail Emini nga Nikushtaku – Mulla Xhema, si bashkëpunëtor i Sulë Hotlës, dhe vuan 6 vjet e gjysmë burg. Në qershor të vitit 1947, u burgos edhe Shaban ef. Osmani, dhe u dënua me 6 vjet burg. Edhe mulla Ferat ef. Hamiti nga fshati Nikushtak, dënohet me 6 vjet burg, etj¹⁵⁷.

Disa nga prijësit fetarë të anës së Kumanovës, si Mulla Dulla i Hotlës e Mulla Sadiku i Sllupçanit, më herët ishin likuiuduar nga organet e OZNA-s.

Menjëherë pas arrestimit të kreut të NDSH-së, Komiteti Qendror formoi komitetin tjetër për trevat e Kumanovës, me kryetar Mefail Grushinën. Në të vërtetë, Sami Shabedini, i cili ishte sekretar i komitetit të parë, që ndryshe njihej si Komiteti i Orizares, kishte

¹⁵⁴ Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë – Shkup, ДАРМ, 1.1101.10.1. Tanjug, 31.1.1947, f.53

¹⁵⁵ Të dhënat janë marrë nga dosja gjyqësore e Zija Shabedinit, Shkup.

¹⁵⁶ “Qëndresa Shqiptare në Karadakun e Kumanovës gjatë Luftës së Dytë Botërore”, (përgatiti për botim: S.Demiri), Kumanovë, 2005

¹⁵⁷ Naser Ramadani, kumesë në simpoziumin “Kontributi i ulemave në ngritjen e çështjes kombëtare”, BFI, Shkup, 2013, 153.

arritur t'i shmangej arrestimit, duke e thyer kordonin e madh policor të vendosur në hyrje të Orizares, dhe përkohësisht vendoset në Grushinë. Pas një kohe të shkurtër, bashkërisht me Mefail Grushinën kalon në Shkup, ku takohet me Qemal Skënderin, të cilit i deklaron: *"Unë do të kaloj në mal, Mefaili deri tash ka punuar me mua, direktivat që i merrja nga ju, ja përcjellja atij, tash ai drejtpërsëdrejti do të lidhet me ju dhe do të punoj me fshatin e tij, me fshatin tün dhe fshatrat tjera"*. Për formimin e komitetit të ri të NDSH, në rrethin e Kumanovës, Qemal Skënderi, para organeve të hetuesisë deklaron: *"Pas burgosjes së komitetit në fshatin Orizare atje Mefaili mori detyrë të organizoj komitet të ri, këtë detyrë ja parashtruam unë dhe Hafiz Mexhiti."*¹⁵⁸

Ndërkohë, në rajonin e Kumanovës vazhdojnë ndjekjet dhe presionet e organeve të sigurimit shtetëror maqedonas kundër shqiptarëve. Arrestohen dhe burgosen shumë pjesëtarë të grupit të Sulë Hotlës, pasi që ky i fundit më herët kishte refuzuar kërkesën e Hysen Tërpezës për të kaluar në Greqi.

Edhe pse më lartë përmendëm arrestimet dhe burgosjet e disa personaliteteve të njohura të rajonit të Kumanovës, në të vërtetë, lista e vepimtarëve të tillë është shumë më e gjatë. Sipas disa llogarive të lira, që nga marrja e pushtetit nga komunistët në fund të vitit 1944, e deri kah fundi i vitit 1947, rreth 200 shqiptarë të kësaj ane ishin burgosur apo keqtrajtuar me akuzën e bashkëpunimit me Sulë Hotlën.

Në tetor të vitit 1947, në bazë të shënimeve të historiografisë zyrtare, përmes disa spiunëve shqiptarë, organizohet një kurthë perfide kundër Sulë Hotlës dhe shokëve të tij më besnik. Në malin Pelister, afër kufirit grek, arrestohet dhe më pas likuidohet: Sulë Hotla, Sami Shabedini nga Orizara, Ali Sylë Staneci, Hamzë

¹⁵⁸ Qerim Lita, kumtesë në "Kumanova për Flamur, NDSH-UÇK", Kumanovë, 2007.

Bellanocën me të birin Arifin, dhe katër vëllezërit Emimi nga Breza, djemtë e Ajet Emimit – Aliu, Shefkiu, Iseni e Rasimi¹⁵⁹.

Me këto veprime të OZN–ës dhe UDB–ës jugosllave, ishte neutralizuar veprimtaria atdhetare e krerëve të nacionalizmës shqiptare, eksponentë të NDSH–së dhe Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Por, ideali i tyre mbeti i pashuar. Në atë frymë vazhdoi rezistenca shqiptare deri në luftërat e fundit çlirimtare të UÇK–së, dhe kërkesat për barazi të plotë të shqiptarëve në trojet e tyre.

¹⁵⁹ Për më shumë shih: Sevdail Demiri, “Flakadani i rezistencës karadakiane”, KSH Jehona e Karadikut, Kumanovë, 2006.

SHTOJCË

Dokumente

Përgatitur nga Qerim Lita

*Dokumenti nr.1:***AKTAKUZA**

**E PROKURORISË PUBLIKE, KUNDËR 17 ANËTARËVE
TË KQ TË NDSH—së NË SHKUP, DËRGUAR MË 11 JANAR
1947 DERI TE GJYQI I QARKUT—SHKUP¹⁶⁰**

Prokuroria Publike e Republikës Popullore të Maqedonisë

11 janar viti 1947

Nr.6

Shkup

Gjyqit të Qarkut

Shkup

Në bazë të nenit 11 të Ligjit për Prokurori Publike, nenit 49 Ligjit për rregullimin e gjyqeve popullore dhe nenit 13 Ligjit për lëndë penale kundër popullit dhe shtetit këtij gjyqi ja dorëzoj këtë:

AKTAKUZË**KUNDËR:**

1/ Qemal Iskenderi Alim, flokqethës, i lindur në Shkup, shqiptar, shtetas jugosllav, di shkrim lexim, gjatë kohës së okupacionit organizator i çetave balliste.

¹⁶⁰ ДАРМ.Ф.Јавно Обвинителство на Нар. Републ. Македонија, Пов.Бр.6, 11 јануари 1947 год., Скопје, стр.23.

2/ **Azem Idriz Marana**, mësues, i lindur në fshatin Maranë, banor i qytetit të Shkupit, shqiptar, shtetas jugosllav, gjatë okupacionit mësues në rrethin e Tetovës.

3/ **Mexhit Aki Zyberi**, shitës, nga Shkupi, shqiptar, shtetas jugosllav, di shkrim lexim.

4/ **Mamut Hisen Dumani**, nga fshati Bellovë (Peshkopi–Shqipëri), banor i qytetit të Shkupit, shtetas shqiptar.

5/ **Rudi Hysni Muarrem**, Shqiptar, shtetas jugosllav, gjatë okupacionit oficer italian, është pranuar në armatën e jugosllavisë, ish–kapiten.

6/ **Memed Nezir Bushi**, oficer, i lindur në fshatin Dukagjin, rrethi i Burelit–Shqipëri, jeton në Tetovë, shqiptar, shtetas shqiptar, ka kryer Akademinë Ushtarake në Romë të Italisë, gjatë okupacionit kryetar komune.

7/ **Jonuz Imer Balla**, mësues, i lindur në fshatin Polis (Elbasan–Shqipëri), ndërsa jeton në Tetovë, shqiptar, shtetas shqiptar, gjatë okupacionit mësues.

8/ **Dr. Qeram Muhamed Zllatku**, mjek, i lindur në qytetin e Dibrës, shqiptar, shtetas jugosllav, gjatë okupacionit student në Zagreb, ndërsa pastaj mjek në Tiranë.

9/ **Osman Ahmet Cami**, bujk, i lindur në qytetin e Dibrës, shqiptar, shtetas jugosllav.

10/ **Medat Mustafë Tërshana**, i lindur në qytetin e Dibrës, tregtar, shqiptar, shtetas jugosllav, gjatë okupacionit në çetat balliste.

11/ **Gani Beu Mehmed Abdullau**, bujk, i lindur në Dibër, shqiptar, shtetas jugosllav.

12/ **Spiro Harilla Theodosi**, mësues, i lindur në Korçë– Shqipëri, ndërsa jeton në Gjorçe Petrov, shqiptar, shtetas shqiptar.

13/ **Ajdar Kurtish Jashari Mulla Ajdari**, bujk, hoxhë, i lindur në fshatin Orizare, rrethi i Kumanovës, shqiptar, shtetas jugosllav, gjatë okupacionit organizator i çetave balliste.

14/ **Xhemal Fazli Kasami**, polic, nga fshati Bllacë, shqiptar, shtetas jugosllav.

15/ **Sherif Memet Aliti**, drugdhendës, i lindur në Kaçanik, jeton në Shkup, shqiptar, shtetas jugosllav.

16/ **Xhavid Abdulla Selimi**, rrobaqepës, i lindur në Shkup, shqiptar, shtetas jugosllav.

17/ **Galip Rauf Mustafa**, rrobaqepës, i lindur në Gjilan, turk, shtetas jugosllav.

ARSYETIM

Kur të shfletohet materiali hetues kundër të akuzuarve, menjëherë bie në sy çështja, se shumica e të akuzuarve gjatë Luftës Nacionalçlirimtare në mënyrë aktive kanë bashkëpunuar me okupatorin, që në kohën më vendimtare të historisë së popujve tanë i kanë shërbyer armikut në përpjekje për të përmbysur dhe shkatërruar popujt tanë.

E krijuar në luftën e përbashkët e popujve tanë kundër okupatorit, armiqve të brendshëm dhe bashkëpunëtorëve të tyre, reaksionarët ndërkombëtarë të të gjitha ngjyrave, Jugosllavia e re i vëllazëroi dhe i bashkoi të gjithë popujt e vendit tonë dhe i ofroi mundësi çdonjërit personalisht demokraci të plotë dhe liri për shfrytëzimin e të drejtave nga luftimet e fundit përfundimtare, pikërisht nga arsyeja se ajo është demokratike dhe popullore. Mundësitë e tilla ishin edhe për të akuzuarit. Por pikërisht nga fakti se, Jugosllavia e re është demokratike, popullore, e përforcuar në bashkim – vllazërimin e të gjithë popujve tanë, pikërisht pse është e pavarur, e lirë dhe

paqedashëse, që nga ditët e para të krijimit të saj, ajo me vepra e tregoi demokratizimin e plotë gjatë zgjidhjes së çështjes nacionale dhe i mundësoi çdo populli zhvillim e plotë nacional dhe të papenguar, se tërë fuqinë e vet e përqendroi në rinovimin dhe ndërtimin e vendit si dhe ruajtjen atyre që arriti nga lufta Nacionalçlirimtare. Për këtë arsye RFPJ u bë e padëshirueshme për krejt imperialistët dhe reaksionarët, ferrë në sy për për të gjithë armiqtë e lirisë, paqes dhe demokracisë. Ja përse e urrejnë Jugosllavinë e re dhe e etiketojnë. Ndaj dhe imperialistët hartojnë plane të errëta kundër saj. Me ndihmën dhe përkrahjen e armiqve të lirisë në Bari, Kajro, të monarko-fashistëve grekë e kështu me radhë, u krijuan nga emigrantët kuislingë dhe shërbetorët e njohur të okupatorit komitete të ndryshme të cilat, për të maskuar tradhtinë, i kanë dhënë emra bombastikë "Nacionale", "Nacionale Qendrore" e kështu me radhë. Për këtë arsye po ngrihen si lugetërit shërbetorët e mjerë të okupatorit e po krijojnë dhe forcojnë banditizmin në vendin tonë, krijojnë dhe përkrahin grupe bandash, krijojnë organizata antipopullore me persona siç janë këta të akuzuarit për tradhti dhe krim. Të gjithë së bashku, tradhtarët serbë, kroatë, maqedonas, shqiptarë dhe ata të popujve tjerë të vendit tonë, luftojnë që popullit tonë t'i shlyhen arritjet e luftës çlirimtare, t'i hiqen të drejtat nacionale dhe ta bëjnë koloni të mvarur.

Në këtë pasqyrë, me qartësinë e saj, materialet hetuese vërtetojnë se të akuzuarit janë agjentë të mjerë të imperializmit ndërkombëtar për çka gjithashtu kanë punuar siç kanë punuar gjatë kohës së luftës të popujve tanë në favor të okupatorit fashist. Lidhjet e të akuzuarve me armiqtë e brendshëm dhe ata të ikurit, lidhjet me nxitësit e luftës së re, dërgimin e bandave të monarko-fashistëve grekë, lidhjet me konsujt anglezë dhe turq në Shkup, këshillat dhe ndihmat që kanë marrë prej tyre, agjitacioni dhe propaganda e drejtuar kundër vendit tonë, kundër popujve sllavë në përgjithësi, kundër paqes, gjoja se është e domosdoshme lufta ndërmjet amerikanëve dhe Bashkimit Sovjetik, krejt kjo tregon qartë se të akuzuarit pa kurrfarë ndjenje dhe krenarie nacionale, kanë punuar

në dobi të armiqve të paqes dhe njëkohësisht këto lidhje tregojnë edhe për burimin ku hartohen planet kundër Jugosllavisë së re.

Fati i të gjithë tradhtarëve të popullit është të ngelin pa asnjë mbështetje të masave popullore, për t'u detyruar ta pranojnë banditizmin si të vetmin mjet që u ka ngelur. Të njejtin fat e kanë edhe të akuzuarit e tanishëm. Megjithëse me një shkathësi shumë të madhe, ata e kanë fshehur veprimtarinë e tyre kriminale dhe tradhtarë, duke e maskuar tradhtinë nën ombrellën e luftës kombëtare për bashkim kombëtar. Por masa shqiptare, e vetëdijshme që në Jugosllavinë e re i ka siguruar të drejtat e e veta për një zhvillim të plotë nacional ashtu si edhe popujt e tjerë në Jugosllavi, nuk iu nënshtrua aventurierëve, të cilët i njeh që nga ditët e vështira si shërbëtorët më besnikë të fashizmit dhe si njerëz të cilët gjatë tërës së tyre kanë jetuar me djersën e të tjerëve. Klasa punëtore nuk pranoi të mashtrohet. Tashmë akuzës i ka ngelur të përqendrohet te një numër i njerëzve të orientuar si profashistë; shumica që nga koha e luftës i ka përlyer duart me gjakun e luftëtarëve të lirisë. Ja, për çka janë të akuzuar. Ata si mjetin e tyre të vetin janë të detyruar të pranojnë banditizmin dhe krimin kundë popujve të Jugosllavisë.

Se për çfarë qëllimesh është krijuar organizata ilegale antipopullore është theksuar në dispozitat e kësaj aktakuze dhe shihet edhe nga materiali i paraqitur i hetuesisë.

Kështu, AZEM MARANA, në proçesverbalin e tij të datës 18–IX 1946 deklaroi se bashkërisht me Hasan Bilallin dhe disa të tjerë në një mbledhje të elementeve me orientim armiqësor, duke folur për situatën politike, kanë ardhë në "përfundimin se duhet të punojnë ilegalisht për bashkangjijtjen e Kosovës me viset tjera Shqipërisë". Në vazhdim, kur është parashtruar çështja se si dhe në çfarë mënyrë të punohet, ai vendosi që në mbledhje të ftohet, si njeri me përvojë për këto çështje, i akuzuari Mahmut Dumani, që të tregojë "orientimin e punës".

I akuazuari Mahmut Dumani menjëherë është dakorduar dhe në mbledhje, e cila pas kësaj është mbajtur, ka filluar të flasë për bashkangjijtën e Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore me Shqipërinë. I akuzuari AZEM MARANA pasi deklaroi se si Mahmut Dumani fliste për vrasjet, të cilat gjoja se i kanë kryer partizanët ndaj shqiptarëve në Kërçovë dhe Gostivar, në të njëjtin procesverbal thot: "Mahmut Dumani paraqet nevojën për organizim që të gjithë ne jemi pajtuar dhe paraqiti programin e punës së organizatës të cilën e kemi krijuar. Në program flitej që të punojmë për një bashkim të Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore Shqipërisë, të vendosim lidhje me nacionalistat në Kosovë me Shqipërinë, me qëllim zgjerimin e punës tonë. Këtë program ne e kemi pranuar dhe i dhamë detyrë vetvetes që ta zbatojmë në vepër."

Lidhur me këtë, pranon gjithashtu edhe i akuzuari Qemal Iskenderi, i cili, duke folur për karakterin e organizatës, në dëgjimin e tij të datës 4–XI 1946 i përbërë prej prokuroris publike deklaroi: "Organizata jonë, në të cilën unë isha një ndër udhëheqësit, ka patur për qëllim të rrëronte regjimin aktual në Jugosllavi, të rrënojë qeverinë aktuale në Shqipëri, me çka do të mundësohej që Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia Perëndimore të bashkohen në një Shqipëri etnike."

Nga citimet e mësipërme, të dhëna në hetuesi, nga të akuzuarit Iskenderi dhe Marana në mënyrë të pakontestueshme vërtetohet se organizata, në krye të së cilës kanë qenë edhe të akuzuarit Qemal Iskenderi, AZEM MARANA, Mexhit Zyberi, Mahmut Dumani dhe Hysni Rudi është krijuar dhe ka filluar aktivitetin me punë kriminale që në fillim të vitit 1945, kur popujt e Jugosllavisë dhe populli vëlla shqiptar, bashkërisht me të gjithë popujt liridashës, akoma zhvillonin luftë të përgjakshme për ta përzënë okupatorin fashist nga vendi ynë, për një jetë të lirë dhe në bashkëpunim vëllazëror të popujve tanë.

Dhe kur si rezultat i kësaj lufte të përbashkët të popujve tanë fitohet liria dhe pavarësia, kur u krijuan të gjitha kushtet e patjetër-

sueshme për zgjerimin e marrëdhënieve tona vëllazërore, kur të gjithë popujt ishin orientuar në ngritjen e kushteve materiale dhe kulturore të popujve tanë, këto mbeturinat e njera të fashizmit, besnikë ndaj punës së tyre antipopullore, dhe nën ombrellën e nacionalizmit të rrejshëm, duke u lidhur me zjarrvënësit e rinj të luftës, duke u bërë shërbetorë të armiqve tanë shekullorë, përpiqen që me çdo kusht të krijojnë trazira në shtetin tonë, me çka në këtë mënyrë të krijojnë kushte për intervenim të fuqive të huaja në vendin tonë.

Se kjo është kështu, e tregon fakti se janë të lidhur me bandat e shpartalluara balliste dhe të njëjtat principe i bashkojnë me organizatën dhe u japin detyrë që të zhvillojnë luftë të armatosur për arritjet e qëllimeve të tyre dhe njëkohësisht lidhen me elementët kuizlingë dhe ballistë të arratisur. Këtë e vërteton i akuzuari Iskenderi, i cili në proçesverbalin e cituar, kur flet për lidhjen me të gjithë armiqtë e huaj, deklaron: "Që bashkërisht me ta, në momentin e dhënë. me armë në dorë të rrënojmë pushtetin e tanishëm popullor dhe të vendosim tonin... në këtë drejtim, ne, organizata jonë, u fut në lidhje edhe me çetat balliste të cilat lëviznin në teritorret e RFP dhe të cilat luftonin kundër pushtetit popullor... Këto çeta balliste... para se të fillonim aksionin tonë të përgjithshëm, duhej të na shërbenin për grumbullimin e anëtarëve tanë të organizuar". Ndërsa në proçesverbalin e tij para organeve të hetuesisë të datës 17-X 1946, pasi ka folur për mbledhjen me përfaqësuesit e bandave balliste, mbajtur në gusht të vitit 1945 në fshatin Tanishecë, deklaron: "Hisen Tërpeza i cili në atë kohë ishte komandant i tërë farcave balliste... u fut në shërbim të bandave monarko-fashiste, në luftë kundër forcave demokratike të popullit grek dhe u zgjodh komandant i ndonjë brigade shqiptare", – e mori fjalën dhe na deklaroi neve se si nëpërmjet Kosovës kishin marrë një letër prej Muharrem Bajraktarit, në të cilën lajmëronte se në Bari ishte formuar një komitet, i cili do të "punojë për krijimin e kufijve etnikë të shtetit shqiptar, që nënkuptohet se Kosova dhe pjesë e Maqedonisë t'i bashkangjiten Shqipërisë". Ndërsa pyetjes drejtuar

të akuzuarit Iskenderi, se në çfar mënyre do të arrihej kjo, Hysen Tërpeza i është përgjigjur: "Do të formojmë çeta, të cilat do të jenë të armatosura dhe me luftë do t'i arrijmë qëllimet e këtij komiteti". Në këtë mbledhje gjithashtu është parashtruar çështja e ndihmës, që organizata do të kishte nevojë të merrte prej disa nga shtetet e huaja. Me këtë rast, Luan Gashi, ish profesor, përndryshe sekretar i Hysen Tërpezës, deklaroi se: "Në Shkup kishim konsullin anglez dhe turk, me të cilat me çdo kusht duhej të vendosnim lidhje". Dhe me të vërtetë, kjo lidhje është vendosur. Që lidhja është vendosur, e vërteton në deklaratat e veta i akuzuari AZEM MARANA, i cili flet qartë në procesverbalin e cituar se i kishte dërguar letër konsullit anglez, Xhorxh Herbert Bjurton me këtë përmbajtje: Ekselencës së tij konsullit anglez – Shkup.

"Meqë e kemi vështirë në mal, pa ushqim, vështirë e kemi të qëndrojmë këtu, prandaj po ju drejtohem juve për këshilla se a të qëndrojmë këtu apo të kalojmë në Greqi. Nëse na këshilloni të rrimë këtu, atâherë, ju lusim juve që të na dërgoni shifrën për punë me radiostacion, që se si të kemi lidhje me juve.

Nga komanda e përgjithshme e lëvizjes për lirin e Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore dhe bashkangjytjen me Shqipërinë".

Këtë letër konsullit anglezë ia ka dorëzuar Xhozef Bërkiç, të cilit konsulli anglez pyetjes së këtij të fundit sikurse edhe të letërshkruesit, i përgjigjet po njësoj: "Herën tjetër mos më sill letra, le të vinë vetë ata". Dhe pak kohë pas dërgimit të kësaj letre filloi koncentrimi i bandave balliste dhe kalimi i tyre në Greqi.

Gjithashtu, është vërtetuar lidhja me konsullin turk Emin Vefa Geçekin. Kjo më së qarti shihet nga deklarata e të akuzuarit Xhavit Abdullahut i cili në procesverbalin e tij të datës 20. VIII. 1946, para organeve të hetuesisë deklaroi— se me urdhrin e organizatës ka shkuar me banditin ilegal Qazim Sopi te konsulli turk me qëllim që këtij të fundit, pra, Qazimit, t'i jepej pashaportë false me qëllim që të kalonte kufirin dhe të shkonte në Turqi. Sipas deklaratës së

Xhavid Abdullahut shihet se Qazim Sopit i ishte dashur të grumbulloste disa të dhëna në vendin tonë dhe ato ti përcillte përtej kufirit që të shërbenin armiqve të shtetit tonë. Përveç kësaj, i akuzuari Xhavid e pranon pashaportën false të lëshuar nga konsulli turk dhe ia dorëzon Qazim Sopit. Në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar gjithashtu se Xhavid Abdullahu i dorëzoi letrën konsullit turk, të shkruar nga Ibrahim Haki – Kelmendi –ish profesorë, në të cilën letër kërkohen direktiva për punë. Kur pas një kohe të caktuar Xhavid Abdullahu shkoi të merrte përgjigjen e letrës te konsulli turk, ky i ka thënë: "Nuk ka përse të urreheni me turqit, ju jeni muslimanë dhe po ashtu edhe ata. Lërimi mënjane mospajtimet nacionale, duhet të luftoni si muslimanë dhe mos u frikësoni, sepse çfardëlloj zënke do ju dëmtojë. Ju a shihni se në çdo luftë vetëm muslimanët bëhen viktima. Ja, tash po i vrasin nëpër fshatra si për shembull nga Bllaca e deri në Gjilan a shihni se sa janë vrarë? Ata tentojnë që muslimanët një ditë të shpërngulen prej këtu. Kështu, ti përshëndeti shokët dhe thuaju që të merren veshë disi që si muslimanë të veprojnë bashkërisht, të jenë të bashkuar". Përveç kësaj, kjo lidhje gjithashtu vërtetohet edhe nga deklarata e dëshmitarit Hilmi Zariqit, i cili në dëgjimin e fjalës së tij para organeve të Kosovës të datës 1–I 1947 në mënyrë të pakontestueshme e vërtetoi se organizata ka patur lidhje të ngushta me përfaqësuesin konsullor anglez. Gjithashtu, ai dëshmoi se bandat balliste kryenin vetëm atë që i urdhërohej nga Komiteti Qendror i organizatës antipopullore në Shkup, e se këto urdhëresa kjo organizatë i ka pranuar nga një forcë ndërkombëtare.

Që kjo organizatë antipopullore, përveç kësaj lidhjeje mbante lidhje edhe me organizatat tjera antipopullore dëshmohet edhe nga deklarata e të akuzuarit dr. Qeram Muhamed Zllatku, dhënë para organeve të hetuesisë të datës 17–IX 1946 në të cilën thotë: "Halim Orana përfaqësuesi konsullor i qeverisë kuislinge shqiptare te gjakëpirësi i popullit kroat, Ante Pavelić, ka deklaruar se, "Direktivat e Komitetit Qendror nuk i vendos ai, por i merr nga

Greqia nëpërmjet Selanikut, dhe se të njëjtat direktiva në Greqi arrijnë nga Bari –Itali".

Nga citatet e mësipërme shihet qartë se e tërë veprimtaria e organizatës ishte e inspiruar nga armiqtë e betuar të popujve tanë si dhe të popullit vëlla shqiptar, pikërisht nga ata reaksionarë ti cilët dëshirojnë që prej popujve tanë dhe prej popullit vëlla shqiptar të krijojnë robër të cilët të punojnë për intetresat e tyre dhe që pasurinë e dy shteteve tona ta shfrytëzojnë për vendosjen e dividendave të tyre.

Që kjo organizatë ilegale antipopullore mbante lidhje me mbeturinat e bandave ustashe dhe atyo çetnike të shpartalluara, në krye me Drazha Mihajloviçin, si dhe me bandën terroriste në diasporë, me gjakëpirësin e popullit maqedonas Vanço Mihajlovin, dëshmon deklarata e Qemal Iskenderit dhënë para organeve të hetuesisë, në të cilën Qemal Iskenderi thekson se Halim Orana krahas lidhjes që e ka pasë me Komitetin në Bari njëkohësisht ka mbajtë lidhje për aksione të përbashkëta edhe me bandat e Paveliçit, Drazha Mihajloviçit, si dhe me bandën terroriste të Vanço Mihajlovit në diasporë.

Organizata e themeluar në këtë mënyrë, duke e filluar veprimtarinë e saj kriminale nga fillimi i vitit 1945, e udhëhequr nga personat e lartpërmendur të Komitetit Qendror arrin të zgjerohet dhe të themelojë komitetet e veta qarkore dhe vendore , krahas atyre në Kosovë si edhe në këto vende të Republikës Popullore të Maqedonisë: në Dibër, rrethin e Dibrës, Tetovë, rrethin e Tetovës, Shkup, rrethin e Shkupit, si dhe në disa vendbanime në rrethin e Kumanovës. Duke punuar për zgjerimin dhe përforcimin e organizatës, arrijnë deri te Kongresi IV i cili është mbajtur në Shkup me 1 qershor 1946, në të cilin marrin pjesë delegatët e këtyre vendeve: Prishtinë, Gjilan, Dibër, Tetovë dhe Shkup. Të gjithë të pranishmit në këtë kongres: Qemal Iskenderi, Hasan Bilalli, AZEM MARANA dhe kapiten Rudi, si delegatë për qytetin e Shkupit, Osman Cami për Dibrën, Jonuz Balla për Tetovën, Faiku këpucar, për Prishtinën dhe Haki efendiu për Gjilanin,

bashkërisht me Halim Oranën, morë pjesë në diskutime të cilat kanë patur për lëndë gjendjen politike të brendshme dhe të jashtme, rezultatet e arritura të organizatës dhe organizimin e mëtejshëm si dhe format e organizimit, po ashtu edhe detyrat e organizatës për të ardhmen. Përveç tjerash, i akuzuari, kapiten Rudi, flet për formën e organizatës dhe shton se: krahas Komitetit Qendror nevojte që në të gjitha rrethet, nëse deri tash nuk janë formuar, të formohen komitete të cilat do të jenë në lidhje të drejtëpërdrejtë me Komitetin Qendror, ndërsa këta do të krijojnë komitete në rrethe, detyra e së cilave do të jetë të formojnë në regjionet e tyre komitete vendore nëpër fshatra dhe komuna. Më tutje i akuzuari kapiten Rudi, nënvizon nevojën që secili komitet i rrethit, nëse deri tash nuk ka arritur, të krijojë në territorin e tij nga një çetë, për armatosjen dhe mirëmbajtjen e së cilës të angazhohet vetë komiteti. Si rezultat i këtij diskutimi, në fund paraqitet rezoluta, në të cilën krahas thirrjes për vazhdimin e luftës kundër pushtetit popullor, në mënyrën siç u tha më lart, e paraqesin edhe shemën e organizimit të vetë organizatës.

Pjesëmarja e të gjithë të akuzuarve në këtë organizatë antipopullore, me qëllimet që u thanë më lart dhe veprimet kriminale të tyre, të paraqitura individualisht në dispozitivin e kësaj aktakuze, në mënyrë kategorike dhe të pamohueshme vërtetohet edhe nga pranimi i tyre i pastër dhe sqarimi i qartë, nga deklaratat e personave që u morën në pyetje, të cituara në listën e dorëzuar krahas aktakuzës, për të cilën propozohet të merren në pyetje si dëshmitarë, si dhe nga dëshmitë e shkruara të cilat kanë dorëzuar, si shtojcë edhe atë: rezoluta e Kongresit IV me titullin – "Shema e organizatës", – nga përmbajtja e së cilës asnjë nga të akuzuarit nuk distancohet; apeli "Vëllezër Kosovar" i shumëzuar dhe i shpërndarë nga i akuzuari AZEM MARANA; shifra për letërkëmbim ndërmjet të akuzuarit AZEM MARANA dhe banditi Gjon Sereçi, si edhe letra me titull "I dashur vëlla" – e dërguar nga të akuzuarit Qemal Iskënderi dhe Mexhit Haki Zyberi, kaçakut Mefail Zajazit, dhe përveç kësaj edhe armatimin e municionin e zbuluar.

Për të akuzuarin Mahmut Dumanit i cili përpiqet para hetuesisë ta fshehë të vërtetën për rolin e tij udhëheqës në organizimin në organizatën antipopullore, nga dëshmitë e grumbulluara në hetuesi, si dhe nga sqarimi i të akuzuarit AZEM MARANA, të cituara më lart, nga deklarata e tij para organeve të hetuesisë të datës 6 –XI 1946, përveç tjerash theksohet: "Në përgjithsi, në bisedimet tona si edhe në mbledhje Mahmut Dumani paraqitej ashpër kundër situatës së tanishme në Jugosllavi dhe angazhohej që sa më parë të organizohet pakica shqiptare në luftë, për çka edhe vetë ai ofronte sugjerime dhe plane". Nga sqarimi i të akuzuarit Qemal Iskenderi dhënë para Prokurorit Publik të Republikës Popullore të Maqedonisë, në procesverbalin e datës 23–XI 1946, përveç tjerash kemi këtë pohim: "AZEM MARANA dhe Hasan Bilalli mua më kanë folur, kur ne bisedonim për organizatën, se Mahmut Dumani është organizatori kryesor i organizatës dhe se ai i ka organizuar". Nga sqarimi i Jetish Vishit, dhënë para organeve të hetuesisë në procesverbalin e datës 24–XI 1946 theksohet se i akuzuari Mahmut Dumani gjatë një takimi që e kanë pasur në Shkup, për afërsisht shëngjergji i vitit 1946, ka folur për organizatën antipopullore në mesin e mësuesve shqiptarë nga Tetova dhe Shkupi. Nga deklarata e dëshmitarëve Nebi Veli Jonuzi dhe Nuredin Jonuz Ibrahimini, në detaje i paraqesin mbledhjet e organizatës, të cilat janë mbajtur në fillim të vitit 1946 në Shkup në shtëpinë e Hysni Qemalit, me pjesëmarrjen e Qemal Qazimit, Nebi Veli Jonuzit dhe Azem Maranës, në të cilat mbledhje, përveç asaj që u theksua më lart, Mamut Dumani ka propozuar që brigada shqiptare të tërhiqet në mal.

Gjithashtu edhe veprimtaria e të akuzuarit Hysni Rudi, e paraqitur në dispozitivin e kësaj aktakuze, në tërësi e vërtetohet me pranimin e pjesëshëm të tij, si edhe deklarata e Azem Maranës i cili me rastin e të akuzuarit të përmendur Rudi, duke folur për Kongresin IV të organizatës, thekson: "Pas meje foli kapiden Rudi për mënyrën e organizimit. Theksoi se krahas Komiteti Qendror... duhet të formojë në të gjitha qarqet komitete, të cilat do të jenë në lidhje me Komitetin Qendror. Pastaj ai foli se këto komitete qarkore

duhet të formojnë komitete nëpër rrethe, të cilat do të mbajnë lidhje vetëm me komitetet qarkore dhe jo edhe me Komitetin Qendror. Komitetet e rretheve duhet të formojnë komitete nëpër komuna. Theksoi se secili komitet duhet të përbëhet prej kryetarit, sekretarit, arkëtarit dhe kundërzbuluesit, detara e të cilit është politike... Ky anëtar i katërt thirret "SIP" – Sigurimi politik" – që nënkupton sigurim politik. Më tutje, Rudi theksoi që secili komitet qarkor të formojë në viset e tij nga një çetë, të cilën do ta armatosë dhe mirëmbajë dhe këto do të paraqiten si forca ushtarake e organizatës. Pas kësaj, ai theksoi se komitetet duhet të përpiqen t'i përfaqësojnë këshilltarët e pushtetit popullor nëse janë shqiptarë, dhe t'i angazhojnë për qëllimet e tyre. Nëse ndonjë nga ata nuk do të pranonte ose do të mbante qëndrim armiqësor, të vritet si i dëmshëm për organizatën. Në diskutimin, e zhvilluar me rastin e këtij propozimi të kapiden Rudit, njëzërit janë pranuar të gjitha propozimet dhe secili delegat është dashtë t'i zbatojë në jetë në krahinën e tij. (*Proçesverbali para organeve të hetuesisë nga data 8_XI 1946, fq.8*). Nga rezoluta e Kongresit IV, e dorëzuar – Shema e organizatës e cila është aprovuar si rezultat i punës të Kongresit IV shihet – se këto propozime të të akuzuarit Rudi, në të vërtetë janë pranuar. Kjo çka u tha më lart vërtetohet edhe nga deklaratat e të akuzuarëve Qemal Skënderi, Jonuz Balla dhe Osman Cami.

Prokuroria mendon se gjatë hetimit është vërtetuar e gjitha ajo çka është paraqitur në aktakuzë, qoftë në pranimin e tërësishëm apo të pjesshme të të akuzuarve, qoftë në pranimin e dëshmitarëve që janë pyetur, ose nga materiali tjetër, i vërtetuar dhe i dorëzuar si shtojcë e lëndës, prandaj këto propozime janë plotësisht të arsyeshme dhe me bazë.

Prokurori Publik i RP të Maqedonisë

Nikolla Vrazhalski

Dokumenti nr.2:

AKTAKUZA SHITESË

E NIKOLLA VRAZHALLSKIT KUNDËR HASAN BILALLIT DHE NAZMI AZEMIT¹⁶¹

Duke e pas parasysh se në duart e pushtetit popullor janë edhe Hasan Hamdi Bilalli edhe Nazmi Emin Azemi, veprimtaria e të cilëve është në përputhje të plotë me veprimtarinë e të akuzuarve Qemal Iskenderit, Azem Idriz Maranës e të tjerëve sipas veprës penale nr. 1–47, e cila tash para gjyqit po shqyrtohet edhe atë në bazë të nen. 11 të Ligjit për prokurori publike neni 49 të Ligjit për rregullim të Gjyqit Popullor dhe neni 13 të Ligjit për veprë penale kundër popullit dhe shtetit sipas veprës së mësipërme penale sjellë këtë plotësim:

Aktakuzë, kundër;

1/ I akuzuari Hasan Hamdi Bilalli, mësues, i lindur në Prishtinë, jeton në Shkup, i moshës 29 vjeçare me kombësi Shqiptare, shtetas i Jugosllavisë, i biri i Hamdi Bilallit dhe Hateme Hatem Memedit, ka të kryer katër klasë gjimnaz dhe kursin pedagogjik gjatë okupacionit, i pa martuar, i pa dënuar, tash në burgun hetues.

2/ I akuzuari Nazim Emin Azemi, bujk, i lindur në Kaçanikun e Vjetër, i moshës 23 vjeçare, me kombësi shqiptare, shtetas i Jugosllavisë, i biri i Emin Azemit dhe Sherife Selmani, di shkrim lexim, i pa martuar, i pa dënuar, tash në burgun e hetuesisë.

A R S Y E T I M

Nga pranimi i të akuzuarve Hasan Bilalli dhe Nazmi Azemi dhe nga sqarimet nga ana e të akuzuarve të tjerë si dhe nga dëshitë e

¹⁶¹ ДАПМ: 1.1101.6.12/523/578. Në ditën e tretë të gjykimit, Prokurori Publik, e shtoi aktakuzën edhe kundër Hasan Bilallit dhe Nazmi Azemit, të cilët me 20 janar 1947 qenë depërtuar në Jugosllavi nga ana e organeve policore shqiptare.

paraqitura prej dëshmitarëve është dëshmuar sipas dispozitave të radhitura më lartë të akuzuarve të përmendur, ndërsa duke e pas parasysh lidhjen e pandashme me veprimtarinë e të akuzuarit Qemal Skënderit e të tjerëve sipas veprës penale 1/47 të këtij plotësimi të prokurorisë publike të veprës së përmendur paraqitet si e arsyeshme dhe e bazuar me Ligj.

Dokumenti nr. 3:

FJALA PËRMBYLLËSE

E PROKURORIT PUBLIK, NIKOLLA VRAZHALLSKI, MBAJTUR MË 4 SHKURT 1947¹⁶²

Këto ditë që u shqyrtuan veprat penale të të akuzuarve, na dhanë pasqyrë plotësisht të qartë se çfarë njerëz janë këta, se çfarë tradhtie të madhe kanë kryer ndaj popullit të vet, ndaj popujve jugosllavë, ndaj shtetit tonë popullor. Çfarë tradhtie të madhe kanë kryer ndaj ideologjisë, në emër të së cilës të gjithë popujt tanë e kanë ofruar edhe popullin shqiptar nga Republika Federative Popullore e Jugosllavisë si dhe shqiptarët nga Republika e Maqedonisë, të cilët në vitin 1941 u futën në luftë kundër fashizmit gjermano-italian, në luftë për liri, barazi, mirëkuptimin vëllazëror, për pushtetin e tij popullor, që të mos jetë si në të kaluarën rob i të huajve, që të mund të kontribuojë me tërë fuqinë e tij, që ta krijojë të ardhmen e tij.

Ky proces, neve gjithashtu na dha pasqyrë të qartë në atë se ku shtrihen rrënjët e veprimtarisë antipopullore dhe agentureske e të akuzuarve. Procesi, neve na i tregoi rrënjët e veprimtarisë së këtyre

¹⁶² ДАРМ.1.1101.6.14/666-775. Procesi gjyqësor zgjatë deri me 4 shkurt 1947, dhe me 26, 27, 28, 29, 30, 31 janar dhe 1, 3 shkurtë 1947, merren në pyetje të gjithë të akuzuarit si dhe dëshmitarët, ndërsa datën 4 shkurt¹⁶² gjyqi e kishte rezervuar për Prokurorin Publik Nikolla Vrazhalski, për të dhënë fjalën përfundimtare.

bandave keqëbërëse dhe gjakpirëse, ky ne na e tregoi edhe burimin ku të gjithë armiqtë tanë kanë shkuar në veprimtarinë tradhtare ndaj Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, na tregoi neve se cilët ishin planet e errëta për robërimin e popujve tanë.

Gjatë këtij procesi në mënyrë brilante është ndriçuar çështja, se rrënjët e të gjitha atyre përgatitjeve dhe veprimeve – rezultat i së cilës ishin aktet terroriste dhe krijimi i organizatave të ndryshme antipopullore – burimin e kanë nga jashtë, nga Bari, nga Greqia monarko-fashiste, nga shërbetorët e njohur fashistë dhe mbështetësit e tyre nga jashtë. Nuk është habi se rrënjët dhe burimi i këtyre organizatave antipopullore paraqiten – nga jashtë, tek ata që nuk mundën të pajtohen me situatën e re të krijuar në shtetin tonë, e cila ka ardhur si rezultat i luftës heroike të popujve tanë; ata nuk mundën të pajtohen me gjendjen që shteti ynë e ka në vendosjen e paqës, jetës së lirë dhe zhvillimin e gjithanshëm e të gjithë popujve.

Duke i parë rrethanat kështu, që ndryshe ata nuk mundën t'i shikojnë, ne do të mundemi të gjykojmë drejt se përse zhvillohet luftë kundër Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë edhe pse gjendet në radhët e para të tyre. Duke u nisur nga kjo pikë, neve do të na ishte e qartë përse rrënjët dhe burimi i të gjithë mbështetësve antipopullore gjendet në shtetet perëndimore, dhe në anën tjetër, përse këta mbështetës, në mesin e popujve tanë, nuk kanë asnjë përkrahje, por bazohen në mbeturinat e mjera, të shërbetorëve të përmbysur fashistë, tek ata, duart e të cilëve janë të përlyera me gjakun e popujve tanë.

Nëse përqendrohemi në proceset e deritanishme në vendin tonë, do të shohim se udhëheqësit kryesorë dalin nga këto radhë dhe organizata, të cilat gjatë okupacionit, respektivisht gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ishin shërbetorët më besnikë të okupatorit. Ato, në rrethana të reja, e vazhdojnë veprimtarinë e tyre antipopullore, por në një formë tjetër dhe nën filialën e huaj.

Edhe në rastin konkret veprimtaria tradhtare e të ashtuquajturës organizatë "Nacional Demokratike Shqiptare" nuk është asgjë tjetër vetëm se vazhdimi i veprimtarisë antipopullore të ballistëve gjatë kohës së okupacionit, vazhdimi i veprimtarisë së atyre tradhtarëve të popullit shqiptar, të cilët gjatë kohës kur ndriçonte Lufta Nacionalçlirimtare mes popullit vëlla shqiptar dhe popujve të Jugosllavisë, si dhe të gjithë popujve ballkanikë, shkuan në një tradhti të paparë, duke kaluar në shërbimin e drejtpërdrejtë të okupatorit fashist. Duke e parë veprimtarinë e tërësishme të kësaj organizate, duke e parë veprimtarinë e çdo anëtari të saj veç e veç, do të shohim se të gjithë gjatë kohës së okupacionit kanë qenë shërbetorët më besnikë të okupatorit.

Nuk është e rastit që ata menjëherë pas çlirimit të lidhen me bandat e shkapërderdhura balliste, të cilat ishin të përndjekura nga njësitë e Armatës tonë popullore, ndërsa duke e humbur mbështetjen e masave shqiptare, shkojnë në akte terroriste individuale, duke u lidhur me rrethet reaksionare ndërkombëtare, në ilegalitet për të kërkuar strehim te monarko-fashistët në Greqi, ku bashkërisht me bandat monarko-fashiste bëjnë përgatitje për sulm ndaj RFPJ, duke shkuar, ndërkohë, në luftën e tyre kundër forcave demokratike dhe progresive të popullit grek.

Nëpërmjet Qemal Iskënderit, Hasan Bilallit dhe Azem Maranës, erdhi teri te lidhja e organizatës me bandat tjera të shkapërderdhura si të Hysen Tërpezës, Ibrahim Hakiut, Ajat Gërgurit etj., më vonë vjen deri te lidhjet e këtyre bandave me bandat tjera balliste në Republikën Popullore të Shqipërisë në krye me tradhtarin e popullit shqiptar, Muharrem Bajraktarin, si edhe deri te lidhja me komitetin e kuislingëve dhe gjakëpirësve si Mit'hat Frashëri, Mehdi Frashëri etj. në Bari.

Duke parë se nuk kanë kurrfarë mbështetje te klasa punëtore shqiptare, ndërsa në anën tjetër qëllimi i tyre ishte që me çdo kusht të zbatohen detyrat e paraqitura, ata e rikthejnë të vjetrën duke shpërnda parulla deri te masa e përgjithshme, të cilat fashistët

sistematikisht i shpërndanin me qëllim të krijonin hendek ndërmjet popullit shqiptar dhe popujve jugosllavë. Pakica shqiptare nuk ishte me ata tradhtarë shqiptarë, pakica shqiptare e dinte se bandat e Hisen Tërpezës, Sulë Hotlës dhe Ajet Gërgurit nuk paraqesin asgjë tjetër përveçse përpjekje për t'u rikthyer në kohën e zezë të okupacionit. Ajo, bashkërisht me popujt tjerë të Jugosllavisë, u fut në luftë kundër okupatorit fashist, e vetëdijshme se vetëm me luftën e përbashkët mund ta fitojë lirinë e vet, të zhvillohet dhe të ndërtojë kulturën e vet nacionale. Në këtë luftë heroike pakica shqiptare në Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë dha kontributin e duhur në luftën e drejtë të popujve tanë, e cila përfundoi me sukses dhe e cila popujve tanë ju garantoi të gjitha të drejtat. Në këtë luftë pakica shqiptare përfitoi një vend të lakmueshëm në bashkësinë e popujve jugosllavë, e vetëdijshme se vetëm në bashkësi me popujt tanë mund të përparojë. Dhe pikërisht për këtë nuk ka forcë e cila do të mund ta ndajë pakicën shqiptare nga ajo, që për të është e vetnja rrugë e drejtë.

Se pakica shqiptare vërtet është e lirë në Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë dhe se asaj në të i janë siguruar të gjitha të drejtat dhe i është dhënë mundësia e gjithanshme për jetesë të papenguar nacionale dhe zhvillim të shpejtë, nuk e din vetëm pakica shqiptare, por këtë shumë mirë e dinë edhe këta tradhtarë të cilët janë dërguar para gjyqit. Këtë shumë mirë e di edhe "kreshniku – heroi" i organizatës, AZEM MARANA; këtë e di edhe i edukuari fashist, oficeri i Musolinit Hysni Rudi, këtë e di edhe stipendisti kuisling, dr. Qeram Zllatku. Këtë të vërtetë ata edhe para gjyqit e kanë pranuar kur para Azem Maranës, sekretarit të organizatës së tyre, thanë se pakica shqiptare në RFPJ është e lirë, mirëpo ata me vetëdije atë pakicë e kanë mashtruar.

Desia br. 198
 Prilog br. 38
 Strana br. 3

Пресуда: *гав. од 30. маја 1946. го. 6210/14-X-46*
 на змет со застрелување и траен губитак на пилитички и гаварошки
 права. Уи.бр.1/21.1.1.47.год.Јавно обвинителство за гр.Скопје.бр.
 бр. 8/47.год.Скружни суд.Скопје.

Л И Ч Е Н О П И С

Бојот: СРЕДЕН коса: СМЕДЛА оч: КОСТЕВАНИ
 Уста: ПРАВИЛНА заби: ОДРАВИ нос: ПРАВИЛЕН
 Мустаки: БРИЧИ брада: БРИЧИ особени знаци: НАМА

Дактилоскопска формула: 34344
22222

Фотографија: Од ко'е оделение је тех. зарегистриран:
за Македонија број 1535 го 1946. г.



Pikërisht nga ajo se këta e dinë, ata janë kundër kësaj lirie të pakicës shqiptare. Ata jan kundër edhe nga shkaku se e di se Republika Federative Popullore e Jugosllavisë është shtet i pavarur, se popujt e Jugosllavisë janë zotërues të pasurisë së kësaj toke, se ky pushtet është në duart e masave të gjera punonjëse, se toka i takon fshatarit, të cilën e punon. Pikërisht nga krejt kjo që u tha, ata, si besnikë të veprimtarisë së tyre gjakëpirëse dhe antipopullore, besnikë të tradhtive të tyre, të cilat i kanë kryer gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe, së fundi, besnikë ndaj padronëve të tyre të rinj, mbjellin urrejtje nacionale, pakënaqësi të paparë, të errët dhe joparimore, të bazuar dhe krijuar në fanatizmin e mesjetës.

Natyrore është, që në punën e tyre tradhtare të gjejnë ndihmë nga jashtë, te shtresat e orientuara armiqësisht ndaj Jugosllavisë së Re. Edhe njëra edhe tjetra palë kanë të njëjtin qëllim: të rrënojnë pushtetin popullor, këtë krijesë më të bukur të Luftës Nacional-çlirimtare, si në Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë po ashtu edhe në Republikën Popullore të Shqipërisë, si aleate e jonë, dhe ta ripërtrijnë ndërtesën e vjetër të Karagjorgjeviqit dhe Petar Zhivkoviqit në Jugosllavi dhe Ahmet Zogut në Shqipëri. Prandaj, nuk është kurrfarë befasië që gjeneral Hodgsoni i premton 35.000 pushkë dhe ndihma tjera materiale dhe morale bandave balliste në Republikën e Shqipërisë. Prandaj, nuk është kurrfarë befasië që të kërkojnë oficerë nga ndërkombëtarët, të cilët do të udhëhiqnin me aksionet e atyre bandave balliste; nuk është kurrfarë befasië që nga konsulli turk në Shkup marrin pasaportë për banditin, i cili do të përcjellë jashtë informacione sekrete dhe direktivën e konsullit; dhe së fundi, nuk është kurrfarë befasië që banditët t'i shkruajnë letër konsullit anglez në të cilën e pyesin se a të qëndrojnë në pyll apo të kalojnë në Greqi. Në tërësi, është vërtetuar fakti se dy javë më pas filloi koncentrimi i bandave balliste dhe, si rezultat i atij koncentrimi – depërtimi në drejtim të Greqisë.

Kjo organizatë antipopullore do të lidhet me mbeturinat ustashe, me bandat gjakëpirëse kroate, pastaj me organizatën terroriste të Vanço Mihajlllovit dhe së fundi me mbeturinat e njera të organizatës tradhtare të Drazha Mihajllloviçit, pikërisht me bandat gjakatare, me ato banda që deri në vitin 1941 pakicën shqiptare në Jugosllavi e kanë shtypur deri në skajshmëri. Ky është një mbarim logjik e të gjitha organizatave të njgjajshme sepse:

Ato në punën e tyre antipopullore, janë distancuar prej masave dhe, duke mos patur ku të mbështeten, krijojnë banda gjakatare, të cilat ia shtrinë njëra-tjetrës dorën dhe bashkërisht u futën në tradhtinë edhe më të madhe. Ata bijnë për shkak se ajo rënie është e patjetërsueshme, sepse lidhjet me elementët reaksionarë jashtë vendit dhe lidhjet ndërmjet veti nuk janë të mjaftueshme për

ballafaqimin me popullin. Populli çdoherë ka fuqi në vete për t'i përmbysë.

Është vërtetuar fakti, se të gjitha rrugët e tradhtarëve të popujve tanë janë në Greqinë monarko-fashiste, e cila është themeli i vetë atyre gjakëpirësve. Ata shkojnë atje sepse e dinë që monarko-fashistët do t'ju japin mbështetje të plotë, se do t'ju japin, ushqim, veshmbathje dhe kazermat në të cilat do të bëjnë jetë ushtari, shkojnë atje sepse ngushtë janë lidhur me ta, dhe së fundi, shkojnë sepse janë shërbëtorët e tyre, sepse janë në ballë të bandave monarko-fashiste, ku natë e ditë përgatiten për ndërhyrje në Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë dhe atë të Shqipërisë.

Gjatë procesit nëntëditor, i cili është udhëhequr në mënyrë objektive nga gjyqi popullor dhe i përcjellur me shumë vëmendje nga masat popullore të shtetit tonë, përftohet një pasqyrë e qartë, se bëhet fjalë për një organizatë të pastër antipopullore, me qëllime fashiste nën mbulesën "Nacional Demokratike Shqiptare". Nga deklaratat e vetë organizatorëve dhe anëtarëve udhëheqës të kësaj organizate, si dhe nga deklaratat e dëshmitarëve si dhe nga dëshmitë e ofruara është vërtetuar karakteri i rëndë kriminal dhe gjakëpirës i organizatës së lartpërmendur në aktivitetet e saj antipopullore, e cila pothuajse dy vjet i ka zhvilluar në territorin e Republikës Popullore të Maqedonisë dhe në Kosovë.

Pasi lidhen ndërmjet veti, më pas themelojnë organizatën, ku Komiteti Qendror në Shkup fillimisht paraqitet si lidhja kryesore mes bandave balliste vendore me organizatat e ngjajshme në Perëndim si dhe lidhja me rrethet reaksionare ndërkombëtare prej të cilave kanë pritur ndihmë materiale dhe morale.

Ndërkohë, duke mos arritur të lidhen me bandat në Republikën Popullore të Maqedonisë, organizata dhe Komiteti Qendror vendosin t'i vazhdojnë lidhjet me bandat, të cilat kalojnë në Greqinë monarko-fashiste, dhe, sipas deklaratave të të kuzuarve Hasan Bilalli, Nazmi Azenit etj. ekziston shtabi i zonës operative Nr. 2 si

dhe komiteti ku, sipas deklaratës së dëshmitarit Bajram Bajraktari, tradhtari i popullit liridashës, Ali Këlcyra më herët e ka formuar komitetin ballist me qëllime të njëjta, repsektivisht për ndërhyrje në Republikën Popullore të Shqipërisë. Kjo ndërhyrje do të paraqiste sinjalin për kryengritjen e bandave balliste në Republikën Popullore të Shqipërisë.

Të vetëdijshëm se masat shqiptare nuk do t'i përfitojnë vetëm me parullat që ata kanë shpërndarë, ata orientohen te sllavët, duke tentuar t'i paraqesin si armiq të shqiptarëve. Ata e dinë se merita më e madhe për përmbysjen e fashizmit i takon sllavëve. Ata, gjithashtu, e dinë edhe atë se popujt sllavë pas luftës janë luftëtarët më këmbëngulës për paqe përfundimtare dhe të drejtë, se janë rojet më këmbëngulëse të lirisë dhe pavarësisë së popujve të vegjël, se në administrimin shtetëror kanë shkuar përpara dhe paraqiten si shembull i popujve tjerë. Ata këtë e kanë ditur dhe me vetëdije e kanë mbjellur urrejtjen kundër sllavëve, me çka ju kanë shërbyer atyre armiqve, të cilët përpiqen të krijojnë njëfarë blloku antisllavë, atyre nxitësve të luftës, atyre të cilët njëkohësisht janë armiq të më të përбетuar edhe të vetë shqiptarëve.

Të distancuar dhe përjashtuar nga populli, ata kalojnë në aksione terroriste. Si kurban i veprimtarisë së tyre ra heroi popullor Miladin Popoviçi, i cili tërë jetën e vet ia kushtoi popullit dhe zgjerimit të marrëdhënieve vëllazërore me pakicën shqiptare, pastaj Rexhep Zajazi, Mehmed Zajazi dhe djem e vajza tjera të popullit punëtor. Të qorruar dhe tërësisht të orientuar në vepra tradhtarë, ata shkojnë me mjete gjakpirëse duke menduar se në këtë mënyrë do të mund t'i arrijnë qëllimet e tyre. Mirëpo, ky gjak i derdhur, çdo dëshmor i rënë edhe më tepër i bashkonte popujt tanë, edhe më tepër i përforconte themelet e ndërtesës sonë.

Veprimtaria antipopullore dhe terroriste e organizatës edhe më tepër do të përforcohet me ardhjen e spiunit të përбетuar Halim Oranës, ish-konsulli i qeverisë kuislinge të Shqipërisë, te gjakëpirësi i popullit Paveliç.

Zgjedhja e të akuzuarit Hysni Rudi për komandant suprem të bandave në territorin e Kosovës dhe Republikës Popullore të Maqedonisë vërteton se bandat kan menduar se është koha të kalojnë në zbatimin e planeve të tyre të errëta, posaçërisht pas fjalimit inkurajues të oficerit të Calldirisit drejtuar vëllezërve të tyre, bandave balliste të ikur në Greqinë monarko-fashiste, që përmban këtë: "Mos u demoralizoni, së shpejti do të vijë dita ku bashkërisht do të kthehemi në vendin tuaj".

Unë, si Prokuror publik i cili duhet të tregojë objektivitetin më të madh në aktakuzë, nuk mundem të gjej madje asnjë fjalë e cila do të shfrytëzohej si rrethanë lehtësuese për akuzën. Ata kanë qenë nga fillimi armiq të përbetuar të popullit të tyre. Detyra e tyre themelore përbëhej në veprimtarinë kundër popullit të tyre, në veprimtari kundër popujve të Jugosllavisë.

Në bazë të kësaj që u elaborua dhe duke patur parasysh procesin e zhvilluar deri tash, duke patur parasysh materialin që gjyqi disponon, Prokuroria Publike është e mendimit se aktakuza në tërësi dhe në veçanti për çdo të akuzuar është vërtetuar në tërësi, se është vërtetuar çdo paragraf i saj. Për këtë arsye, i propozoj gjyqit që të akuzuarve t'u jepen dënime sa më të rënda për veprën e kryer.

Dokumenti nr. 4:

VENDIM

i Gjyqit të Qarkut të Shkupit kundër 19 veprimtarëve të KQ të NDSH-së në Shkup, që kryetari i gjyqit Panta Maria e lexoi më 7 shkurt 1947¹⁶³

VENDIM

NË EMËR TË POPULLIT

Gjyqi i Qarkut në qytetin e Shkupit me përbërje: kryetar **Panta Marina** anëtarë-porotë **Tekia Aliti**, **Vesel Limani**, me proçesmbajtësin **Borçe Cvetkovskin** në veprën penale numri penal 8/47 kundër të akuzuarve: **Qemal Iskënderi Alim**, **Azem Idriz Marana**, **Mexhit Haki Zyberi**, **Mahmut Hysen Dumani**, **Hysni Muharrem Rudi**, **Mehmet Nazim Bushi**, **Jonuz Imer Balla**, **Dr. Qeram Muhamet Zllatku**, **Osman Ahmet Cami**, **Medat Mustafa Tërshana**, **Gani-Bej Mehmed Abdullau**, **Spiro Harilla Theodosi**, **Hajdar Kurtish Jashari**, **Mulla Hajdari**, **Xhemal Fazli Kasami**, **Sherif Mehmet Aliti**, **Xhavit Abdulla Selimi**, **Galip Mustafa Rauf**, **Hasan Hamzë Bilalli** dhe **Nazmi Emin Azemi**, të gjithë në burgun hetues për shkak vtë eprës penale sipas nenit 3 pika 1, 2, 4, 7, 8, 9 dhe 14 lidhur me nenin 2 nga ligji për vërtetim dhe ndryshim dhe plotësim të Ligjit për vepra penale kundër popullit dhe shtetit mbështetur në aktakuzën e Prokurorit Publik të Republikës Popullore të Maqedonisë, **Nikolla Vrazhalski**, numër 1/47 nga data 11.I. 1947 gjatë mbajtjes së seancave të mbyllura dhe të hapura në ditët 26, 27, 28, 29, 30, 31 janar dhe 1, 3 dhe 4 shkurt 1947, në të cilat Prokurori Publik i RP të Maqedonisë **Nikolla Vrazhalski** kërkoi që të gjithë të akuzuarit të shpallen si fajtorë dhe të marrin dënimet e

¹⁶³ ДАРМ-оделение Скопје, 1.81.8/1-12, ПРЕСУДА К.бп.8/47.

merituara ndërsa fajtorët dhe mbrojtësit e tyre edhe atë: i akuzuari Qemal Iskënderi Alim, Azem I Marana, Mexhit H. Zyberi dhe Galip Rauf dhe mbrojtësi i tyre: Shukri Ramo: të akuzuarit Mamut Dumani dhe Hysni Rudi me mbrojtësin Abdulla Saqipi avokat; Mehmet Bushi dhe Qeram Zllatku me mbrojtësin Bllagoja Poppankov, avokat; të akuzuarit Jonuz Balla, Hasan Bilalli dhe Xhavit Abdullau me mbrojtësin Anton Pop–Todorov, avokat; të akuzuarit Spiro Theodosi dhe Gani Bej Mehmet Abdullau me mbrojtësin Zhivko Bazhdavella avokat; të akuzuarit Xhemal F Kasami dhe Sherif Memet Aliti me mbrojtësin Risto Janakiev, avokat; të akuzuarit Osman Cami dhe Medat Tërshana me mbrojtësin Jordan Panzov Stojanov, avokat; dhe të akuzuarit Hajdar Kurtishi dhe Nazmi Azemi me mbrojtësin Mirko Shulev, avokat; lusin që të sjellen dënime sa më buta, gjyqi solli shpallur me datën 7.II.1947 këtë

VENDIM:

1.Qemal Iskenderi Alim, *djalë i Iskenderit Halinit dhe Ademsha Aliut, Berber, i lindur në Shkup, i moshës 24 vjeçare, për nga përkatësia kombëtare shqiptar, shtetas jugosllav, di shkrim, lexim, i martuar, me dy fëmijë, i padënuar deri tash, në periudhën e okupacionit organizatorë i çetave balliste, tash në burg.*

2.Azem Idriz Marana, *djalë i Idriz Maranës dhe Hatixhe Durakovas, mësues, i lindur në fshatin Maranë, e jeton në Shkup, i moshës 23 vjeçare, përkatësia nacionale shqiptar, shtetas jugosllav, i martuar, deri tani nuk është i dënuar, në kohën e okupacionit mësues në rrethinën e Tetovës, tash në burg.*

3.Mexhit Aki Zyberi, *djalë i Haki Zyberit dhe Sulejhana Saliut, pemëshitës, i lindur në Shkup, i moshës 22 vjeçare, përkatësia nacionale shqiptar, shtetas i Jugosllavisë, di shkrim, lexim, i martuar, babë i dy fëmijëve, deri tash nuk është dënuar, tashti në burg.*

4.Mahmut Hysein Dumani, *djalë i Hysein Dumani tdhe Melege Osmanit, i lindur në fshatin Vellovë (Peshkopi–Shqipëri), banor i Shkupit, shqiptar, shtetas i Shqipërisë, i padënuar, tash në burg.*

5.Rudi Hysni Muharrem, *djalë i Muharremit dhe Nerxhivanit, i moshës 29 vjeçare, përkatësia nacionale shqiptar, shtetas jugosllav, gjatë kohës së okupacionit oficer italian, i pranuar në Armatën jugosllave, ish–kapiten, i padënuar, tash në burg.*

6.Mehmed Nezir Bushi, *djalë i Nezirit dhe nënë Mines oficer, i lindur në fshatin Dukalinë – Burelë–Shqipëri, jeton në Tetovë, i moshës 33 vjeçare, përkatësia nacionale shqiptar, shtetas shqiptarë, ka kryer Akademinë Ushtarake në Romë – Itali, në kohën e okupacionit kryetar i Komunës, i padënuar, tash në burg.*

7.Jonuz Imer Balla, *djalë i Imerit dhe nënë Hatixhes, mësues, i lindur në fshatin Molis (Elbasan–Shqipëri), jeton në Tetovë, i moshës 25 vjeçare, shqiptar, shtetas shqiptar, i padënuar, në kohën e okupacionit mësues, tash në burg*

8.Dr. Qerim Muhamet Zllatku, *djalë i Muhamedit dhe Dulnies, mjek, i lindur në Dibër, i moshës 32 vjeçare, përkatësia nacionale shqiptar, shtetas jugosllav i pamartuar, i padënuar, gjatë kohës së okupacionit student në Zagreb, dhe pastaj mjek në Tiranë, tashti në burgun hetues.*

9.Osman Amet Cami, *djalë i Ahmetit dhe Shyretes, bujk, i lindur në Dibër, i moshës 28 vjeçare, përkatësia nacionale shqiptar, shtetas jugosllav, i pamartuar, i padënuar, tash në burgun hetues.*

10.Medat Mustafa Tërshana, *djalë i Mustafës dhe Hamides, tregëtar, nga Dibra, i moshës 30 vjeçar, shqiptar, shtetas jugosllav, i pamartuar, i padënuar, tash në burgun hetues.*

11.Ganibeu Memed Abdullahu, *djalë i Memedit dhe Zibes, bujk, i lindur në dibër, i moshës 55 vjeçar, përkatësia nacionale shqiptar, shtetas jugosllav, din shkrim lexim, i martuar, babë i katër fëmijëve, i padënuar, tash në burgun hetues.*

12.Spiro Harrilla Theodosi, *djalë i Harillës dhe Nadjezhdës, mësues, i lindur në Korçë–Shqipëri, jeton në Gjorçe Petrov, i moshës 22 vjeçare, shqiptar, shtetas i Shqipërisë, i pamartuar, i padënuar, tash në burgun hetues.*

13.Hajdar Kurtish Jashari – Mulla Hajdari, *djalë i Kurtishit dhe Hibës, bujk, hoxhë, i lindur në fshatin Orizarë, rrethi i Kumanovës, i moshës 37 vjeçarë, përkatësia nacionale shqiptar, shtetas jugosllav, i martuar babë i 5 fëmijëve, i padënuar, gjatë kohës së okupacionit organizator i çetave balliste, tashti në burgun hetues.*

14.Xhemail Fazli Kasami, *djalë i Fazlisë dhe Meremes, polic, i lindur në fshatin Bllacë, i moshës 28 vjeçarë, përkatësia nacionale shqiptar, shtetas jugosllav, i pamartuar, i padënuar, tash në burgun hetues.*

15.Sherif Memed Aliti, *djalë i Memetit dhe Nebijës, xehtar, nga Kaçaniku, jeton në Shkup, i moshës 35 vjeçar përkatësia nacionale shqiptar, shtetas jugosllav, i martuar, babë i dy fëmijëve, i padënuar, tash në burgun hetues.*

16.Xhavit Abdulla Selimi, *djalë i Abdullahut dhe Fatimes, rrobaqepës, i lindur në Shkup, i moshës 22 vjeçar, përkatësia nacionale shqiptar, shtetas jugosllav, di shkrim, lexim, i pamartuar, i padënuar, tash në burgun hetues.*

17.Galip Rauf Mustafa, *djalë i Raufit dhe Ilfetes, rrobaqepës, i lindur në Gjilan, i moshës 44 vjeçarë, përkatësia nacionale turk, shtetas jugosllav, babë i dy fëmijëve, di shkrim, lexim, i padënuar, tash në burgun hetues.*

18.Hasan Hamdi Bilalli, *mësues, i lindur në Prishtinë, jeton në Shkup, i moshës 29 vjeçarë, përkatësia nacionale shqiptar, shtetas jugosllav, djalë i Hamdisë dhe Hatona, di shkrim, lexim, ka kryer 6 klasë shkollë dhe kursin pedagogjik në kohën e okupacionit, nuk është i martuar, nuk është i dënuar, tash në burgun hetues.*

19.Nazmi Emin Azemi, *bujk, i lindur në Kaçanikun e Vjetër, i moshës 23 vjeçare, përkatësia nacionale shqiptar, shtetas jugosllav, djalë i Eminit dhe Sherifës, di shkrim, lexim, i pamartuar, nuk është i dënuar, tash në burgun hetues.*

JANË FAJTORË PËR SHKAK SE:

a) Gjatë periudhës 1945, kanë organizuar, udhëhequr dhe kanë qenë anëtarë të Organizatës ilegale antipopullore e ashtuquajtur “Nacional Demokratike Shqiptare”, në krye të së cilës, nga muaji korrik 1946, është krijuar Komitet Qendror. Me seli në Shkup, i përbërë prej 6 anëtarëve, organizatë e cila ka përfshirë territorin e Kosovës, Metohisë dhe Maqedonisë, kanë patur për mision që, nën parullën e nacionalizmit fals të ushtrojnë propagandë shoviniste dhe agjitacion, të përfshijnë sa më tepër shqiptarë dhe turq, të hidhen në ilegalitet ku do të lidhen me grupet bandite, të krijojnë klimë të përshatshme për intervenim, të rrezikojnë integritetin e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, ta shkëpusin nga ajo territorin autonom, Kosovën, dhe pjesën më të madhe të Republikës Popullore të Maqedonisë, që me ato territore, në lidhje me organizata të ngjashme në diasporë dhe me ndihmën e imperializmit ta rrëzojnë sistemin shtetëror aktual në Republikën Popullore të Shqipërisë, të krijojnë Shqipëri të madhe me udhëheqje zogiste, kuislinge dhe balliste në krye.

b) Për shkak të krijimit të detyrës së parashtruar, organizata ka kryer punë vetëm në aksionet me bandat e ngelura në Kosovë dhe Maqedoni, ka pranuar banditizmin si metodë për luftë, duke i marrë të gjitha masat që numri i bandave të zmadhohet, duke i dhënë si detyrë çdo komiteti të rrethit të organizatës të organizojnë nga një çetë balliste dhe t’ia bashkangjisë bandave ekzistuese, ka organizuar lidhje dhe e ka përfshatë punën me mbeturinat e bandave balliste në terrenin e Republikës Popullore Shqiptare, me

të cilat bashkërisht të merren sulme për ta rrezikuar si shtetin tonë ashtu edhe R.P. të Shqipërisë.

c) Janë lidhë me komitetet në Bari, Kajro dhe Greqi, të cilat atje janë formuar nënkomitetet nga shqiptarë të arratisur, elementë kuislingë, të cilët nën mbështetjen dhe ndihmën e imperialistëve të huaj, të luftojnë kundër shtetit tonë, dhe në pajtim të direktivave dhe udhëzimeve nga jashtë, të cilët i kanë marrë nëpër kanalet nëpërmjet Greqisë monarkofashiste, të zgjerojnë propagandë false për domosdoshmërinë e Luftës mes anglo-amerikanëve në njërin anë dhe popujve sovjetik – popujve sllavë në anën tjetër, ku në këtë situatë shqiptarët do të duhej të ngrihen në kryengritje të përgjithshme kundër Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë.

ç) Janë lidhur me organizatën e Vanço Mihajllorit në diasporë, me qëllim e organizimit të luftës së përbashkët kundër RFPJ, e nëpërmjet Halim Oranës, ish – konsull i Shqipërisë, kuisling i gjakëpirësit Pavliq, janë lidhur me bandat e mbetura të ustashëve në Kroaci dhe çetnikët të tradhtarit Drazha Mihalloviqit në Serbi.

d) Janë futur në lidhje dhe kanë pranuar udhëzime për punën e organizatës nga konsulli turk në Shkup, Emin Geçek, i cili u dorëzon pasaporta për kalimin e bandave në Greqinë monarkofashiste, dhe udhëzon bashkimin e shqiptarëve dhe turqëve në luftë kundër RFPJ, kanë vendosur lidhje me konsullin anglez në Shkup, Xhorxh Herbert Bruton, nga i cili kanë kërkuar udhëzime për punën e mëtejshme të organizatës, pas së cilës ka ardhur tërheqja e një pjese të bandave në Greqinë e monarkofashistëve.

dh) Kanë tubuar elementë armiqësorë profashistë në radhët e shqiptarëve në Brigadën VII shqiptare në armatën jugosllave, duke i orientuar me propagandë të gënjeshtërt, se Armata jugosllave do të shkatërrohet, si e si t'i tërheqin në mal dhe t'i bashkangjisin me bandat e atëhershme ekzistuese, gjithë këtë me qëllim që në njërin anë të dobësohet forca sulmuese e armatës tonë e në anën tjetër,

gjatë luftës për çlirimin përfundimtar të atdheut nga okupatori të mundësojnë forcat fashiste dhe okupatorët që, pa u dënuar, të tërhiqe nga Jugosllavia, të largojnë një pjesë të madhe të forcave të armatës tonë në luftë kundër bandave dhe kështu të krijojnë kushte për intervenimin nga jashtë.

e) Kanë sjellë vendim në mbledhjen e qershorit 1946, që e kanë quajtur kongresi i katërt, që t'i përforcojnë aksionet terroriste dhe të kalojnë në eliminimin të përfaqësuesve të popullit, organet shtetërore dhe personave ushtarakë siç edhe janë vrarë: Heroi i Popullit, Miladin Popoviqi, Rexhep Zajazi – anëtar i Këshillit të përgjithshëm të frontit popullor të Maqedonisë, Memet Dauti – deputet i popullit, Remzi Abedini – zëvendëskomandant i batalionit, togren Panda Çeskovska etj.

f) Në bashkëpunim me bandat ekzistuese – mbeturinat e shkatërruara balliste në Shqipëri, dhe me ata që nga Shqipëria kanë ikur në Greqinë monarkofashiste e kanë orientuar punën e tyre për rrënimin e sistemit shtetëror ekzistues në Republikën Popullore të Shqipërisë, duke rrezikuar me këtë edhe sigurinë e saj, krejt me qëllim që të vendosin pushtet antipopullor me në krye shërbëtorët e njohur të okupatorit dhe tradhtarët shqiptarë si Muharrem Bajraktari, Mit'hat Frashëri dhe të dënuarit tjerë veç e veç.

JANË FAJTORË EDHE PËR ATË:

1) I akuzuari Qemal Iskënderi Halim:

a) Në pranverën e vitit 1945 është futur në organizatën antipopullore për qëllimet e lartpërmendura, nga Hasan Bilalli, punoi në zgjerimin e kësaj organizate, duke ofruar Rexhep Daut Fazliun, komandant i policisë popullore në fshatin Tanishecë, tash në arrati, si dhe të akuzuarin Xhemail Fazli Kasami. Përmes tyre, sipas vendimit të organizatës, bashkë me Mexhit Haki Zyberin, hyri në lidhje me çetat ilegale balliste, me udhëheqësit e të cilave siç janë

Hisen Tërpeza, Din Hoxha, Luan Gashi, Ibrahim Hakiu etj, në gusht të vitit 1945 në fshatin Tanishecë zhvilloi mbledhje ilegale të ashtuquajtur Kongresi i tretë i organizatës "nacional demokratike shqiptare", ku u morën këto vendime:

Të punojnë për zgjerimin e mëtejshëm të organizatës në territorin e RPM dhe Kosovës, duke nxitur urrejtje fetare dhe nacionale në mesin e popullatës; të lidhen me të gjitha çetat balliste ekzistuese të cilat t'i zgjerojnë me dërgimin e njerëzve të tyre, si dhe të organizojnë të atilla atje ku mungojnë, dhe të gjitha ato të jenë nën udhëheqjen e organizatës, të kujdesen për armatimin dhe ushqimin e çetave, dhe për këtë krerët të vendosin lidhje me konsullatën angleze dhe atë turke në Shkup nga të cilat të kërkojë ndihma dhe udhëzime për veprimtarinë e mëtejshme të organizatës dhe posaçërisht të vendosin lidhje me komitetin në Bari dhe bandat monarko-fashiste në Greqi për shkak luftës së përbashkët kontradiktore kundër RFPJ. Organizata të kalojë në eliminimin fizik të deputetëve popullorë, të organeve shtetërore, si dhe të zhdukë ata shqiptarë të cilët nuk pajtohen me punën dhe qëllimet e organizatës.

Pas miratimit të konkluzioneve, i akuzuari Qemal Iskënderi bashkërisht me Mexhit Haki Zyberi këto vendime i përcollën në Shkup, dhe në formë direktive ua paraqitën anëtarëve tjerë të organizatës për zbatimin e tyre ku pjesërisht edhe korrën sukses.

b) Kur Ibrahim Hakiu ish-profesor në gjimnazin e Prishtinës u caktua si delegat i çetave balliste në Shkup, i akuzuari Qemal Iskënderi në shtëpinë e tij mundësoi disa takime me Hasan Bilallin, Zhozef Bërkiçin etj, gjithë me qëllimin që organizata të zgjerohej, të forcohej dhe të vendosnin lidhje me konsullatat angleze e turke në Shkup. Lidhur me këtë, Ibrahim Hakiu shkroi një letër përkonsullin turk, letër të cilën i akuzuari Qemal Iskënderi nëpërmjet Hasan Bilallit dhe të akuzuarit Xhavit Abdullahun e dorëzuan deri te konsulli turk, i cili, në përgjigjen e dhënë i porositi të ishin unikë në aksionet me elementet reaksionare të pakicës

nacionale turke për një sukses më të madh në luftën e organizatës kundër RFPJ.

c) Më vonë, në vjeshtën e vitit 1945, pasi i tërhoqi dhe i futi në organizatë Halimin, Nazifin dhe Ramadanin nga fshati Zajas i Kërçovës, luftëtarë në AJ, nëpërmjet tyre punoi për zgjerimin e organizatës në radhët e AJ. Lidhet me ballistin Mefail Zajazin i cili me çetën e tij vepronte nëpër fshatrat e Kërçovës duke i nënshtuar shqiptarët me qëllim që të anëtarësoheshin në organizatë. Përmes Hajdar Kurtishit u lidh me komitetin që me kohë ishte formuar nga banda e Sulë Hotlës në fshatin Orizare dhe nëpërmjet këtij komiteti vendosi kontakte të përhershme me çetën e lartpërmendur, ndërsa pas burgosjes të disa anëtarëve të këtij komiteti Qemali formoi çetë tjetër në të njëjtin fshat si dhe në fshatrat Tërnovcë, Llojanë dhe Brezë. Pas kësaj u lidh me Hamid Eminin, të cilin e anëtarësoi dhe i dha si direktivë të formonte komitete në Kosovë, si edhe të lidhej me çetat e armatosura atje, ku edhe ka korrrë sukses. Gjithashtu, ai arriti të vendoste lidhje me çetën e Ramës nga Gjilani të cilën edhe ia bashkangjiti organizatës;

ç) Në pranverën e vitit 1946, dërgoi në Shqipëri Mehmet Breznicën, për t'u lidhur me Komitetin Qendror të organizatës homologe të atjeshme, dhe prej andej të sillte një anëtar të Komitetit Qendror të asaj organizate si dhe një oficer anglez, i cili do të udhëhiqte me punën e çetave të armatosura ushtarake të organizatës sipas direktivave të imperializmit perëndimor. Më vonë Mehmet Breznicën e dërgoi edhe në Greqi me qëllim të rivendoste lidhjen e shkëputur me çetat balliste, të cilat ndodheshin në territorin grek dhe me ndihmën e monarko-fashistëve dhe të imperializmit perëndimor përgatitën sulm e armatosur kundër Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë dhe RP të Shqipërisë;

d) Në maj të vitit 1946, bashkërisht me Halim Oranën, ish-konsull i qeverisë kuislinge të Shqipërisë i gjakpirësit Pavliq, i cili pas çlirimit e lidhi organizatën "nacional demokratike shqiptare" me mbeturinat ustashe në Kroaci, me çetat e shpartalluara të D.M., me

organizatën terroriste të Vanço Mihajlllovit në diasporë dhe me komitetin e Barit në Itali, punoi në përforsimin e organizatës, për qëllimin e së cilës bashkërisht me të akuzuarit AZEM MARANA, Hysni Rudi dhe Mexhit Zyberi dhe tash i aratisuri Hasan Bilalli thirën Kongresin IV të organizatës, i cili u mbajt në Shkup me 1 qershor të vitit 1946, ku morën pjesë delegatët e territoreve të RP të Maqedonisë dhe Kosovës.

Në këtë kongres u formua Komiteti Qendror i organizatës në të cilin u fut edhe i akuzuari Qemal Iskënderi. Në kongres u paraqit rezoluta në të cilën, përveç tjerash, pakica shqiptare ishte e fuar në luftë kundër RFPJ.

dh) Pas mbajtjes së kongresit, ku falë aksioneve të suksesshme të njësisve të AJ, vjen në pikëpyetje ekzistenca dhe mirëmbajtja e çetave të armatosura në territoret e RPM dhe Kosovës, i akuzuari Qemal Iskënderi nëpërmjet Zhozef Bërkiçit i dorëzoi një letër konsullit anglez në Shkup të cilën, sipas dëshmisë së tij, e ka shkrojtur të akuzuarit AZEM MARANA dhe Jonuz Balla, ku nëpërmjet saj organizata kërkonte ndihmë dhe këshillime nga konsulli i lartpërmendur nëse edhe më tutje çetat e armatosura do qëndronin në territorin e RFPJ apo të kalonin në Greqi; gjithashtu, kërkonin edhe shifrën për mbajtjen e lidhjeve me radiostacion, pas së cilës filloi edhe koncentrimi i çetave të Ajet Gërgurit, Gjon Sereçit, Din Hoxhës etj, për kalimin në Greqi, ku një pjesë e të cilëve edhe sot ndodhen atje.

e) Si anëtar i KQ të organizatës, pas mbajtjes së kongresit me qëllim që të viheshin në jetë konkluzionet e sjellura, shkoi në Kosovë ku bëri revizionimin e komiteteve ekzistuese, zhvilloi mbledhje me Ajet Gërgurin dhe profesorin Gjon Sereçin në malet e Drenicës ku nisi pregatitjet për mbajtjen e kongresit të pest të organizatës.

f) Përveç atyre që u thanë deri tash, i akuzuari Qemal Iskënderi akuzohet edhe për atë se në vjeshtën e vitit 1944, gjat tërheqjes së ushtrisë gjermane nga Maqedonia ka pranuar prej tyre dhe

bashkëpunëtorëve të tyre armatime rreth 800 pushkë së bashku me municionin përkatës me të cilat armatosi elementët armiqësorë nga rrethi i Shkupit për luftë kundër ushtrisë nacionalçlirimtare të Jugosllavisë duke marrë pjesë edhe vetë dhe duke i krijuar kështu mundësi forcave gjermane ta kishin më të lehtë tërheqjen nga territori i RP të Maqedonisë

2) I akuzuari AZEM MARANA:

a) Në fillimin e vitit 1945, meqë ishte i orientuar armiqësisht kundër regjimit ekzistues të RFPJ, bashkërisht me Hasan Bilallin, të akuzuarin Mahmut Dumanin etj., organizoi dhe mori pjesë në katër mbledhje në të cilat është formuar organizata me qëllimet e lartpërmendura. Lidhur me këtë, me propozimin e Mahmut Dumanit, me qëllim që të arriheshin qëllimet e organizatës, vendosën që brigada VII shqiptare, e cila në atë kohë qëndronte në Kumanovë në kuadër të AJ, të tërhiqej në mal, duke krijuar edhe fondin përkatës për mirëmbajtjen e saj.

b) Në tetor të vitit 1945, në një takim që ka patur në Shkup me Abdulla Musliun, kryetar i këshillit popullor të rrethit të Ferizajt, mori udhëzimin nga i ashtuquajtimi shtab kryesor i ushtrisë popullore për çlirimin e Kosovës, udhëzim të cilin e shumëzoi për shpërndarje.

c) Në pranverën e vitit 1946, si një ndër udhëheqësit e organizatës, u lidh me Gjon Sereçin, përfaqësues i dalluar e së njëjtës organizatë në Kosovë, me të cilin u mor vesht se në çfarë mënyre dhe me çfarë forcash të përbashkëta ta zgjeronin organizatën. Për këtë qëllim mori shifrën për mbajtjen e lidhjeve konspirative, shifër me të cilën mbajti lidhje edhe pas kalimit të tij në mal, te çetat balliste;

ç) Duke punuar për zgjerimin e organizatës në Shkup, krijoi grupin prej katër anëtarëve: Hamdi Abaz Sulejmani, Demir shnajderin, Nebi Jonuzin dhe Sherif drugdhendësin, të gjithë nga Shkupi; i anëtarësoi në organizatë të akuzuarit Mehmet Bushin dhe Spiro Harillën, u dha detyra që në rrethet e Tetovës dhe të Gjorçes

Petrovit ta zgjeronin organizatën dhe të krijonin komitete, detyrë, të cilën këta edhe e kryejnë. I akuzuari A. Marana personalisht mori pjesë në betimin solemn të anëtarëve të organizatës gjatë formimit të komitetit në rrethin e Gjorçe Petrovit.

d) Në vazhdim, si një personalitet me përgjegjësi në organizatë, me qëllim që ta lidhte me organizatën në Kosovë shkoi vetë për Kosovë dhe në Ferizaj, ku u lidh me funksionarin e dalluar të organizatës, Sefedinin, nga i cili u njoh me situatën e organizatës atje.

dh) Si një ndër anëtarët më të dalluar dhe më aktivë të organizatës, bashkërisht me Hasan Bilallin dhe me të akuzuarit Qemal Iskënderi, kapiten Rudin etj. e organizojnë kongresin IV të organizatës në Shkup. Mori pjesë aktive në dhe njëherësh zgjidhet anëtar i KQ të organizatës. AZEM MARANA është pjesëmarrës në përpilimin e rezolutës së kongresit të lartpërmendur; rezolutën e aprovuar personalisht, e shumëfishon në mainën e shkrimit të organizatës, të cilën ai vetë e ua ka shpërndarë delegatëve të kongresit dhe anëtarëve të organizatës. Gjithashtu, i akuzuari AZEM MARANA ka udhëhequr dhe ka mbajtur në gjendje ruajtjeje arkivin e KQ të organizatës.

3) I akuzuari Mexhit Haki Zyberi:

a) Menjëherë pas çlirimit, duke qenë në detyrë të KV popullor në fshatin Tanishec, ka mbajtur lidhje me çetatat balliste të Hasan Kabashit, Hajri Saqipit etj., për çka ka njoftuar Qemal Iskënderin, me të cilin bashkërisht është futur në organizatë me sugjerimin e Hasan Bilallit para të cilit edhe bëri betimin.

b) Më vonë, me urdhër të organizatës, bashkërisht me të akuzuarin Qemal Iskënderi mori pjesë në mbledhjen e mbajtur në fshatin Tanishec, që është quajtur kongresi III i organizatës, me përfaqësuesit e çetave balliste të Sulë Hotlës, Hysen Tërpezës etj., ku ka dhënë konkluzionet të paraqitura në pikë 1.

c) Në bashkëpunim me të akuzuarin e parë ka krijuar komitetet e organizatës në fshatrat Bojanë dhe Brezë. Me punën e drejtpërdrejtë udhëhoqi dhe anëtarësoi në organizatë: Hafiz Shabanin, hafiz Shukrinë, hafiz Fejzullahun, Qemal Muslinë, Saraçin nga të cilët mblodhi ndihma financiare për nevojat e organizatës.

ç) Me urdhër të të arratisurit Hasan Bilalli shumëfishoi dhe shpërndau shemën e organizatës tekstin e betimit dhe metodën e punës të organizatës, metodë e cila është përpiluar nga i akuzuari Memed Bushi;

d) Gjatë gjithë kohës, deri në zbulimin e organizatës, ka mbajtur lidhje me organizatës dhe çetave balliste në terren, në të cilat ka dërguar njerëz, armatime dhe mjete tjera të nevojshme, si dhe është raportuar për zhvillimet e aksioneve të çetave balliste të Sul Hotlës, Hisen Tërpezës, Mefail Zajazit, Ramës nga Gjilani.

dh) Bashkërisht me Hasan Bilallin dhe të akuzuarin AZEM MARANA etj., ka punuar për përgatitjen dhe thirrjen e kongresit IV të organizatës në Shkup, ku u zgjodh anëtar i KQ të organizatës, duke e kryer detyrën si ballist.

4) I akuzuari Mahmut Dumani

a) Në fillimin e vitit 1945, si kundërshtar i sistemit aktual të RFPJ-së, është lidhur me të arratisurin Hasan Bilallin, me të akuzuarit Azem Maranën, Nebi Veli Jonuzin etj., ku në disa takime që ka mbajtur me ta ka diskutuar për situatën politike të brendshme dhe jashtme duke i bindur për nevojën e formimit të organizatës ilegale, organizatë e cila do të luftonte kundër sistemit aktual politik të RFPJ-së, sistemit aktual shtetëror në R.P. të Shqipërisë, dhe, si rezultat i këtyre takimeve, është formuar organizata, mbështetur në metodat dhe principet e punës, siç janë theksuar më lart.

b) Njëkohësisht, me propozimin e tij, është marrë vendim që Brigada shqiptare, e cila në këtë kohë qëndronte në Kumanovë, në

kuadër të armatës jugosllave, të vendosej në mal dhe për mirëmbajtjen e saj ka qenë krijuar fond i veçantë.

5) I akuzuari Hysni Muharrem Rudi:

a) Meqë kishte orientim armiqësor ndaj sistemit të RFPJ, u lidh me Halim Oranën dhe me të akuzuarit Qemal Iskënderi, Azem Maranën etj. Aktivisht ka punuar për organizimin e kongresit IV, duke qenë një ndër më aktivët në punën e tij. Përpunoi dhe propozoi strukturën organizative të organizatës së "NDSH"; në kuadër të kësaj, ai ka kërkuar që çdo komitet të krijonte çetën e armatosur, e cila nën drejtimin e komitetit të vepronte në terren si dhe të merrte pjesë në vrasjen e atyre shqiptarëve të cilët nuk pajtoheshin me punën dhe qëllimet e organizatës, propozime të cilat kongresi në tërësi i aprovoi edhe me rezolutën duke bërë shpërndarjen nëpër komitetet.

b) Me qëllim që të gjitha këto që u thanë më lart të zbatoheshin në praktikë, i akuzuari kapiten Rudi u zgjodh anëtar i KQ të organizatës.

6) I akuzuari Mehmed Bushi:

a) Në tetor të vitit 1945, kur vihet në dijeni nga Muhamet Jakupi për ekzistencën e organizatës antipopullore, me qëllimet e lartpërmendura, u bë anëtar i saj dhe gjatë shkuarjes në Shkup u lidh me Azem Maranën, Qemal Iskënderin, anëtarë të KQ të organizatës në Shkup nga të cilët mori detyrën e formimit komitetin e rrethit në Tetovë, detyrë të cilëy menjëherë e kreu në mbledhjen e radhës në fshatin Reçicë e Madhe. Në komitetin për Tetovë dhe rrethin e Tetovës janë përfshië këta anëtarë: Nexhmedin Sezair Besimi, Etem Tahiri kryetar i këshillit popullor të rrethit të Tetovës etj..

b) Deri në demobilizimin nga brigada, në pranverën e vitit 1946 përsëri u kthye në Shkup ku u takua me Azem Maranën, i cili në emër të Komitetit Qendror të organizatës e urdhëroi të formonte

komitetin të ri të rrethit sepse i pari nuk pati treguar aktivitet. Në komitetin e ri u përfshinë këta anëtarë: Jonuz Balla, Nexhmedin Sezair Besimi dhe Xhevair Vesel Hoxha, të cilët i akuzuari Bushi i sqaroi se çfarë qëllimesh ka organizata, i udhëzoi për metodën e punës, për formimin e tresheve dhe për krijimin e çetave të armatosura. Anëtarët e sapozgjedhur bënë edhe betiminpara tij për lojalitetin ndaj organizatës.

c) Për propagandimin e parimeve të organizatës si dhe për përforcimin e saj, i akuzuari Bushi përpiloi një afishe në të cilën paraiti qëllimet dhe detyrat e organizatës, metodën e luftës si dhe betimin që duhej të bënte secili anëtar i organizatës, në të cilin, përveç tjerash, dënohet me vdekje çdo anëtar i cili do ta tradhtonte organizatën. Si i deleguar i KQ të organizatës udhëhoqi punën e komitetit në Tetovë dhe personalisht shkoi nëpër fshatra për të punuar në zgjerimin e organizatës duke bërë për vete elementët me bindje të njehta armiqësorë ndaj RFPJ.

ç) Përveç kësaj, i akuzuari Mehmet Bushi është fajtor edhe për shkak se në vitin 1944 u fut në formacionin e armatosur në shërbim të okupatorit dhe u bë komandant i zonës balliste të Tetovës dhe duke bashkëpunuar me banditin e mirënjohur Xhemë Hasa.

7) I akuzuari Jonuz Balla:

a) Është anëtarësuar në komitetin e dytë të rrethit për Tetovë dhe rrethin e Tetovës, dhe si i tillë është zgjedhur delegat në kongresin IV të organizatës, mbajtur me 1 qershor 1946 në Shkup, ku mori pjesë aktive në punimet e kongresit si dhe në aprovimin e rezolutës së lartpërmendur;

b) Më vonë organizoi dhe udhëhoqi komitetin për qytetin e Tetovës, ku përveç tij kanë qenë të angazhuar edhe Nexhmedin Sezair Besimi dhe Ismail Seiti, me të cilët zhvilloi disa mbledhje ku dhe u përpunua rezoluta e kongresit Veç tjerash, janë mobilizuar edhe në krijimin e çetave të armatosura, të cilat nën udhëheqjen e tyre do të vepronin në atë territor.

c) Si anëtar i organizatës dhe shumë i afërt me anëtarët e KQ të po kësaj organizate, tok me të akuzuarin AZEM MARANA dhe me sugjerimin e Qemal Iskënderit, në emër të organizatës shkrojtën një letër në gjuhën frënge. Letër e cila shkoi deri te konsulli anglez në Shkup, me përmbajtjen që u tha më lart.

8) I akuzuari Dr. Qeram Muhamed Zllatku:

a) Në organizatë është futur nga Halim Orana. Në maj të vitit 1946 ka organizuar komitetin e rrethit të Dibrës ku u përfshinë si anëtarë të akuzuarit Osman Ahmet Cami dhe Medat Tërshana. Në qershor të vitit 1946 u lidh me të akuzuarin Qemal Iskënderi në Shkup nga i cili mori direktiva për ta zgjeruar veprimtarinë e organizatës në Strugë dhe Kërçovë dhe të hyjë në lidhje me çetën e Shemë Hatipit. Njëkohësisht nga i akuzuari Iskënderi e merr rezolutën e kongresit të IV;

b) Ka urdhëruar që i akuzuari Osman Cami të formojë komitet në Strugë si dhe bashkërisht me të akuzuarin Medat Tërshana të lidhen me çetën e Shemë Hatipit.

9) I akuzuari Osman Ahmet Cami:

Në organizatën e lartpërmendur është futur nga dr. Qeram Zllatku, ku bëhet anëtar i komitetit për rrethin e Dibrës dhe, si i tillë, zgjidhet delegat në Kongresin IV të organizatës mbajtur me 1 qershor 1946 në Shkup, në të cilin ka paraqitur raport për punën dhe aksionet e çetave balliste në RP të Shqipërisë. Pas kongresit shkoi në Strugë me qëllim që ta formonte komitetin e të njëjtës organizatë me urdhër të Dr. Qeram Zllatkut. Tok me të akuzuarin Medat Tërshana lidhet me çetën e Shemë Hatipit e cila vepronte si në territorin tonë, po ashtu edhe në territorin e RP të Shqipërisë, e gjithë kjo me qëllim të realizimit të detyrave të larëpërmendura të organizatës.

10) I akuzuari Medat Mustafa Tërshana:

a) Në organizatën e lartpërmendur është futur nga i akuzuari Dr. Qeram Muhamet Zllatku në maj të vitit 1946. Kaloi anëtar i

komitetit të rrethit të Dibrës dhe punoi në mënyrë aktive për zgjerimin dhe përforcimin e organizatës dhe bashkërisht me të akuzuarin Osman Ahmet Cami nëpërmjet të akuzuarin Gani Be Mehmet Abdullahu bënë lidhjen e organizatës në Dibër me çetën e Shemë Hatipit.

b) Përveç kësaj, gjatë kohës së okupacionit, pas tërheqjes së njësisë të LNÇ nga Dibra, ku bashkërisht me ballistët tjerë të pranishëm atje ka keqtrajtuar të përmendurin Andrea, gruan dhe nënën e tij, për shkak se i kanë ndihmuar LNÇ; më pas Andrean e çojnë në burg, ku edhe vritet.

11) I akuzuari Gani Be Mehmet Abdullahu:

Menjëherë pas çlirimit mbajti lidhje me çetën balliste të Shemë Hatipit, duke ndihmuar me ushqime, pará dhe mjete tjera të nevojshme. Mori masat e duhura, nëpërmjet vëllait të tij, Shahzivarit, për lidhjen e çetës së Shemë Hatipit me çetën e Dan Kaloshit në RP të Shqipërisë, dhe e lidhi çetën e Shemë Hatipit me komitetin e organizatës në Dibër.

12) I akuzuari Spiro Harilla Theodosi:

Në organizatë futet nga i akuzuari AZEM MARANA, me direktivat e tij. Në fillim të muajit prill 1946 formoi komitetin për rrethin e Gjorçe Petrovit në fshatin Çajlanë. Anëtarët e komitetit janë betuar para tij. I akuzuari ka zhvilluar shumë mbledhje me komitetin dhe me mbështetësit e organizatës në fshatrat Raçe, Matkë, Çajlanë dhe ka formuar komitet të ri në fshatin Maranë, ish-rrethi i Draçevës, në të cilën mbledhje mori pjesë edhe i akuzuari AZEM MARANA.

13) I akuzuari Hajdar Kurtishi, Mulla Hajdari:

Menjëherë pas çlirimit, qëndroi për një kohë të caktuar si pjesëtar i çetës balliste të Sulë Hotlës, ndërsa pas kthimit në fshatin Orizare po me këtë çetë mban lidhje të përhershme. Ka ndihmuar me ushqime dhe mjete tjera të nevojshme dhe si hoxhë ka patur

ndikim te popullata e atij rrethi që ta përkrahte dhe ta ndihmonte çetën në punën e saj antipopullore dhe antishtetërore. U zgjodh kryetar i komitetit të organizatës në fshatin Orizare, i cili është formuar nga çeta e Sulë Hotlës në vjeshtën e vitit 1945. Ka qenë lidhur me KQ të organizatës në Shkup, dhe me Hasan Bilallin, Qemal Iskënderin dhe Mexhit Zyberin, nga të cilët ka marrë vazhdimisht udhëzime dhe detyra për mbajtjen e lidhjeve me çetën dhe për zgjerimin e organizatës të cilat i zbatonte rregullisht.

14) I akuzuari Xhemal Fazli Kasami:

Qysh në fillim të vitit 1945, është përfutur nga organizata prej të akuzuarëve Qemal Iskënderi dhe Mexhit Zyberi, bëhet anëtarë i së njejtës organizatë. Ka kryer detyrën e korrierit mes udhëheqjes së organizatës dhe çetave balliste në Kopilaçe dhe si i tillë, së bashku me të araturin Rexhep Dautin, dërgojnë në mbledhje anëtarët e KQ Qemal Iskënderin dhe Mexhit Zyberin në kongresin e tretë të organizatës, që është mbajtur në gusht të vitit 1945 në fshatin Tanishecë. Në shtëpinë e tij ka mbajtur të fshehur një mitraloz me municionin e duhur si dy arka municion për çetat.

15) I akuzuari Sherif Memet Aliu:

Ka shërbyer si bashkëpunëtor i organizatës në Kaçanik, duke dërguar raporte deri në KQ të organizatës në Shkup, ku flitej për gjendjen dhe veprimtarinë e organizatës në Kaçanik si dhe ka çuar afishe të organizatës në Kaçanik.

16) I akuzuari Xhavit Abdulla Selimi:

Në organizatë është futur në fillim të vitit 1945, është bërë anëtar i grupit, ka bërë betimin dhe ka mbajtur lidhje edhe me disa grupe tjera në Shkup. Gjatë kësaj kohe ka punuar për zgjerimin e organizatës dhe formimin e komitet në fshatin Luboten. Në ka lidhur Hasan Bilallin me komitetin në fshatin Orizare, ka dërguar letër sekrete të Azem Maranës në Tetovë te Xhevahir Vejseli, anëtar i komitetit të rrethit. Është lidhur me Nexhati Ibrahim Purde

nga Gostivari, nëpërmjet të cilit ka bërë përpjekje të formojë komitetin në Gostivar si dhe ka hyrë në lidhje me një organizatë të tillë në RP të Shqipërisë.

Në pajtueshmëri me direktivat e marra nga anëtari i përmendur i organizatës Hasan Bilalli, ka qenë lidhur me konsullin turk në Shkup Emin Vefa Geçek, i cili i ka nxjerrë pashaportën për kalimin përtej kufirit të të akuzuarit Qazim Sopi. Më pas i akuzuari e kë shoqëruar Qazim Sopin përtej kufirit duke i dhënë materiale sekrete. Gjithashtu, i akuzuari Xhavit i ka dorëzuar konsullit turk një letër të organizatës me anë të së cilës cilën ka kërkuar prej tij direktiva për veprimtarinë e organizatës. Në takim të dytë me konsullin, ky i fundit i ka dhënë udhëzimet e duhura.

17) I akuzuari Galip Rauf Mustafa:

Pasi vihet në dijeni për ekzistencën dhe qëllimet e organizatës së lartpërmendur, nisi të punojë për organizimin e rinisë turke në grupe ilegale, grupe të cilat punojnë për qëllimet e organizatës në fjalë. Me kohë ka qenë lidhur me të arratisurin Mahmut Sopin si dhe me kërkesën e të akuzuarit Qemal Iskënderi për ta dërguar deri te çetat balliste Qemal Iskënderin etj..

18) I akuzuari Hasan Bilalli:

a) Qysh në fillim të vitit 1945, bashkë me të akuzuarit AZEM MARANA dhe Mahmut Dumani ka krijuar organizatën antipopullore "Nacional Demokratike Shqiptare" dhe është zgjedhur anëtar i Komitetit Qendror të kësaj organizate.

b) Gjatë veprimtarisë për zgjerimin e organizatës Nacional Demokratike Shqiptare ka qenë lidhur me të akuzuarin Qemal Iskënderin i cili u betua bashkërisht me të akuzuarin Mexhit Zyberi dhe Rexhep Dautin para tij, duke i nisur në kongresin e tretë të organizatës mbajtur në muajn gusht të vitit 1945 në fshatin Tanishecë.

c) Ka pranuar letër dekretuese prej çetës së Luan Gashit, sekretar i çetës balliste të Hysen Tërpezës dhe mori pjesë në kongresin e tretë, ndërsa më vonë u lidh me ballistin Ibrahim Hakiu në Shkup, i deleguari i çetave balliste, me të cilin ka biseduar që të hyjnë në lidhje me konsullin turk në Shkup. Për këtë qëllim futi në organizatë të akuzuarin Xhavit Abdullau dhe i dha si detyrë të dërgoj letrën deri te konsulli turk si dhe për të marrë përgjigje, detyrë që Xhavit e kreu.

ç) Ka qenë lidhur me të arratisurin Qazim Sopi të cilit nëpërmjet të akuzuarit Xhavit Abdullahu i ka nxjerrë pashaportë false nga konsulli turk si dhe i ka dhënë Qazim Sopit 1.000 dinarë si ndihmë.

d) Ka mbajtur lidhje me çetat në Kosovë me të cilat ka komunikuar me anë të letrave duke marrë emrin ilegal "Ilir" dhe me paratë e organizatës dhe njete tjera të nevojshme ka ndihmuar këto çeta.

dh) Në mënyrë aktive ka punuar në përgatitjen e Kongresit IV në Shkup, ku mori pjesë në të dhe u zgjodh anëtar i Komitetit Qendror.

e/ Si i deleguar i Komitetit Qendror të organizatës ka marrë pjesë në kongresin V të saj, mbajtur me 25 korrik 1946 në malet e Lipovicës në Kosovë. Ka marrë pjesë aktive në punimet e kongresit, ku, përveç tjerash vendoset që çetat balliste të kalojnë në Greqi.

f) Pas kongresit të pestë së bashku me çetën e Ajët Gërgurit, meqë ajo u shpartallua, dhe me të arratisurin Naso Kujoviç, ilegalisht ka kaluar kufirin jugosllav-shqiptar dhe po ilegalisht ka bërë përpjekje për kalimin e kufirit shqiptaro-grek. Në Greqië u lidh me çetat balliste si dhe morie pjesë në përgatitjet prej andej kundër RFPJ.

19) I akuzuari Nazmi Emin Azemi:

Menjëherë pas çlirimit është arratisur dhe ka kontaktuar me çetat e Din Hoxhës dhe Abdyl Durrës, të cilat çeta kanë mbajtur kontakte me Komitetin Qendror të organizatës antipopullore Nacional Demokratike Shqiptare. Si anëtar i atyre çetave balliste mori pjesë

në luftimet që zhvilluan ato çeta me njësitet e Armatës Jugosllave, ndërsa sipas direktivave të Komitetit Qendror të organizatës vendosën të kalojnë në Greqi. Bashkërisht me ta forcërisht arritën të kalojnë në Greqi dhe atje ngeli në çetat e armatosura, të cilat përgatiteshin për sulm kundër RFPJ.

Në veprimtarinë e të akuzuarve qëndrojnë të gjitha elementet e duhura për ekzistencën e aktpadisë penale, prandaj gjyqi zbuloi që të akuzuarit kanë kryer aktpadi penale edhe atë:

I akuzuari Qemal Iskenderi, vepër penale e paraparë në nenin 3 T pika 1, 2, 7, 8, 9 nga ligji për vepër penale kundër popullit dhe shtetit lidhur me nenin 2 nga i njejt ligj që është në përputhshmëri si dhe vepër penale nga neni 3 T nga i njejt ligj;

I akuzuari AZEM MARANA, për vepër penale e paraparë në nenin 3 pika 1, 2, 7, 8, 9, nga ligji për vepër penale kundër popullit dhe shtetit lidhur me nenin 2 nga i njejt ligj që është në përputhshmëri;

I akuzuari Mexhit Haki Zyberi, për vepër penale e paraparë në nenin 3 pika 1, 7, 8, 9 nga ligji i përmendur lidhur me nenin 2 nga i njejt ligj që është në përputhshmëri;

I akuzuari Hasan Bilalli, sipas veprës së kryer ka kryer vepër penale të paraparë në nenin 3 pika 1, 2, 7, 8, dhe 9 nga ligji i cituar;

I akuzuari Mahmut Dumani, ka kryer vepër penale nga neni 3 pika 1, 2, 7, 8, dhe 9 lidhur me nenin 2 nga i njejt ligj;

I akuzuari Hysni Rudi, ka kryer vepër penale nga neni 3 pika 1, 7, 8 dhe 9 nga ligji për vepër penale kundër popullit dhe shtetit lidhur me nenin 2 nga i njejt ligj;

I akuzuari Mehmet Bushi, ka kryer vepër penale e paraparë në nenin 3 pika 1, 7, 8 dhe 9 lidhur me nenin 2 nga i njejt ligj;

I akuzuari Ajdar Kurtish Jashari Mulla Ajdari, në këtë dispozitiv është shkruajtur veprimtaria, se ka kryer vepër penale nga neni 3 pika 1, 7, 8 dhe 9 lidhur me nenin 2 nga i njehti ligj;

I akuzuari Osman Cami, ka kryer vepër penale nga neni 3 pika 1, 7, 8 dhe 9 nga Ligji për vepër penale kundër popullit dhe shtetit lidhur me nenin 2 nga i njehti ligj;

I akuzuari Jonuz Balla, me veprimtarin e paraqitur ka kryer vepër penale e paraparë në nenin 3 pika 1, 7, 8 dhe 9 nga ligji i njehtë për vepër penale kundër popullit dhe shtetit, lidhur me nenin 2 nga i njehti ligj;

I akuzuari Nazmi Azemi, ka kryer vepër penale nga neni 3 pika 7 dhe 8 nga ligji për vepër penale kundër popullit dhe shtetit dhe lidhur me nenin 2 nga i njehti ligj;

I akuzuari Qeram Zllatku, ka kryer vepër penale e paraparë në nenin 3 pika 1, 7, 8 dhe 9 nga ligji për vepër penale kundër popullit dhe shtetit lidhur me nenin 2 nga i njehti Ligj;

I akuzuari Spiro Harilla Theodosi, ka kryer vepër penale nga neni 3 pika 1, 7, 8 dhe 9 nga ligji për vepër penale kundër popullit dhe shtetit lidhur me nenin 2 nga i njehti ligj;

I akuzuari Xhavit Abdulla Selimi, ka kryer vepër penale nga neni 3 pika 1, 7, 8 dhe 9 nga ligji për vepër penale kundër popullit dhe shtetit lidhur me nenin 2 nga i njehti ligj;

I akuzuari Galip Rauf, ka kryer vepër penale e paraparë në nenin 3 pika 1, 7, 8 dhe 9 nga ligji për vepër penale kundër popullit dhe shtetit lidhur me nenin 2 nga i njehti ligj;

I akuzuari Xhemal Fazli Kasami, ka kryer vepër penale sipas nenit 3 pika 1, 7, 8 dhe 9 nga ligji për vepër penale kundër popullit dhe shtetit lidhur me nenin 2 nga i njehti ligj;

I akuzuari Medat Tërshana, ka kryer vepër penale e paraparë në nenin 3 pika 1, 7, 8 dhe 9 nga ligji për vepër penale kundër popullit

dhe shtetit lidhur me nenin 2 nga i njejtë ligj, si dhe vepër penale sipas nenit 3 pika 4 nga i njejtë ligj;

I akuzuari Gani Be Mehmet Abdullahu, ka kryer vepër penale e paraparë në nenin 3 pika 14 nga ligji për vepër penale kundër popullit dhe shtetit;

I akuzuari Sherif Memed Aliti, ka kryer vepër penale në nenin 3 pika 14 nga ligji i përmendur.

Për shkak të kësaj si dhe mbështetur në nenin 4 nga ligji për vepër penale kundër popullit dhe shtetit dhe ligji për format e dënimeve

DËNOHEN:

1) **I akuzuari Qemal Iskenderi**, dënohet me vdekje – ekzekutim dhe humbje të përhershme të të drejtave politike dhe disa qytetare.

2) **I akuzuari AZEM MARANA** dënohet me vdekje–ekzekutim dhe humbje të përhershme të të drejtave politike dhe disa qytetare.

3) **I akuzuari Mexhit Aki Zyberi**, dënohet me humbje të lirisë me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 10 vjet, në dënimin e së cilës të llogaritet koha që ka qëndruar në burgun hetues prej 07.08.1946, dhe humbje të të drejtave politike dhe disa qytetare përveç ata të prindërve në kohëzgjatje prej 4 vjetësh.

4) **I akuzuari Hasan Billali** dënohet me humbje të lirisë me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 20 vjet, në të cilën të llogaritet edhe koha që ka qëndruar në burgun hetues prej 21.01.1947, dhe me dënim të humbjes së të drejtave politike dhe disa qytetare në kohëzgjatje prej 3 vjetësh.

5) **I akuzuari Mahmut Dumani**, dënohet me humbje të lirisë me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 4 vjetë, në të cilën të llogaritet edhe koha që ka qëndruar në burgun hetues prej

24.07.1946, dhe humbje të të drejtave politike dhe disa qytetare në kohëzgjatje prej 3 vjetësh.

6) **I akuzuari Hysni Rudi**, dënohet me vdekje–ekzekutim dhe humbje të përhershme të të drejtave politike dhe disa qytetare.

7) **Memet Bushi**, dënohet me vdekje–ekzekutim dhe humbje të përhershme të të drejtave politike dhe disa qytetare.

8) **I akuzuari Hajdar Kurtish Jashari – Mulla Hajdari**, dënohet me humbje të lirisë me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 12 vjet, në të cilat t'i llogaritet koha që ka qëndruar në burgun hetues prej 24.04.1946, humbje të të drejtave politike dhe ato qytetare përveç atyre prindore në kohëzgjatje prej 5 vjetësh.

9) **I akuzuari Osman Cami**, dënohet me humbje të lirisë me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 15 vjetësh, në të cilën t'i llogaritet edhe koha që ka qëndruar në burgun hetues prej 24.07.1946, dhe me dënim të të drejtave politike dhe disa qytetare në kohëzgjatje prej 5 vjetësh.

10) **I akuzuari Jonuz Balla**, dënohet me humbje të lirisë, me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 8 vjetësh, në të cilin t'i llogaritet koha që ka qëndruar në burgun hetues prej 24.07.1946, dhe në humbje të të drejtave politike dhe disa qytetare në kohëzgjatje prej 2 vjetësh.

11) **I akuzuari Nazmi Emin Azemi**, dënohet me humbje të lirisë në kohëzgjatje prej 4 vjetë, në dënimin e së cilës t'i llogaritet edhe koha që ka qëndruar në burgun hetues prej 21.01.1947, dhe humbje të të drejtave politike dhe disa qytetare në kohëzgjatje prej 2 vjetësh.

12) **I akuzuari Dr. Qeram Zllatku**, dënohet me humbje të lirisë dhe punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 20 vjetë, në të cilën t'i llogaritet edhe koha që ka qëndruar në burgun hetues prej 24.07.1946, humbje të të drejtave politike dhe disa qytetarë në kohëzgjatje prej 5 vjetësh dhe humbje të gjithë pasurisë.

13) I akuzuari Spiro Harilla, dënohet me humbje të lirisë me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 3 vjetësh, në të cilin t'i llogaritet edhe qëndrimi në burgun hetues 24.07.1946, dhe me dënim të humbjeve të të drejtave politike dhe disa qytetare në kohëzgjatje prej 2 vjetësh.

14) I akuzuari Xhavit Abdulla Selimi, dënohet me humbje të lirisë me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 6 vjetë, në të cilën t'i llogaritet edhe qëndrimi në burgun hetues prej 24.07.1946, dhe humbje të të drejtave politike dhe disa qytetare në kohëzgjatje prej 3 vjetësh.

15) I akuzuari Galip Rauf, dënohet me humbje të lirisë me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 6 vjetë, në të cilin t'i llogaritet edhe burgu hetues prej 31.07.1946, dhe humbje të të drejtave politike dhe disa qytetare në kohëzgjatje prej 3 vjetësh.

16) I akuzuari Xhamal Fezli Kasami, dënohet me humbje të lirisë me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 15 vjetë, në të cilën t'i llogaritet edhe burgu hetues prej 01.08.1946, dhe humbje të të drejtave politike dhe disa qytetare në kohëzgjatje prej 5 vjetësh.

17) I akuzuari Medat Tërshana, dënohet me heqje të lirisë me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 18 vjetë, në të cilën t'i llogaritet edhe burgu hetues prej 12.08.1946, dhe humbje të të drejtave politike dhe disa qytetare në kohëzgjatje prej 5 vjetësh.

18) I akuzuari Gani Be Mehmet Abdullau, dënohet me heqje të lirisë me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 2 vjetë, në të cilën t'i llogaritet edhe burgu hetues prej 24.07.1946.

19) I akuzuari Sherif Memet Aliti, dënohet me heqje lirie me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 2 vjetësh, në të cilën t'i llogaritet edhe burgu hetues prej 31.07.1946

ARSYETIM

Në prag të procesit gjyqësor të hapur, duke i vlerësuar faktet e Prokurorisë, deklaratat e dëshmitarëve dhe faktet e dokumentuara, gjyqi u bind si në veprat e parashtruara në dispozitivë, po ashtu edhe për përgjegjësinë e veprës nga të akuzuarit.

Procesi i mbajtur në tërësi e bindi gjyqin se e ashtuquajtura "Nacional Demokratike Shqiptare" është organizatë antipopullore dhe terroriste, me karakter fashist dhe me synimin që nëpërmjet dhunës ta rrënojë dhe rrezikojë administrimin ekzistues shtetëror në RFP të Jugosllavisë dhe të rrezikojë sigurimin e saj ndërkombëtarë dhe arrijtjet themelore të LNÇ si ato demokratike, politike, nacionale dhe ekonomike, si dhe të rrezikohet siguri në RP të Shqipërisë me të cilën RFP e Jugosllavisë ka kontratë për miqësi dhe bashkëpunim.

Organizatorët dhe anëtarët përgjegjës të kësaj organizate, të akuzuarit Qemal Iskënderi, AZEM MARANA, Mexhit Haki Zyberi etj. deklaruan qartazi se organizata ka filluar veprimtarinë antipopullore të plotë në fillim të vitit 1945, por gjithashtu nga pranimi i të akuzuarve u vërtetua se organizata vetëm se e ka vazhduar punën e saj antipopullore nga koha e okupacionit, duke hyrë tash në shërbim të armiqve të paqës dhe demokracisë.

Duke mos patur mundësi të fitojë mbështetje në masat e gjera të pakicës shqiptare për veprimtarinë e saj antipopullore, organizata gjeti mbështetje te reaksionarët imperialistë ndërkombëtarë duke krijuar kushte për intervenim në RFPJ, e cila u vërtetua qartë si nga pranimi i të akuzuarve po ashtu edhe nga deklaratat e dëshmitarëve.

Karakteristika terrorist e organizatës gjithashtu u vërtetua si nga pranimi i të akuzuarve, të cilët deklaruan se që në Kongresin e tretë, në gusht të vitit 1945, terrorizmi ishte pranuar si mjet i luftës; kështu edhe nga dëshmitë e shkruara që u paraqitën, nga të cilat gjyqi u bind për zbatimin e asaj metode, ndërsa si mjet për zbatimin e

terrorizmit ata i shohin bandat balliste të shpartalluara, me të cilat ata zhvilluan mbledhje të cilat punonin sipas direktivave të tyre.

Nga pranimi i të akuzuarit Qemal Iskënderi dhënë para gjyqit, u pa qartë se emri i organizatës "Nacional Demokratike Shqiptare" ka qenë zgjedhur me qëllim që të mjegullojë pakicën shqiptare dhe për shkak komprometimit të emrit të vërtetë të organizatës që nga koha e okupacionit "Balli Kombëtar" ndërsa qëllimi parësor ka qenë futja e urrejtjes nacionale me paraqitje të qartë të terrorizmit dhe orientimin kah përmbyjsja e vëllazërim–bashkimit të popujve të Jugosllavisë me pakicën shqiptare që është arritë në luftën çlirimtare, dhe e cila deri sot në kohën e rinovimit dhe ndërtimit të bashkësisë tonë vëllazërore gjithnjë e më tepër po forcohet.

Gjatë dhënies së dënimeve për të gjithë gjyqi pati parasysh peshën dhe karakterin e kryerjes së veprave penale si dhe rrezikun shoqëror që të akuzuarit paraqesin për interesat shtetërore dhe pushtetit popullor e cila futet si barrë.

Si lehtësim, gjyqi pranoi vetëm për **Hasan Bilallin, Spiro Harillën dhe Nazmi Azemin** për shkak qëndrimit korrekt në seancë, ndërsa për **Gani Be Mehmet Abdullahun** për shkak moshës.

Qëndrimin e **Azem Maranës** në fjalën e tij përfundimtare, gjyqi e mori si përpjekje të fundit për mjegullim, sepse po ky person, me fraza boshe dhe pa kurrfarë paraqitjeje reale u përpoq që veprimtarinë e tij kriminale ta paraqesë si të pabazë dhe si rezultat i propagandës armiqësore.

Nga Gjyqi i qarkut në qytetin e Shkupit 7 – II – 1947.

Dokumenti nr. 5:

V E N D I M

i sjellë më 7 mars 1947 nga ana e Prezidiumit të Kuvendit Popullor të RFPJ, me të cilën hedhen poshtë ankesat e të dënuarve me vdekje ekzekutim AZEM MARANA, Hysni Rudi dhe Mehmet Bushi, ndërsa pranohet ankesa e Qemal Skinderit¹⁶⁴

PREZIDIUMI

I KUVENDIT POPULLOR TË RFPJ

Proc. nr. 925

7 mars viti 1947

Beograd

Në bazë të nen. 1 të Ligjit për dhënie të amnestisë dhe zbutje të dënimit, nen.3, 4 dhe 7 të Ligjit të Prezidiumit të kuvendit Popullor të RFPJ dhe nen. 12 i Rregullores për organizim dhe veprimtari të brendshme të Prezidiumit të kuvendit Popullor të RFPJ në mbledhjen e mbajtur me 7 mars të vitit 1947, solli këtë

V E N D I M

1. Që lutjet për zbutje të dënimit të Azem Idriz Maranës, Hysni Muharem Rudit dhe Mehmet Nezir Bushit, të gjykuar me dënim vdekje pushkatim me vendimin e plotfuqishëm të gjyqit popullor të Qarkut në Shkup V.P.nr. 8/47 nga 7 shkurti viti 1947 NUK PRANOHEN.

¹⁶⁴ ДАРМ.-оделение Скопје, 1.81.8/121

2. Që lutja për zbutje të dënimit të Qemal Halim Iskënderit, i dënuar me dënim vdekje pushkatim me vendimin e plotfuqishëm të gjyqit popullor të Qarkut në Shkup V.P.nr. 8/47 nga 7 shkurti viti 1947 PRANOHET:

3. Që të dënuarit Qemal Halim Iskënderi ti zëvendësohet dënimi me vdekje me dënim heqje lirie me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) vjet, ndërsa dënimi i dhënë humbja e përhershme e të drejtës politike dhe disa të drejta qytetare, të zëvendësohet me dënim humbje e të drejtave politike e disa qytetare, përveç prindërore, në kohëzgjatje prej 5 (pes) vjet.

V.F. L.P

Sekretar

Kryetar

M. Peruniçiç, s.r.

D—r Mosha Pijada, s.r

129

ПРЕЗИДИЈУМ
НАРОДНЕ СКУПШТИНЕ ФНРЈ
По.бр.925
7 марта 1947 год
Београд

На основа члана 1 Закона о давању амнестије и помиловања, чл. 3, 4 и 7 Закона о Президијуму Народне скупштине ФНРЈ и чл. 12 Правилника о унутрашњој организацији и пословању Президијума Народне скупштине ФНРЈ на својој седници од 7 марта 1947 године, донело је следећу

О Г Л У К У

1) Да се молбе за помиловање Азем Ибраје Ђорана, Хусни Мукрем Гулаја и Мехмед Назир Гулаја, осуђених на казну смрти стрељањем извршном пресудом Окружног народног суда у Скопљу Пр.Д.бр. 8 (47 од 7 фебруара 1947 године) НВ УТА Б.

2) Да се молба за помиловање Кемал Мискендери Халима, осуђеног на казну смрти стрељањем извршном пресудом окружног народног суда у Скопљу Пр.Д.бр. 8 (47 од 7 фебруара 1947 године) УБАЖИ:

Да се осуђеном Кемал Мискендери Халиму изречена казна смрти замени казном лишава слободу са притвором у трајању од 20 (двадесет) година, а изречена казна смрти у политичких и појединачних грађанских права замени казном губитка политичких и појединачних грађанских, саврогитивних, права у трајању од 5 (пет) година.

С.Ф.С.Н.

Секретар,

Б. Герукичич, с.р.

Председник,

Д. Р. Мона-Њидаре, с.р.

П.П.



Секретар,

[Handwritten signature]

Dokumenti nr.6:

SHKRESË

e Ministrisë së Drejtësisë të Qeverisë së RP të Maqedonisë, dërguar gjyqit të Qarkut në Shkup, në të cilën kjo e fundit njoftohet për vendimin e Prezidiumit të Kuvendit Popullor të RFPJ, lidhur me lutjet për zbutje të dënimeve të: Azem Maranës, Hysni Rudit, Mehmet Bushit dhe Qemal Skënderit¹⁶⁵

MINISTRIA E DREJTËSISË Deri TE GJYQI I QARKUT
MAQEDONIA DEMOKRATIKE FED. SHKUP

- Nr. 175 –
- 15 – V – 1947


SHKUP

Ju dërgohen materialet e veprës penale rreth fajësisë së QEMAL ISKËNDERI HALIM etj. dhe Vendimi Proc. Nr. 925 nga 7 marsi 1947 të Kryesisë së Prezidiumit të kuvendit Popullor të RFPJ, me të cilin vendim NUK JANË PRANUAR lutjet për zbutje të dënimit me vdekje të: AZEM IDRIZ MARANËS, HYSNI MUAHEREM RUDIT dhe MEHMET NEZIR BUSHIT, ndërsa lutja për zbutje të QEMAL HALIM ISKËNDERIT ËSHTË PRANUAR dhe ndaj të njëjtut vendimi i dhënë me vdekje pushkatim zëvendësohet me dënim heqje të lirisë me punë të detyrueshme në kohëzgjatje prej 20 vjet.

MINISTËR

V. Kalajxhiski

¹⁶⁵ ДАРМ.-отделение Скопје, 1.81.8/122



Dokumenti nr.7:

SHKRESË

e Gjqit të Qarkut të Shkupit, dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme të RP të Maqedonisë, me të cilën lejohet ekzekutimi i dënimit me vdekje pushkatim ndaj Azem Maranës, Hysni Rudit dhe Mehmet Bushit¹⁶⁶

DERI TE: MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME


TË RP TË MAQEDONISË, SHKUP

Në pajtim me vendimin e këtij gjyqi vendimin e gjyqit Suprem dhe vendimin e Prezidiumit të RFPJ nr. 925/47 Ju lejohet realizimi i dënimit me vdekje me pushkatim ndaj të dënuarve Azem Idriz Marana, Hysni Muarrem rudi dhe Mehmet Nezir Bushi.

Për realizimin ju lusim që të jemi të njoftuar

16. V. 1947

Kryetari



¹⁶⁶ ДАРМ.-оделение Скопје, 1.81.8/127

Dokumenti nr.8:

PROÇESVERBAL

i komisionit për realizimin e dënimit me vdekje pushkatim ndaj të dënuarve AZEM MARANA, Hysni Rudi dhe Mehmet Bushi¹⁶⁷

Në pajtim me letrën e Ministrisë së Punëve të Brendshme të RP të Maqedonisë Proc.VII Nr. 1500 nga 19 maji viti 1947, me të cilën caktohet komisioni për zbatimin e dënimit me vdekje mbi të dënuarit me VDEKJE edhe atë:

1/ AZEM IDRIZ MARANA, djali i Idriz Maranës dhe Atixhe Durakut, mësues Shqiptar, shtetas i Jugosllavisë, mosha 23 vjeç, i lindur në fshatin Maranë rrethi i Draçevës, ka jetuar në Shkup, i martuar, nuk ka qenë i dënuar më herët.

2/ Hysni Muarrem Rudi, djali i Muarremit dhe Nerxhivanit, mosha 28 vjeç, me kombësi Shqiptar, shtetas i jugosllavisë, gjatë kohës së okupacionit oficer Italian, i lindur në Mitrovicën e Kosovës, ka jetuar në Tiranë RP e Shqipërisë, i martuar me një fëmijë, më hert nuk ka qenë i dënuar.

3/ Mehmet Nazif Bushi, djale i Nezirit dhe i Minës, oficer, i lindur në fshatin Dukagjin, rrethi i Burelit–Shqipëri, ka jetuar në Tetovë, mosha 33 vjeç, Shqiptar, shtetas i Shqipërisë, më herët nuk ka qenë i dënuar.

Të tre janë dënuar nga ana e gjyqit popullor të qarkut Shkup, me vendim V. P. Nr. 8/47 nga 7 shkurti i vitit 1947 me dënim me VDEKJE pushkatim, humbje të përhershme e të drejtave qytetare e politike, për veprë penale kundër popullit e shtetit, për shkak se kanë qenë organizator dhe anëtarë të organizatës antipopullore “Nacional Demokratike Shqiptare” dhe kanë punuar për rrënimin e rregullimit ekzistues të RFPJ. Vendimi i gjyqit të qarkut është

¹⁶⁷ ДАРМ.-отделение Скопје, 1.81.8/124.

vërtetuar nga ana e Gjyqit Suprem të RP të Maqedonisë me vendimin V.A.Nr. 49/47 dhe lutjet për amnestion janë hedhë poshtë nga ana e Kuvendit popullor të RFPJ me vendim Nr. 925 nga 7 marsi – 1947, me çka vendimi u shpall i plotfuqishëm.

Në pajtim me shkronjën “I” nga rregullorja e përkohshme për ekzekutimin e dënimeve, komisioni në përbërje: Reiz Shaqiri – kryeshef i DPB–shk¹⁶⁸ si përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Brendshme të RP të Maqedonisë, shoku Jovan Dukovski –ndihmës prokurori si përfaqësues i Prokurorisë Publike për RP të Maqedonisë dhe shoku Gjorgji Gavrilski – ndihmës ministër si përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësi Popullore të RP të Maqedonisë, në prani të proçesverbalistit shokut Ratko Panovski me datën 19.V.1947 u takua në drejtorinë e burgut–Shkup. Komisioni pasi konstatoi se të dënuarit me vdekje AZEM MARANA, Hysni Rudi dhe Mehmet Bushi janë njoftuar për ekzekutimin e dënimit me vdekje, se janë njoftuar familjet e tyre dhe se gjithçka është shkuar sipas procedurës ligjore, urdhëroi që të dënuarit me vdekje të dërgohen në vend të caktuar për pushkatim. Pas kësaj të dënuarit menjëherë qenë dërguar dhe shoku prokurori publik të gjith të dënuarve ua dha fjalën përfundimtare, pasi të gjithë u shprehën u shkua në realizimin e dënimit me vdekje pushkatim ndaj të treve. Pas 15 minutave nga pushkatimi, mjeku konstatoi se personat kanë vdekur, komisioni urdhëroi që personat të varrosen në vendin e caktuar për atë qëllim. Me këtë u mbarua në ora 23 në datën 19.V. të vitit 1947.

I hartuar në katër ekzemplarë me datën 19.V.1947.

Proçesverbalist

1. Përfaq. i Min. Pun. Brend.

K O M I S I O N I

2. Përfaq. i Prok. Pub. të RPM

3. Përfaq. i Min. së Shënd. Pop.

¹⁶⁸ Departamenti i Punëve të Brendshme -Shkup

ЗАПИСНИК

Согласно писмото на Министерството на Внатрешните работи на Н.Р.Македонија Пов. VII Бр. 1500 од 19. Мај, 1947 година, со кое се одредува комисијата за извршување на смртната казна над осудените на СМРТ и тоа:

1/АЗЕМ ИДРИЗ МОРАНА, сина на Идриз Морани и Атија Дуракова, учител, Албанец, Југословенски поданик, стар 23 години, роден во село Морани-Драчево, живее во Скопје, измет, порано неосудуван.

2/ХУСИ МУАРЕМ РУДИЌА, син на Муарем и Геризван, стар 28 години, по народноста Албанец, поданик Југословенски, за време на окупацијата Италијански офицер, роден во Косовска-Митровица, живее во Тирана Н.Р. Албанија, женет со едно дете, порано неосудуван.

3/МЕХМЕД НАЗИК БУЏИЌА, син на Резир и Мина, офицер, роден во село Дукадиново, срез Буре Албанија, живее во Тетово, стар 23 години, Албанец, албански државјанин, порано неосудуван.

Сите тројца се осудени од страна на окружниот народен Суд Скопје, со пресуда Кр.Д.Бр. 8/47 од 7. II. 1947 година на казна СМТ со стрелба, трајен губиток на граѓанските и политички права, за крвничко дело против народот и државата, за тоа што се били организатори и членови на противнародната организација "Национал Тигар Демократик" и работале за урнување на постојаното устројство во ОФГ. Пресудата на окружниот суд не потврдена од страна на Врховниот Суд на Н.Р. Македонија со пресуда Кр.Д.Бр. 49/47 и молбите за помилување се одбени од страна на Народната Скупштина на ОФГ со одлука По бр. 925 од 7-Март-1947 година, со кое пресудата не е поставена извршена.

Согласно буква "и" од привремениот правилник за извршување на казните, комисијата во состав: Гале Шакир, казачки САР-ик како представител на Министерството на Внатрешните работи на Н.Р. Македонија, Јован Љубовски - бол. обик. како представител на Јавното обвинителство за Н.Р. Македонија и другарот Др. Јосиф Јовановски - б. лич. како представител на Министерството на Народното Здравје на Н.Р. Македонија, при записничар другарот Ратко Пановски се састана на ден 19.V.1947 година во управата на казано-поправителниот дом Скопје. Комисијата след како констатира дека на осудените на смрт Азем Морани, Хусни Рудиќа и Мехмед Буџиќа им не е саопштено за извршување на смртната казна, обавестени се нивните семејства и да по сите не е поставено по закон, нареди да се осудените на смрт изведат на отпределено место за екзекуција. После тоа веднаг осудените бова изведени и другарот Јавен обвинител им даде последна дума на сите осудени, след како истите не произнесоа се приступи ко исполнење на смртната казна со стрелба над сите тројца. След 15 минути од екзекуцијата, лекарот констатира дека лицата се мртви, комисијата нареди да се лицата закопат на отпределеното место за таѓањето. Со тоа се заврши во 23 саат на ден 19.V.1947 година.

Составен во четири примерка на 19.V.1947 г. во Скопје

ЗАПИСНИЧАР:

[Signature]

КОМИСИЈА:

1. Предст. на Мин. Внатр. Работи

[Signature]

2. Предст. на Јавното Обвинит. ТР

[Signature]

3. Предст. на Мин. на Народ. Здравје

[Signature]

Dokumenti nr. 9:


SHKRESE

e Ministrisë së Punëve të Brendshme të RP të Maqedonisë, me të cilën njoftohet Gjyqi i Qarkut në Shkup, për realizimin e vendimit me vdekje pushkatim ndaj Azem Maranës, Hysni Rudit dhe Mehmet Bushit.¹⁶⁹

Si shtojcë Ju dërgohet proçesverballi i komisionit që mori pjesë gjatë realizimit të dënimit me vdekje ndaj të dënuarve: Azem Idriz Maranës, Hysni Muarem Rudit dhe Mehmet Nezir Bushit, të cilët janë dënuar nga ana e atij gjyqi me vendim V.P. nr. 8/47

KRYESHEFI I DHOMËS SË VII

/R. Bizhinovski/



¹⁶⁹ ДАРМ.-одделение Скопје, 1.81.8/126

R E Z Y M E

Më 1 qershor 2016, pikërisht në 70-vjetorin e mbajtjes së Kongresit II (IV) të NDSH-së, në Shkup u mbajt konferencë shkencore, ku u paraqitën 12 kumtesa nga studiues nga Kosova dhe Maqedonia.

Konferenca ishte fryt i bashkëpunimit mes Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup dhe Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, dhe u mbajt në sallën e ITSHKSH-së në Shkup.

Kështu, në hyrje të konferencës, fjalë përshëndetëse patën drejtori i ITSHKSH – Shkup, dr.Skender Asani, drejtori i IH – Prishtinë dr. Sabit Syla, dhe kryetari i Komunës Çair të Shkupit, z.Izet Mexhiti, si mbështetës kryesor i aktivitetit.

Drejtorët theksuan rëndësinë e mbajtjes së kësaj konference, pikërisht në Shkup, këtu ku ishte njëra ndër çerdhet kryesore të organizatës NDSH. Njëkohësisht shprehën gatishmërinë, që edhe më tutje të kontribuojnë në planin shkencor, për zbardhjen e kësaj ngjarjeje me rëndësi historike për të kaluarën tonë.

Kryetari i Komunës Çair, Izet Mexhiti, theksoi se pas 7 dekadave, NDSH-ja përjetësohet dhe zyrtarizohet pikërisht këtu në Shkup, ku disa nga rrugët e qytetit të Shkupit, do ta mbajnë me krenari emrat “Nacional-Demokratët Shqiptarë”, Azem Marana, Qemal Skenderi dhe Gjon Sereçi.

Më pas u paraqitën studiuesit me temat e tyre. E para referoi studiuesja nga Prishtina, Sabile Keçmezi-Basha, në temën “Formimi dhe veprimtaria e NDSH-së (1945–1947)”; Studiuesi nga Shkupi Qerim Lita referoi në temën: “Organizimi dhe mbajtja e Kongresit II (IV) të NDSH-së në Shkup”; Skender Asani foli për “Komitetin e NDSH-së për qytetin e Shkupit dhe veprimtarinë e Ibrahim Haki-Kelmendit”; Sabit Syla dhe Izet Miftari në kumtesën

e tyre u përqëndruan në “Rezistencën kundër vendosjes së pushtetit komunist në rajonin e Shalës së Bajgores (1944 – 1947)”. Më tej, studiuesi Haki Kasumi referoi për “Veprimtarinë atdhetare të Gjon Serreqit”, kurse Daut Bislimi për “Veprimtarinë dhe ndikimin e Halim Oranës në Kongresin e II-të të NDSH-së”; Izber Hoti për “Organizatën Nr. 2. dhe Ajet Gërgurin”; Naim Halimi u përqëndrua në “Historiografinë shqiptare dhe të hauj për dhe rreth NDSH-së”; Nuridin Ahmeti për “Kontributin e krerëve fetarë nga Kosova në Lëvizjen Nacional-Demokratike Shqiptare”; Sevdail Demiri për “Arrestimet dhe gjykimet e anëtarëve të Komitetit të NDSH-së së Kumanovës në vitin 1946/47”, etj.

Gjatë konferencës u zhvillua edhe një debat mjaft konstruktiv, i cili do të ketë impakt në përmirësimin dhe avancimin e mëtejshëm të kumtesave shkencore, të cilat botohen në revistën “Scupi” në Shkup.

Këshilli organizues i konferencës, në përbërje dr.Skender Asani, prof.dr.Sabit Sylja, prof.dr.Sabile Keçmezi-Basha, dr.Qerim Lita, dhe dr.Sevdail Demiri, vlerësojnë se shumica e kumtesave kishin nivelin e duhur shkencor, dhe se gjatë versionit përfundimtar, para botimit, një pjesë e tyre do të duhet që të argumentohen edhe më tepër me dritën e burimeve të mirëfillta arkivore dhe shkencore.

Ju faleminderit.

S. Demiri, 1.6.2016, Shkup

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP
INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” – PRISHTINË

70–vjetori i Kongresit II (IV) të NDSH–së në Shkup

SCUPI, vëllimi 16 – 2017

Për botuesin:

Dr. Skender Asani

Kryeredaktor:

Dr. Sevdail Demiri

Shtypi: Fokus Print – Shkup

CIP – Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

323.1(=18)(062)

SHTATËDHJETË

70-vjetori i Kongresit II (IV) të NDSH-së në Shkup : (konferencë shkencore, 1 qershor 2016). 16 / [kryeredaktor Sevdail Demiri]. - Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, 2017. - 172 стр. : илустр. ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Содржи и: Shtojcë

ISBN 978-608-4653-44-8

1. Дополн. насл.

а) Албанско национално движење - Собири

COBISS.MK-ID 102658314